



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË I STUDIMEVE

E DREJTA PENALE

“VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR ME THEKS TË VEÇANTË NË
RAJONIN E TETOVËS, për periudhën 2009-2014”

Kandidati:

Driton ASANI

Mentor:

Prof. Dr. Ismail ZEJNELI

Tetovë, Maj 2020

Struktura e punimit:

**“VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR ME THEKS TË VEÇANTË NË RAJONIN E TETOVËS,
për periudhën 2009-2014”**

HYRJE

KAPITULLI I

VËSHTRIMET E PËRGJITHSHME MBI VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR

1.1. Përkufizimi i veprave penale në përgjithësi dhe veprave penale kundër mjedisit në veçanti.....	9
1.2. Rëndësia e mbrojtjes së mjedisit. Lidhja me të drejtat themelore të njeriut	11
1.3. Vështrimi i shkurtët historik mbi zhvillimin e të drejtës së mjedisit dhe burimet e saj	15
1.4. Mbrojtja e mjedisit në nivel ndërkombëtar dhe evropian.....	18
1.5. Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale në kuadrin e Bashkimit Evropian	20
1.6. Mbrojtja e mjedisit sipas legjislacionit të brendshëm të Republikës së Maqedonisë	22
1.6.1. Ligji për mjedisin jetësor	23
1.6.2. Ligji për mbrojtjen e natyrës	24
1.6.3. Ligji për ujërat	26
1.6.4. Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit.....	26
1.6.5. Ligji për menaxhimin e mbeturinave	27
1.6.6. Ligji për Energjetikë.....	28
1.6.7. Ligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht.....	29
1.6.8. Ligji për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor.....	30

Kapitulli II

KARAKTERISTIKAT E VEPRAVE PENALE KUNDËR MJEDISIT

2.1. Vështrime hyrëse për veprat penale kundër mjedisit	31
2.2. Llojet e veprave penale kundër mjedisit jetësor	31
2.2.1 Ndotja e ambientit jetësor	32
2.2.2. Ndotja e ujit të pijshëm	34
2.2.3. Prerja e paligjshme e pyjeve	36
2.2.4. Rrezikimi i mjedisit jetësor me hedhurina	41
2.2.4.1. Mbeturinat industriale	43
2.2.4.2. Mbeturinat komunale	43
2.2.4.3. Mbetjet radioaktive	44
2.2.4.4. Mbetjet mjekësore	44
2.2.5. Transportimi i materieve të rrezikshme në vend.....	45
2.2.6. Uzurpimi i paluajtshmërive	46
2.2.7. Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale.....	46
2.2.8. Gjuetia e paligjshme.....	46
2.2.9. Peshkimi i paligjshëm.....	47

Kapitulli III

ANALIZË DHE TË DHËNA STATISTIKORE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

3.1. Ecuria dhe vëllimi i veprave penale kundër mjedisit	48
3.2. Kryerësit e veprave penale kundër mjedisit jetësor	48
3.2.1. Moshë dhe gjinia e kryerësve të veprave penale kundër mjedisit jetësor	55
3.2.2. Shkollimi, profesioni dhe nacionaliteti i kryerësve të veprave penale kundër mjedisit..	57

3.3. Veprat penale kundër mjedisit jetësor, analizë sipas të dhënave nga Prokuroritë publike dhe gjykatat e RM-së.	59
3.3.1. Raportimet sipas të dhënave nga Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor i RM-së	61
3.4. Analizë e përgjithshme për veprat penale kundër mjedisit jetësor, në rajonin e Tetovës dhe komunat për reth.	63

Kapitulli IV

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR NË RM NË NJË KONTEST KRAHASIMOR ME SHTETE TË TJERA DHE ME DIREKTIVAT E BASHKIMIT EVROPIAN MBI KRIMIN MJEDISOR

4.1. Vështrim krahasues mbi veprat penale kundër mjedisit	67
4.1.1. Veprat penale kundër mjedisit në legjislacionin e SHBA-ve	67
4.1.2. Veprat penale kundër mjedisit në Gjermani	69
4.1.3. Veprat penale kundër mjedisit në Angli dhe Uells	70
4.1.3.1. Legjislacioni në Mbretërinë e Bashkuar	71
4.1.3.2. Dënimet për veprat penale kundër mjedisit në Mbretërinë e Bashkuar	72
4.1.4. Veprat penale kundër mjedisit në Francë.....	73
4.1.4.1. Legjislacioni në Francë.....	73
4.1.4.2. Dënimet për veprat penale kundër mjedisit në Francë.....	74
4.1.5. Veprat penale kundër mjedisit në Itali	74
4.1.5.1. Të dhëna statistikore për veprat penale kundër mjedisit në Itali,	75
4.1.6. Veprat penale kundër mjedisit në Kroaci.....	78
4.1.6.1. Veprat Penale kundër mjedisit sipas Kodit Penal të Kroacisë.....	78
4.1.6.2. Të dhëna statistikore për veprat penale kundër mjedisit në Republikën e Kroacisë ...	79
4.1.7. Veprat penale kundër mjedisit në Kosovë	80

Kapitulli V

POLITIKA E DËNIMIT PËR VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SI DHE MASAT PARANDALUESE

5.1. Dënimet sipak Kodit Penal të RMV-së për veprat penale kundër mjedisit jetësor	83
5.1.1. Vepra penale e ndotjes së ambientit jetësor	84
5.1.2. Vepra penale e ndotjes së ujit të pijshëm.....	85
5.1.3. Vepra penale e prerjes së paligjshme të pyjeve.....	86
5.1.4. Vepra penale e rrezikimit të mjedisit jetësor me hedhurina	86
5.1.5. Vepra penale e transportimit të materieve të rrezikshme në vend.....	87
5.1.6. Vepra e rënda penale kundër mjedisit jetësor.....	87
5.2. Masat parandaluese ndaj veprave penale kundër mjedisit.....	88
PËRFUNDIMI.....	90
BIBLIOGRAFIA.....	91

HYRJE

Në këtë punim shkencor do të hulumtohen veprat penale kundër mjedisit jetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë, që paraqiten si vepra të rënda të kundërligjshme që çënojnë mbrojtjen e mjedisit, çënojnë një ndër të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që është uji dhe ajri, të drejta të cilët na i ka falur Zoti, dhe pa të cilët nuk mund të jetojmë.

Do të hulumtohen ato vepra penale për të cilat gjykata shqipton dënim me gjobë, dënim me burgim prej 1 deri në 5 vite, si dhe në raste më të rënda dënim me burgim deri në 10 vite.

Në theks të veçantë do të hulumtohen veprat penale që janë kryer përgjatë periudhës 2009-2014. Do të trajtohen veprat që kanë përfunduar si dhe ato që janë më aktuale dhe proceset gjyqësore akoma nuk kanë përfunduar.

Do të analizohet roli dhe rëndësia e organeve kompetente të cilët mund të parandalojnë këto vepra, cili është roli i tyre dhe sa këto kanë arritur rezultat në këtë fushë. Një theks të veçantë do t'u kushtohet edhe organizatave joqeveritare dhe aktivistëve të ndryshëm për mbrojtjen e mjedisit, ndikimi dhe kontribuimi i tyre në shoqëri për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Lëndë hulumtimi do të jenë veprat penale kundër mjedisit, gjykatat dhe organet tjerra kompetentë, kryerësit e këtyre veprave, dënimet e shqyrtuara si dhe masat për parandalimin e këtyre veprave. Do të hulumtohet mbi bashkëpunimin e institucioneve përkatëse vendore dhe atyre ndërkombëtare për parandalimin e kësaj problematike.

Do të shfrytëzohet literatura shkencore nga autorë të ndryshëm vendor dhe të jashtëm, si dhe burime të ndryshme nga interneti në përputhshmëri me temën

Qëllimi i këtij punimi është njohja dhe studimi i veprave penale kundër mjedisit jetësor, hulumtimi i faktorëve dhe rethanave që i detyrojnë personat të kryejnë këto vepra dhe pasojat që shkaktohen nga këto vepra penale. Të gjitha këto me një qëllim të vetëm luftimin dhe parandalimin e këtyre veprave mjaft të dëmshme për shoqërinë.

Qëllimi i hulumtimit ka të bëjë me evidencat statistikore, të shihet sa persona juridik janë dënuar dhe sa persona fizik, sa prej tyre e vuajnë dënimin, rrjedhja e procedurës gjyqësore dhe për sa pritet aktgjykimi i tyre.

Përmes këtij hulumtimi do të shihet se sa janë efikase sanksionet e parapara në Kodin Penal të RM-së kundër kryerësve të këtyre veprave penale, do të hulumtohet se në mesin e

kryerësve cilët persona janë të përfshirë, mosha e tyre dhe a ekziston recidivizmi te këto lloje veprash penale.

Hipoteza primare e këtij punimi është, ndikimi i këtyre veprave në shoqëri dhe cënimi i të drejtave elementare për jetë.

Hipoteza sekondare ka të bëjë me problematikën e organeve kompetente, respektivisht rolin e inspektoratit në shqyrtimin e dënimeve dhe parandalimin e këtyre veprave.

Gjithashtu a ekziston nevoja e themelimit të një organi i cili do të kontribuonte në vetëdijësimin e qytetarëve dhe njoftimin me problematikën dhe pasojat që shkaktohen nga këto vepra.

Hipoteza terciare ka të bëjë me kapacitetin e organeve kompetente për shqyrtimin e dënimeve dhe sa rezulton bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për zgjidhjen e problematikave të kësaj natyre.

Për mbledhjen e të dhënave dhe dhënien e një pasqyre sa më reale në lidhje me veprat penale kundër mjedisit jetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë, do të shërbehemi me të dhënat statistikore nga enti përkatës për statistika, si dhe për trajtimin, studimin, analizën e kësaj materie, metodat që do të shfrytëzohj do të jenë:

- Metoda historike
- Metoda krahasuese
- Metoda e analizës
- Metoda e studimit të rasteve individuale
- Metoda e anketës dhe intervistës
- Metoda statistikore, etj.

Veprat penale kundër mjedisit jetësor, janë në rritje të vazhdueshme, përderisa studimi i tyre i pamjaftueshëm e jo pak i rëndësishëm, prandaj rëndësia e këtij punimi qëndron në atë se gjatë analizës së shkaqeve të kryerjes dhe hulumtimit të këtyre veprave, del në sipërfaqe se si rezultat i cilëve faktorë këto vepra janë në rritje të vazhdueshme, si intervenon shteti në kompensimin, dëmshpërblimin dhe mbrojtjen e viktimave, sa ndikojnë sanksione e parapara kundër këtyre veprave penale në risocializimin e kryerësve dhe vetëdijësimin e qytetarëve në përgjithësi.

Shpresoj që ky punim do të kontribuojë në njohjen e rrezikshmërisë së këtyre veprave penale për të gjithë personat që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, si dhe të kontribuojë për gjetjen e masave më efikase për parandalimin e kësaj dukurie të dëmshme për shoqërinë, veçanërisht në qytetin e Tetovës dhe zonat reth tij, siç është Mali Sharr një bukuri e rrallë natyrore me një ekosistem të pasur me gjelbërim dhe shumë burime të ujit të cilët mund të shfrytëzohen për qëllime të mira.

Për të ruajtur biodiversitetin e këtij regjioni, Mali Sharr duhet që të shpallet “Park Nacional” që të ketë mbrojtjen dhe kujdesin e duhur nga organet kompetente për të ruajtur dhe zhvilluar vlerat e këtij “perimetri të pasur” që do të ishte edhe zona me sipërfaqe më të madhe e mbrojtur nga shteti.

KAPITULLI I

VËSHTRIMET E PËRGJITHSHME MBI VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR

1.1. Përkufizimi i veprave penale në përgjithësi dhe veprave penale kundër mjedisit në veçanti

E drejta penale është organi i së drejtës që përcakton veprat penale, rregullon “kapjen”, ngarkimin dhe gjykimin e personave të dyshuar, si dhe rregullon dënimet dhe mënyrat e trajtimit të zbatueshme për autorët e dënuar¹.

Çështjet më kryesore që i trajton e drejta penale janë, vepra penale, kryerësi i veprës penale dhe sanksioni penal. Vepra penale është kategoria kryesore qendrore në sistemin e së drejtës penale, ajo legjitimon të drejtën e ndëshkimit si dhe e përcakton fushën e represionit penal-juridik, ndërsa nga nocioni i saj nxirren edhe kategoritë tjerra themelore siç janë, përgjegjësia penale dhe dënimi².

Qasja tradicionale ndaj ligjit penal në të kaluarën ka qenë se, një krim është një veprim i gabuar moralisht. Qëllimi i sanksioneve penale kishte të bënte me atë që shkelësi të jepte ndëshkim për dëmin e bërë dhe të shfaros fajin e tij moral, dënimi duhej të përmbushej në përpjestim me fajësinë e të akuzuarit. Në kohët moderne kanë mbizotëruar pikëpamjet më racionale dhe më pragmatike. Shkrimtarët e iluminizmit si Cesare Beccaria në Itali, Montesquieu dhe Voltaire në Francë, Jeremy Bentham në Britani dhe P.J.A. von Feuerbach në Gjermani e konsideronin qëllimin kryesor të së drejtës penale si parandalimin e krimit. Me zhvillimin e shkencave shoqërore, lindën koncepte të reja, siç janë ato të mbrojtjes së publikut dhe reformës së shkelësit. Një qëllim i tillë mund të shihet në kodin penal gjerman të vitit 1998, i cili paralajmëroi gjykatat se efektet që dënimi do të pritet të ketë në jetën e ardhshme të kryesit në shoqëri do të konsiderohen. Në SHBA, një Kod Penal Model i propozuar nga Instituti Amerikan i Drejtësisë në vitin 1962 thotë që një objektiv i të drejtës penale duhet të jetë “të japë paralajmërim të drejtë për natyrën e sjelljes së deklaruar si një vepër penale” dhe të

¹ Hans-Heinrich Jescheck and Jerry Norton, Criminal law, Encyclopaedia Britannica, Inc., 2020 Encyclopaedia Britannica, fq. 1

² Vlado Kambovski & Ismail Zejneli, E drejta Penale, Shkup 2018, fq. 79

promovojë korrigjimin dhe rehabilitimin e shkelësve. Që nga ajo kohë ka pasur interes të përtërirë për konceptin e parandalimit të përgjithshëm, duke përfshirë edhe parandalimin e shkelësve të mundshëm dhe stabilizimin dhe forcimin e normave shoqërore.³

Lënda e së drejtës penale dhe normave të saj i paraqet veprat penale. E drejta penale i mbron vlerat dhe të mirat themelore nga sjelljet e caktuara të njeriut të cilat me ligj janë të shpallura si të ndaluara dhe që ndëshkohen me ligj.⁴

Kodi Penal i RM-së është përcaktuar për nocionin objektiv-subjektiv të veprës penale, e cila definohet si veprim i kryerësit të fajshëm, që është e përcaktuar me ligj si veprë e kundërligjshme dhe është e ndëshkueshme, në raport me personat e papërgjegjshëm si veprim që është tregues i gjendjes së posaçme të personit ndaj të cilit është imponuar zbatimi i masave të posaçme për ndihmë, mjekim apo masa të mbikqyrjes.⁵

Subjekti i veprës penale është personi fizik që kryen veprë penale, gjithashtu si subjekte të veprës penale konsiderohen edhe personat juridik.⁶

Mjedisi është një vend ku ekzistojnë gjëra të ndryshme që mund të jenë të gjalla (biotike) ose jo të gjalla (abiotike). Ai përfshinë forca fizike, kimike dhe forca të tjera natyrore. Gjëra që jetojnë në atë ambient. Ata ndërveprojnë vazhdimisht me të dhe përshtaten me kushtet në mjedisin e tyre. Në mjedis ka ndërveprime të ndryshme midis kafshëve, bimëve, tokës, ujit dhe gjallesave tjerra.⁷

E drejta mjedisore është “koleksioni”⁸ i ligjeve, rregulloreve, marrëveshjeve dhe ligjit të përbashkët që rregullon mënyrën se si njerëzit ndërveprojnë me mjedisin e tyre ku jetojnë. Qëllimi kryesor është mbrojtja e mjedisit dhe krijimi i rregullave për mënyrën se si njerëzit

³ Hans-Heinrich Jescheck and Jerry Norton, Criminal Law, Encyclopaedia Britannica, Inc., 2020 Encyclopaedia Britannica, fq. 4.

<https://www.britannica.com/topic/criminal-law>

⁴ Vlado Kambovski, E drejta Penale, Shkup 2007, fq. 9

⁵ Vlado Kambovski & Ismail Zejneli, E drejta Penale, Shkup 2018, fq. 81

⁶ Po aty, fq. 84 (referim fusnotës numër 5)

⁷ Gary Skinner, Ken Crafer, Melissa Turner, John Stacey, Ann Skinner, Cambridge IGCSE® and O Level Environmental Management Coursebook, London 2017, fq. 189-190

⁸ Environmental LAW definition, What is Environmental LAW, Legal Career Path article, <https://legalcareerpath.com/what-is-environmental-law/>

mund të përdorin burimet natyrore. Ligjet mjedisore jo vetëm që synojnë të mbrojnë mjedisin nga dëmtimi, por gjithashtu përcaktojnë se kush mund ti shfrytëzoj ato burime.

Veprat penale kundër mjedisit përfshijnë të gjitha aktivitetet që shkaktojnë dëm të konsiderueshëm ose rrezik për mjedisin, shendetin e njeriut ose të dyja bashkë. Veprat penale kundër mjedisit, për kryerësit e këtyre veprave përfitimet mundet të jenë po aq fitimprurëse sa veprat tjera më të rënda penale si p.sh. trafikimi me mjete narkotike, mirëpo te këto vepra penale kundër mjedisit sanksionet janë shumë më të ulëta dhe është shumë më e vështirë që të zbulohen. Këta faktorë e bëjnë këtë shumë tërheqëse te grupet e organizuara kriminale. Gati se 50%⁹ e aktiviteteve kriminale në zonat e konfliktit kanë të bëjnë me vepra penale kundër mjedisit dhe shfrytëzim të paligjshëm të burimeve natyrore. Të ardhurat nga këto aktivitete ndonjëherë përdoren për të financuar terrorizmin si dhe vepra tjera më të rënda penale.

1.2. Rëndësia e mbrojtjes së mjedisit. Lidhja me të drejtat themelore të njeriut

Të drejtat dhe liritë e njeriut kanë zënë vend në shumë shkrime të ndryshme që nga kohërat më të vjetra.

Të drejtat dhe liritë e njeriut janë të drejta, të cilat i përkasin çdo njeriu që nga lindja. Ato nuk fitohen dhe nuk varen nga statusi i individit në fjalë, ato janë universale, të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme, janë kriter thelbësor që shërbejnë në ngritjen dhe avancimin e statusit dhe rolin e njeriut në shoqëri. Këto të drejta burojnë nga e drejta natyrore dhe janë të garantuara me Kushtetutë, i akt më i lartë juridik.¹⁰

Mbrojtja e përgjithshme e njeriut është e garantuar dhe sanksionohet sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948, të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së ku përmendet “Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta, si dhe çdo njeri ka të drejtën e jetës dhe sigurisë së personit”.¹¹

⁹ “Strengthening good environmental governance and international cooperation” : The case for preventing and fighting Environmental Crime in the OSCE Region. OSCE Economic and Environmental Forum, Prague, 2019, fq. 1. <https://www.osce.org/secretariat/429728?download=true>

¹⁰ Kathleen Imholz dhe Elsa Toska (Dobjani), manual, Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, Tiranë 2016, fq. 17

¹¹ <https://childrenandarmedconflict.un.org/keydocuments/albanian/universaldeclara1.html>

Mbrojtja e individit dhe shoqërisë nga kriminaliteti me ndihmën e së drejtës penale realizohet me shpalljen e sjelljeve të përcaktuara si vepra penale dhe sanksione tjera për ato vepra.¹²

Qëllimi kryesor i çdo shoqërie në përgjithësi dhe shtetit në veçanti është mbrojtja e individit dhe shoqërisë duke garantuar të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe parandalimin dhe sanksionimin e cënuesve, shkelësve të këtyre të drejtave sipas ligjeve të implementuara dhe miratuara paraprakisht në Kodin Penal.

Mbrojtja e mjedisit mund të përkufizohet si parandalimi i ndryshimeve të padëshiruara në ekosistemet dhe pjesët përbërëse të tyre duke përfshirë ndryshimet që lidhen me veprimtaritë nga faktori njeri dhe parandalimi i ndryshimeve natyrore të padëshiruara në ekosistemet dhe pjesët përbërëse të tyre.

Çështja që lidhet me këtë përkufizim është nëse “ekosistemet dhe pjesët përbërëse të tyre” përfshijnë njerëzit dhe komunitetet, apo nëse mbrojtja e mjedisit merret vetëm me mbrojtjen e kapitalit natyror. Nga këndvështrimi ekologjik, njerëzit vlerësohen si pjesë përbërëse e ekosistemit. Ndarja e njerëzimit nga mjedisi natyror, mund të shihet si artificiale, mirëpo kjo është e vërtetë, fraza mbrojtja e mjedisit nuk përdoret për t’iu referuar masave që janë krijuar për të rregulluar ose ndërmjetësuar ndërveprimin e drejtëpërdrejtë midis njerëzve. Për shembull, ligjet që ndalojnë sulmin nuk konsiderohen si masa të mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit ka të bëjë me marrëdhëniet midis njerëzve dhe mjedisit natyror sesa marrëdhëniet midis njerëzve dhe komuniteteve.¹³

Një çështje tjetër është nëse mbrojtja e mjedisit ka të bëjë me ruajtjen, konservimin ose të dyja bashkë. Ruajtja e mjedisit i referohet mbrojtjes së një ekosistemi ose ambienti jetësor nga ndryshimi, ndërsa konservimi në përgjithësi shoqërohet me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Shfrytëzimi i burimeve natyrore për qëllime njerëzore nuk është mbrojtje e mjedisit pasi nuk shoqërohet me parandalimin e ndryshimeve të padëshiruara.

¹² Vllado Kambovski, E drejta penale, Shkup 2007, fq. 144

¹³ Clive Hamilton and Andrew Macintosh, Encyclopedia of Ecology, 2008 Elsevier B.V. Amsterdam, fq. 1342.

Një aspekt kritik i mbrojtjes së mjedisit është se drejtohet nga vlerat që njerëzit i atribuojnë aspekteve të ndryshme të mjedisit. Këto vlera nuk kanë nevojë të jenë instrumentale, por faktori motivues për mbrojtjen e mjedisit është gjithmonë parandalimi i ndryshimeve në mjedis që njerëzit nuk duan. Kjo është arsyeja pse masat që lidhen me parandalimin e ndryshimeve natyrore të padëshiruara në ekosistemet, si parandalimi i erozionit bregdetar ose djegia sistematike në rezerva për të zvogëluar rrezikun e zjarreve, mund të përfshihen si mbrojtje e mjedisit. Masat e tilla nuk synojnë të mbrojnë ekosistemet nga aktivitetet njerëzore, por përkundrazi nga forcat natyrore që konsiderohen se kërcënojnë interesat njerëzore.

Në kohën e sotme që jetojmë është e njohur që natyra nuk është më “një luks” opsional, por është një themel thelbësor për mirëqenien e njeriut dhe zhvillim e qëndrueshëm. Ruajtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i natyrës dhe përbërësve të saj nuk është një problem që duhet të zgjidhet por një pjesë integrale e një numri zgjidhjesh siç janë siguria e ujit dhe sistemeve të ujit, mbarimi i urisë, sigurimi i ushqimit, përmirësimi i jetesës, ulja e rrezikut nga katastrofat, zbutja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike si dhe përfundimi i varfërisë ndër të tjerra¹⁴.

Duke analizuar në këndvështrimin e lidhjes me të drejtat themelore të njeriut, objekti kryesor i dispozitave ligjore për mbrojtjen e mjedisit lidhet me mbrojtjen e të drejtës themelore të njeriut, qytetarit për një jetë të shëndetshme në një kontekst ku do të respektohej ekuilibri natyral¹⁵.

E drejta e mjedisit është e përfshirë në shumë legjisllacione dhe rëndësia e marrëdhënies midis mjedisit dhe të drejtave të njeriut është pa diskutim shumë e lartë në legjisllacionet ndërkombëtare. Sidoqoftë duke pasur parrasysh kundërshtimin e shprehur për përfshirjen e konsideratës mjedisore brenda një kornize të të drejtave të njeriut, rrugët e ndryshme drejt mbrojtjes së mjedisit janë hartuar në përpjekje për të ndërtuar në mënyrë progresive një mbulim gjithëpërfshirës të çështjeve përkatëse. Në ligjin e të drejtave të njeriut, hapi i parë ka qenë që të ri-interpetojnë në mënyrë progresive të drejtat e formuluar para “Epokës

¹⁴ <https://www.ipcc.int/en/themes/environment-protection/>

¹⁵ Luca Ramacci, Diritto penale dell' ambiente, Piacenza 2017, fq. 7.

Ekologjike” ashtu siç kanë ndërmarrë disa organe monitoruese dhe mbikëqyrëse të të drejtave të njeriut.¹⁶

Së dyti, të drejtat procedurale të mishëruara në të dy Konventat e të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe të informuara nga zhvillimet në 64 Në këtë pikë, shihni [*D6jeant-Pons, M., 'Le droit de l'homme i l'environnement, droit fondamental au niveau europ6en dans le cadre du Conseil de l'Europe, et la Convention, europdenne de sauvegarde des droits de l'homme et des libert6s fondamentales ', Association Europdenne de Droit de l'Environnement, Journe d'etude sur' le droit de l'homme d l'environnement en droit Constitutionnel comparé dans les Etats de la communautd Europdenne ', Douai, 24 nëntor 1992, Strasburg, Prill 1993 (qarkullimi mimeograf / i kufizuar). 6 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, L6pez Ostra kundër Spanjës, aktgjykim i 23 nëntorit 1994, Seria A, Vol. 303-C (Nr. 41/1993/436/515)].*

39 HeinOnline - 13 Neth. Q. Hum. RTS. 39 1995 NQHR I / 1995, instrumentet mjedisore ndërkombëtare mund të përdoren vetë në disa rethana dhe së fundi, një e drejtë e plotë e mjedisit lejon që konsideratat mjedisore të shikohen vetë, pa mos iu referuar të drejtave të tjera të njeriut dhe të marrin parrasysh dimensionin global të problemeve. Këto alternative duhet të shihen si më shumë plotësuese sesa të pajtueshme pasi që të gjitha kanë tendencë drejt të njëjtit qëllim. Një e drejtë për mjedisin paraqet në teori qëllimin përfundimtar për të marrë parasysh vëmendjen e veçantë të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht, por konsideratat praktike mund të diktojnë përqëndrimin në zgjidhjet e “pjeshme” që kanë përparësinë e rëndësishme për të lejuar një masë mbrojtjeje si e sotmja.¹⁷

Sidoqoftë duhet të thuhet se realizimi i asaj që kërkohet përmes njohjes së një të drejte për mjedis nuk do të ndodhë kurrë plotësisht nëse nuk përfshihet në një strategji më të gjerë. Së pari, ndarja e ngushtë midis degëve të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare nuk është e favorshme për ndërveprime pozitive midis ligjit mjedisor dhe të drejtave të njeriut, çështje

¹⁶ Shih D6jeant-Pons, M., 'Le droit de l'homme i l'environnement, droit fondamental au niveau europ6en dans le cadre du Conseil de l'Europe, et la Convention europdenne de sauvegarde des droits de l'homme et des libert6s fondamentales', Association Europdenne de Droit de l'Environnement, Journe d'etude sur 'le droit de l'homme d l'environnement en droit constitutionnel comparé dans les Etats de la Communautd Europdenne', Douai, 24 novembre 1992, Strasbourg, April 1993 (mimeographed/restricted circulation).

¹⁷ Shih European Court on Human Rights, L6pez Ostra v. Spain, judgment of 23 November, 1994, Series A, Vol. 303-C (No. 41/1993/436/515).

tjetër, në nivelin e KB, është e qartë se pjesa më e rëndësishme e realizimit të së drejtës së mjedisit duhet të bëhet nga agjensitë operative.

Në kontest të deklaratave të lidhur me çështjet e mjedisit, edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për të ju drejtuar gjykatës, është Konventa e Aarhusit, bërë në Danimarkë më 25.06.1998, në preambulë të së cilës thuhet se: “çdo person ka të drejtë të jetojë në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij dhe detyrën si individ dhe në shoqëri, që të mbrojë dhe të përmirësojë mjedisin për të mirën e brezave të sotëm dhe atyre të ardhshëm”.¹⁸

Qëllimi kryesor i konventës së Aarhusit është të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtës së cilitdo që i përket brezave të tanishëm apo të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm për mirëqënien e tij.¹⁹

1.3. Vështrimi i shkurtët historik mbi zhvillimin e të drejtës së mjedisit dhe burimet e saj

Para viteve 1960, e drejta mjedisore nuk ekzistonte si një kategori ligjore diskrete vendase dhe ndërkombëtare. Mbrojtja moderne e mjedisit ka disa rrënjë në ligjet e shekujve XIX për mbrojtjen e shëndetit publik dhe burimeve, si dhe në veprimet ligjore private për dëmet nga ndotja. (Ligji mjedisor ka rrënjë në veprimet private që mbrojnë shfrytëzimin, abuzimin e të drejtave dhe në ligjet e shëndetit publik të shekullit XIX).²⁰ Sidoqoftë para fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekujve XX, nuk pati ndonjë vlerësim të gjërë të idesë se ekosistemet dhe masa ujore dhe ajrore ishin njësi gjeografike që duhet të ishin objekt i një mbrojtje të veçantë juridike.

Ideja e bazuar në shkencë se biosfera ishte një sistem i brishtë i ndjeshëm ndaj dëmtimeve të shkaktuara nga njeriu u pranua gjerësisht pas Luftës së Dytë Botërore, kur ideja fitoi një pranim të gjërë në fund të viteve 1960, mbrojtja ligjore e ajrit, ujit tokës dhe ekosistemeve, të tilla si pyjet, u ndoqën shpejtë veçanërisht në SBHA, Evropë, Australi dhe Zelandë të re. Që atëherë mbrojtja e mjedisit është bërë një element i rëndësishëm i

¹⁸ Konventa e Aarhusit, preambula fq. 2. <https://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>

¹⁹ Paragrafi i 7, i preambulës së Konventës së Aarhusit

²⁰ JE Scott EW Hughes, Ecology, New York 1986, fq. 32

legjislacionit të brendshëm të të gjitha vendeve të zhvilluara si dhe shumë vendeve në zhvillim. Që nga vitet 1980, e drejta mjedisore është bërë gjithashtu një komponent i rëndësishëm dhe evolucionar i së drejtës ndërkombëtare.

E drejta e mjedisit është produkt i mjedisit, i cili mund të përkufizohet afërsisht si një sistem vlerash që kërkon të ripërcaktojë marrëdhëniet e njerëzimit me natyrën. Në mënyrë të veçantë, ambientalizmi kërkon të shtyjë njerëzit të veprojnë si administratorë të natyrës, më tepër shfrytëzues të saj dhe për këtë arsye të respektojnë funksionimin e sistemeve natyrore duke kufizuar aktivitetet që shqetësojnë këto sisteme.

Qëllimi përfundimtar i të drejtës së mjedisit është të ndryshojë sistemin e stimujve të përdorimit të burimeve nga ato që shkaktojnë zhvillim të paqëndrueshëm në ato që shkaktojnë zhvillim të qëndrueshëm mjedisor. E drejta e mjedisit është në thelb një koncept i ri me më shumë ndërprerje sesa vazhdimësi me traditat e kaluara ligjore dhe intelektuale. Shumë nga vlerat e avancuara nga rregulloret mjedisore nuk janë të lidhura me forcimin e dinjitetit njerëzor, mirëqenien e njeriut, mbrojtjen e pronës ose mirëmbajtjen e rendit shoqëror. Përkundrazi, ambientalizmi kërkon të ripërcaktojë rrënjësisht marrëdhëniet midis njerëzve dhe natyrës duke inicuar pjesërisht nismën që të përfitojnë dy bashkësi – ekosistemi dhe gjeneratat e ardhshme, që tradicionalisht nuk kanë pasur personalitet juridik. Si të gjitha fushat në zhvillim të ligjit, ligjet mjedisore janë një miks sistematik, sintetik dhe të paqëndrueshëm të rregullave nga fushat tjerra.

Njerëzit në të gjithë botën në vitet 1990 po e përceptonin tokën si më shumë sesa një glob për tu anketuar, ose zhvilluar për të mirën publike në një afat të shkurtër, ose për tu mbrojtur nga kërcënimet për mirëqenien e saj si njerëzore ashtu edhe natyrore. Të gjitha këto janë deri diku, mirëpo kanë dimensione shtesë. Njerëzit nga kultura të ndryshme e pranojnë përshkrimin shkencor si një material besimi. Ata e njohin angazhimin për tu kujdesur në mënyrë të përhershme, ata pranojnë pa dëshyrë detyrimin për tu pajtuar me problemet që paraqiten nga rritja e numrit dhe oreksit. Kjo nuk është thjeshtë një analizë e pasojave ekonomike dhe

sociale të rregullave të politikave për çështjet mjedisore. Rrënjët janë një sens solemn në rritje i individit si pjesë e një familje njerëzore për të cilën toka është shtëpia e saj shpirtërore.²¹

Nëse e drejta e mjedisit me të drejtë mund të thuhet se është një organ i përhershëm i ligjit që ka një themel të parimeve universale, kjo zhvendosje e vlerës është baza. Ekzistojnë prova të konsiderueshme që parimet thelbësore të ligjeve të mjedisit janë miratuar gjerësisht nga një gamë e gjerë vendesh, ndërsa një anketon ligjet e të gjitha vendeve të botës që e kanë bërë mbrojtjen e mjedisit një përparësi politike, ekziston një uniformitet i konsiderueshëm në objektivat, instrumentet e politikave dhe parimet themelore ligjore. Juristët e mjedisit flasin gjuhën universale juridike, shkencore dhe etike. Arsyeja është e thjeshtë: problemet institucionale që shkaktojnë degradimin mjedisor, ndotje dhe humbje të biodiversitetit janë në thelb të ngjashme në të gjithë botën dhe ndryshimet në përgjigje vijnë më shumë në zbatim sesa në nivelin legjislativ.

Ambientalizmi kërkon të krijojë një marrëdhënie të re midis njerëzve dhe sistemeve natyrore që mbështesin jetën në këtë planet. Prandaj ai kërkon të kthejë një traditë të gjatë mosrespektimi të pasojave të shfrytëzimit, përdorimit dhe konsumit të pakufizuar të burimeve. Nga agimi i historisë njerëzore e deri në fund të shekullit XIX, ligji dhe institucionet shoqërore, të mbështetura nga Judeo-Christian dhe traditat e tjera fetare, vendosën pak kufizime në shfrytëzimin e burimeve natyrore. Shpenzimet mjedisore dhe sociale afatshkurtra dhe afatgjata të shfrytëzimit të shpejtë të burimeve rrallë vlerësohen. Kjo deklaratë duket se është e vërtetë për të dy civilizimet indigjene, Evropën, kolonizimin evropian të Afrikës, Australisë, Amerikës së Veriut dhe Jugut dhe një pjesë më të madhe të Azisë. Është shumë e vërtetë për të dy vendet që njohin pronën private dhe ato që i takojnë pronësisë së burimeve në shtet.

Pamja mbizotëruese që dilte nga mendimi i Judeo-Christian dhe Greek karakterizonte natyrën e pazhvilluar si një depo mallrash të papërpunuara për tu shfrytëzuar dhe transformuar. Babai i etikës mjedisore Aldo Leopold, e lidhi degradimin e mjedisit me teorinë se prona është një marrëdhënie abstrakte, ekskluzive midis personave dhe gjërave sepse kjo komodifikon natyrën. Konservimi (ambientalizmi) nuk po na merr askund sepse është i

²¹ Gilbert F. White, Reflections on Changing Perceptions of the Earth, 1994 Annual Review of Energy and the Environment 19, University of Colorado, Colorado 1994, fq. 48.

papajtueshëm me konceptin tonë Abrahamik për tokën. “Ne abuzojmë me tokën sepse ne e konsiderojmë atë si një send që na përket neve”.²²

1.4. Mbrojtja e mjedisit në nivel ndërkombëtar dhe evropian

Mjedisi është cilësuar si një vlerë themelore e komunitetit ndërkombëtar, mbrojtja e të cilës korrespondon me një interes të të gjithë shteteve dhe njëkohësisht të secilit prej tyre, ashtu sikurse edhe nevojat e tjera parësore të mbarë njerëzimit.²³

Në aspekt ndërkombëtar, krimi mjedisor shpesh është i lidhur me rrjete të tjerra të rënda të krimit të organizuar (lëndët narkotike, trafikimi i qenieve njerëzore dhe armët) dhe korrupsion.

Sipas një raporti të përbashkët të UNEP/INTERPOL në vitin 2018, renditet si aktiviteti i tretë më fitimprurës transnacional në kohën e sotme, menjëherë pas trafikimit me lëndë narkotike dhe falsifikimeve. Nga këto rrjete qarkullojnë deri në 281 miliardë dollarë në të gjithë botën si dhe rritje të fitimeve nga 5 deri në 7% çdo vit.²⁴

Ligjet për mjedisin janë relativisht të reja, ligjvënësit filluan të miratojnë ligjet mjedisore në shekullin XX. Lëvizjet mjedisore filluan të marrin ritmin në vitet 1960 me shumicën e ligjeve dhe rregulloreve mjedisore që u krijuan që nga ajo kohë.²⁵

Një numër i madh aktesh ligjore janë miratuar si në nivel kombëtar, ashtu edhe në ndërkombëtarë me të vetmin qëllim, mbrojtjen e ambientit (mjedisit). Mirëpo që këto ligje ky kuadër më i gjërë ligjor të jetë plotësisht efektiv është më se e nevojshme që të përdoren të gjitha mjetet, ku përfshihet dënimi penal që është më se i nevojshëm në rastet e shkeljeve mjedisore që janë më të rënda dhe me pasoja serioze.

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në rezolutën e parë mbi kontributin e të drejtës penale për mbrojtjen e mjedisit (Rezoluta (77) 28) “aspekte të ndryshme të jetës në

²² A. Dan Tarlock , History of Environmental Law, Chicago-Kent College of Law, USA 2009, fq. 4.

²³ Vllado Kambovski, E drejta penale, 2007 Shkup, fq. 11

²⁴ Jean-Claude BRUNET, 27th OSCE ECONOMIC AND ENVIRONMENTAL FORUM, Prague 12th Sept. 2019 “Strengthening good environmental governance and international cooperation”: The case for preventing and fighting Environmental Crime in the OSCE Region.

<https://www.osce.org/secretariat/429728?download=true>

²⁵ Environmental Law, legal definition “Legal Career Path website”.

<https://legalcareerpath.com/what-is-environmental-law/>

kohën e sotme, posaçërisht zhvillimi industrial, sjell me vehte në mënyrë të domosdoshme një nivel të ndotjes që është i rrezikshëm për komunitetin” dhe se “shëndeti i njerëzve, kafshëve, bimët si dhe ambienti me të gjitha bukuritë duhet të mbrohen me çdo mjet të mundshëm”.²⁶

Ligjet e para për mjedisin ishin të përqëndruara në problemet, kur përdorimi i pasurisë së një personi ndërhyr në shfrytëzimin e pronës të një personi tjetër. Ligjet mbronin një pronar të pasurisë nga një person ose korporatë tjetër që cënonte të drejtën e tyre për t’ua shfrytëzuar pronën. Ligjet e më hershme të mjedisit nuk përqëndroheshin në mbrojtjen e mjedisit në tërësi, ata gjithashtu nuk kanë dhënë qëndrim që një person të padisë një ndotës nëse ata nuk janë dëmtuar personalisht nga veprimet e personit tjetër.

E drejta ndërkombëtare e Mjedisit është e shqetësuar me përpjekjen për të kontrolluar ndotjen dhe varfërimin e burimeve natyrore brenda një kornize të zhvillimit të qëndrueshëm. Është një degë e së drejtës publike ndërkombëtare – një organ ligji i krijuar nga shtetet të qeverisin problemet që lindin midis shteteve.

E drejta ndërkombëtare e Mjedisit mbulon tema të tilla si popullsia, biodiversiteti, ndryshimet klimatike, varfërimi i ozonit, substancat toksike dhe të rrezikshme, ndotja e ujit, ajrit, tokës, detit, ruajtja e burimeve detare dhe dëmtimet nukleare.²⁷

Deklaratat

Dy janë deklaratat kryesore të drejtës ndërkombëtare të mjedisit:

- Deklarata e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Njerëzor (Deklarata e Stokholmit e vitit 1972). Kjo deklaratë përfaqëson një përpjekje të parë të madhe për të konsideruar ndikimin global të njeriut në mjedis dhe një përpjekje ndërkombëtare për të adresuar sfidën e ruajtjes dhe forcimit të mjedisit njerëzor. Deklarata e Stokholmit mbështet kryesisht qëllime dhe politika të gjëra të politikës mjedisore sesa pozicione normale të detajuara. Deklarata si dhe teksti i plotë i Deklaratës.²⁸

²⁶ European commission, Proposal of a directive of the European Parliament and of the Council on the protection of the environment through criminal law, 2007/0022, fq. 6

²⁷ Lakshman D Guruswamy, International Environmental Law in a Nutshell (West, 5th ed, 2017)).

²⁸ Dokumenti i KB A/Conf/48/14.Rev.1 (1972),

- Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin ishte një dokument i shkurtër i prodhuar në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara (UNCED) të vitit 1992, i njohur si Samiti i Tokës në Rio. Deklarata e Rio përbëhet nga 27 parime që synojnë të udhëheqin zhvillimin e qëndrueshëm në të ardhmen në të gjithë botën.²⁹

1.5. Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale në kuadrin e Bashkimit Evropian

Format më serioze të krimit mjedisor shpesh kanë dimension ndërkuftar dhe shume herë përfshijnë grupe kriminale të krimit të organizuar ose persona të korporatave të mëdhaja.

Bashkimi Evropian, në formë direkte ndikohet nga krimet mjedisore si treg i origjinës ose si një destinacion apo si një pikë tranziti midis dy rajoneve të globit.

Këshilli i Evropës më 4 nëntor të vitit 1998, miratoi Konventën për mbrojtjen e mjedisit përmes së drejtës penale.

Konventa ka për qëllim përmirësimin e mbrojtjes që i bëhet mjedisit në nivelin evropian duke përdorur zgjidhjen e fundit të drejtës penale, në mënyrë që të pengojë dhe të parandalojë sjelljen e cila është më e dëmshme për të. Gjithashtu kërkohet harminizimi i legjislacionit kombëtar në këtë fushë.³⁰

Ky instrument i ri ligjor detyron Shtetet Kontraktuese të fusin dispozita specifike në ligjin e tyre penal ose të modifikojnë dispozitat ekzistuese në këtë fushë. Një numër veprash të kryera me dashje ose nga pakujdesia, konventa i përcakton si vepra penale kur ato shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë dëme të qëndrueshme në cilësinë e ajrit, tokës, ujit, kafshëve ose bimëve, ose më keq të rezultojnë në vdekjen ose dëmtimin serioz të ndonjë personi.³¹

Konventa gjithashtu përcakton konceptin e përgjegjësisë penale të personave fizik dhe juridik, specifikon masat që do të miratohen nga shtetet për t'u dhënë mundësi atyre të konfiskojnë pronën dhe të përcaktojnë kompetencat në dispozicion të autoriteteve, dhe parashikon bashkëpunim ndërkombëtar.

²⁹ Dokumenti i KB/A/Conf.151/26 (vël. 1)

³⁰ <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168007f3f4>

³¹ Convention on the Protection of Environment through Criminal Law, ETS No.172, Strasbourg, 04/11/1998
<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/172>

Sanksionet duhet të përfshijnë, sanksion me burgim dhe material.

Një tjetër dispozitë e madhe ka të bëjë me mundësinë që shoqatat e mbrojtjes së mjedisit të marrin pjesë në procedurat penale në lidhje me veprat penale të parashikuara në Konventë.

Bashkimi Evropian gjithashtu ka krijuar edhe një kornizë ligjore për mbrojtjen e mjedisit (Direktiva 2008/99/EC) si dhe mbi ndotjen nga anijet (Direktiva 2009/123/EC). Këto instrumente ligjore përfshijnë një grup gjithëpërfshirës të rregullave minimale që kërkojnë lloje të ndryshme të sjelljes që janë të dëmshme për mjedisin dhe ndihmojnë kriminalizimin.

Direktiva 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit u miratua në tetor të vitit 2008 dhe duhej të transpozohet nga shtetet anëtare deri në dhjetor të vitit 2010.

Direktiva kërkon që shtetet anëtare të trajtojnë si vepra penale veprimtari të caktuara që shkelin legjislacionin e Bashkimit Evropian për mjedisin.

Këto vepra penale përfshijnë dërgesën ilegale të mbeturinave, tregtinë me specie të rrezikuara ose me substanca që shkatërrojnë ozonin, dhe përkeqësimin e ndjeshëm të habitateve të jetës së egër që bëjnë pjesë në rrjetin e vendeve të mbrojtura Natura 2000. Për më tepër dëmi i konsiderueshëm në mjedi i shkaktuar nga emetimet e paligjshme në ajër, ujë ose tokë, funksionimi i paligjshëm i veprimtarive të rrezikshme (përfshirë prodhimin ose trajtimin e materialeve bërthamore) ose trajtimin e paligjshëm të mbeturinave do të konsiderohen gjithashtu vepra penale.³²

Shtetet anëtare do të duhet ti nënshtohen këtyre veprave penale të dënimeve penale efektive, dekurajuese dhe proporcionale. Ata gjithashtu duhet të sigurojnë që kompanitë mund të mbajnë përgjegjësi për veprat penale të kryera nga individë, por nga të cilat përfitojnë.

Direktiva 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal përmban rregulla minimale që kërkojnë kriminalizimin e sjelljes së paligjshme që shkakton ose ka të ngjarë ose supozohet se shkakton dëme në mjedisin jetësor ose jetën e qënieve që jetojnë në atë mjedis³³. Sjellja përcaktohet si e paligjshme kur shkel legjislacionin e Bashkimit Evropian të listuar në një

³² https://ec.europa.eu/environment/legal/crime/legis_en.htm

³³ Directive 2008/99/EC of the European Parliament and of the Council of 19 November 2008 on the protection of the environment through criminal law.

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32008L0099>

nga shtojcat e Direktivës ose një vendim administrativ që jepet efektin e këtij legjislacioni. Sjellja e tillë duhet të kriminalizohet kur kryhet me dashje ose nga pakujdesia serioze. Kërkohej që personat juridik të mbajnë përgjegjësi për vepra të tilla penale. Përgjegjësia e personave juridik mund të jetë e natyrës penale ose tjetër. Veprat penale duhet të jenë të dënueshme me dënime penale efektive, proporcionale dhe shpërndarëse.

Direktiva nuk përmban kërkesa më të hollësishme për llojet dhe nivelet e dënimeve.

Dokument tjetër i rëndësishëm është edhe Direktiva 2005/35/EC mbi ndotjen e burimeve të anijeve dhe Direktiva 2009/123/EC për ndryshimet në Direktivën 2005/35/EC mbi ndotjen e burimeve të anijeve dhe vendosjen e dënimeve për shkelje, përmban rregulla minimale që kërkojnë kriminalizimin e shkakimeve nga burimet e anijeve të substancave ndotëse në ujëra³⁴. Shkakimet e paligjshme që bëhen nga anijet me substanca ndotëse duhet të konsiderohen si vepër penale për sa kohë që ato janë kryer me dashje, në mënyrë të shkujdesur ose me pakujdesi serioze dhe që rezultojnë në ndotje përkeqësim të cilësisë së ujit. Rastet e përsëritura, më pak serioze të shkakimeve të paligjshme nga anijet të substancave ndotëse, të cilat sjellin në ndotje të ujit dhe ndikojnë në cilësinë e ujit duhet të konsiderohen si vepra penale. Kërkohej që personat juridik të mbajnë përgjegjësi për vepra të tilla penale. Përgjegjësia e personave juridik mund të jetë e natyrës penale ose tjetër. Veprat penale duhet të jenë të dënueshme nga një person përgjegjës, proporcionale dhe gjobotje.

Edhe kjo direktivë nuk përmban kërkesa më të hollësishme për llojet dhe nivelet e dënimeve.

1.6. Mbrojtja e mjedisit sipas legjislacionit të brendshëm të Republikës së Maqedonisë

Si një nga pjesët më të rëndësishme sociale, mjedisi në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar ndiqet dhe rregullohet me ligj dhe me një seri aktesh tjerra ligjore, si dhe nga konventat, deklaratat dhe protokollet ndërkombëtare.

³⁴ Directive 2009/123/EC of the European Parliament and of the Council of 21 October 2009 amending Directive 2005/35/EC on ship-source pollution and on the introduction of penalties for infringements.

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32009L0123>

Duke u nisur nga rëndësia e një mjedisi të shëndetshëm si një e drejtë e njeriut, por edhe detyrim, në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, e cila është akti më i lartë shtetëror-juridik, mjedisi përkufizohet si një vlerë themelore.

Në nenin 8 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, mjedisi përcaktohet si një vlerë dhe e drejtë që duhet të promovohet dhe të mbrohet, duke promovuar që rregullimi i humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe promovimi i mjedisit dhe natyrës është një vlerë themelore e Republikës së Maqedonisë.³⁵ “Të gjithë kanë të drejtë për një mjedis të shëndetshëm. Secili është i detyruar që të promovojë dhe të mbrojë mjedisin dhe natyrën. Republika siguron kushte për ushtrimin e të drejtës së qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm”.³⁶

Përveç përkufizimeve kushtetuese për mjedisin, aktet tjerra ligjore që shtjellojnë çështjet, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Maqedonisë janë:

1.6.1. Ligji për mjedisin jetësor

Ky ligj rregullon të drejtat dhe obligimet e Republikës së Maqedonisë, komunës, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, si dhe të drejtat dhe detyrat e personave juridik dhe fizik, në sigurimin e kushteve për mbrojtje dhe përmirësim të mjedisit, për shfrytëzim të të drejtës së qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm.³⁷

Ligji për mjedisin jetësor ka për qëllim të mbrojë dhe përmirësojë cilësinë dhe gjendjen e përbërësve të mjedisit: tokën, ujin, ajrin. Përveç parashikimeve të këtij ligji, dispozitat e Ligjeve për përbërësit e mjedisit dhe ligjet mjedisore do të zbatohen edhe për fushat e mjedisit, biodiversitetit dhe burimeve të tjera natyrore, si dhe mbrojtjen e shtresës së ozonit dhe mbrojtjen nga ndikimi negativ i njeriut në sistemin klimatik.

Sipas Ligjit, mjedisi përcaktohet si hapësira e të jetuarit i të gjitha organizmave të gjallë dhe burimeve natyrore, vlerat natyrore dhe të kryjuara, marrëdhëniet e tyre të ndërsjellta dhe

³⁵ Kushtetuta e RM-së, neni 8

³⁶ Kushtetuta e RM-së, neni 43

³⁷ Ligji për mjedisin jetësor të RM-së, neni 3

hapësira totale në të cilën jeton njeriu dhe në të cilën gjenden vendbanimet, mallrat në përdorim të përgjithshëm, objektet industriale dhe të tjera.

Ndotja e ambientit jetësor është emetimi i ndotësve dhe substancave, që vjen si rezultat i veprimtarisë njerëzore, në ajër, ujë ose tokë, të cilat mund të jenë të dëmshme për cilësinë e ambientit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut ose emetimit të ndotësve dhe substancave të cilat mund të sjellin dëme në pronë ose të ndikojnë në diversitetin biologjik dhe peisazhit.

Mbrojtja e mediave (përbërësve) të mjedisit dhe zonave të caktuara të mjedisit arrihet duke marrë masa dhe aktivitete në lidhje me mbrojtjen nga efektet e dëmshme të përcaktuara nga ky speciale tjerra për:³⁸

- kryerjen e aktiviteteve të ndryshme;
- substancat ndotëse dhe teknologjitë;
- mbeturinave;
- zhurma dhe dridhjet, dhe
- rrezatimi jonizues dhe jo-jonizues

1.6.2. Ligji për mbrojtjen e natyrës

Natyra në kuptimin e këtij ligji përcaktohet si biosfera totale, duke përfshirë: përbërësit e biodiversitetit, habitatet, formacionet gjeologjike, mineralet dhe fosilet si dhe fenomenet e tjera fiziko-gjeografike në tokë.

Ky ligj rregullon mbrojtjen e natyrës duke mbrojtur diversitetin biologjik dhe peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, në zonat e mbrojtura dhe zonat e pa mbrojtura si dhe mbrojtjen e cilësive të rralla të natyrës.³⁹

Mbrojtja e biodiversitetit arrihet përmes krijimit dhe zbatimit të një sistemi masash dhe aktiviteteve për mbrojtjen e specieve të egra, përfshirë materialin e tyre gjenetik, habitatet dhe ekosistemet, në mënyrë që të sigurohet përdorimi i qëndrueshëm i përbërësve të biodiversitetit dhe ruajtja e ekuilibrit natyror.

³⁸ Ligji për mjedisin jetësor të RM-së, neni 2, paragrafi 2

³⁹ Ligji për mbrojtjen e natyrës i RM-së (tekst i konsoliduar), neni 1

Mbrojtja e diversitetit të peisazhit arrihet përmes vendosjes dhe zbatimit të një sistemi masash dhe aktiviteteve për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave karakteristike të peisazhit që lindin nga konfigurimi i tij natyror ose lloji i veprimtarisë njerëzore.

Mbrojtja e trashëgimisë natyrore realizohet përmes krijimit të një sistemi që përcakton masat, procedurat dhe metodat për fitimin e statusit të trashëgimisë natyrore dhe zbatimin e mbrojtjes së tij.

Mbrojtja e cilësive të rralla të natyrës arrihet përmes krijimit të një sistemi që përcakton masat, procedurën dhe metodat e deklarimit të rrallësisë natyrore dhe zbatimin e mbrojtjes së tij.

Qëllimet e këtij ligji janë:⁴⁰

- përcaktimin dhe monitorimin e gjendjes së natyrës;
- rruajtja dhe rivendosja e diversitetit ekzistues biologjik dhe peisazhit në një gjendje ekuilibri natyror;
- krijimin e një rrjeti të zonave të mbrojtura për shkak të mbrojtjes së përhershme të pronave në bazë të të cilave ata kanë fituar statusin e trashëgimisë natyrore;
- duke siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në interes të zhvillimit aktual dhe të ardhshëm, pa dëmtuar ndjeshëm pjesët e natyrës dhe duke minimizuar kështu çrregullimet e ekuilibrit natyror;
- parandalimin e veprimtarive të dëmshme të personave fizik dhe juridik dhe shqetësimet në natyrë si pasojë e zhvillimit teknologjik dhe kryerjes më të favorshme për mbrojtje dhe zhvillim të natyrës, dhe
- sigurimi i të drejtës së qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm.

Mbrojtja realizohet me:

- përcaktimin e përbërësve të diversitetit biologjik dhe peisazhit dhe kërcënimi i tyre;
- krijimin e kushteve dhe marrjen e masave për mbrojtjen e natyrës me qëllim ruajtjen dhe menaxhimin racional të disa përbërësve të diversitetit biologjik dhe peisazhit;
- planifikimi hapësinor dhe aranzhimi;

⁴⁰ Ligji për mbrojtjen e natyrës i RM-së (tekst i konsoliduar), neni 3

- përfshirja e kushteve dhe masave për mbrojtjen e pasurisë natyrore në planet për menaxhimin e pasurisë natyrore në aktivitetet e caktuara ekonomike.
- Miratimin dhe zbatimin e strategjive, programeve, planeve të veprimit, planeve të menaxhimit, kushteve dhe masave për mbrojtjen e ambientit.

1.6.3. Ligji për ujërat

Ky ligj rregullon, çështje që lidhen me ujërat sipërfaqësorë, përfshirë këtu edhe burimet e përhershme ujore ose burimet ujore në të cilat here pas here rrjedhin ujërat, liqenet, rezervuaret dhe burimet, ujërat nëntokësorë, tokat bregdetare dhe habitatet ujore dhe administrimin e tyre, përfshirë edhe shpërndarjen e ujit, mbrojtja dhe ruajtja e ujit si dhe mbrojtja nga efektet e dëmshme të ujit dhe financimin menaxhimin e ujërave si dhe kushtet, mënyra dhe procedurat në të cilat uji mund të shfrytëzohet.⁴¹

Ky ligj rregullon masat për shmangien, parandalimin ose zvogëlimin e efekteve të dëmshme të ndotjes së ajrit të ambientit në shëndetin e njeriut si dhe mjedisin në tërësi, duke vendosur kufijtë dhe vlera të synuara për cilësinë e ajrit të ambientit. Krijimin e një sistemi të vetëm për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së ajrit dhe monitorimin e burimeve të emisioneve të ndryshme në ajër. Mbrojtjen nga aktivitete të caktuara të personave juridik dhe fizik të cilët kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në cilësinë e ajrit të ambientit.

1.6.4. Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit

Ajri i ambientit në këtë ligj përcaktohet si ajri i jashtëm në troposferën e poshtme, me përjashtim të ajrit në mjedisin e punës.

Dispozitat e këtij ligji i referohen ajrit të ambientit përveç ndotjes së ajrit të ambientit të shkaktuar nga substance radioaktive, zhurma dhe katastrofa natyrore si dhe ndotjen e ajrit në mjedisin e punës.⁴²

Qëllimet e këtij ligji janë:⁴³

⁴¹ Ligji për ujërat i RM-së (tekst i konsoliduar), neni 1

⁴² Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit i Republikës së Maqedonisë, neni 2

- shmangia, parandalimi dhe zvogëlimi i efekteve të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe mjedisin në tërësi, përfshirë biodiversitetin, burimet natyrore dhe trashëgiminë historike dhe kulturore;
- sigurimi i informacionit të duhur për cilësinë e ajrit të ambientit;
- parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes që shkakton ndryshimin e klimës, dhe
- ruajtja e cilësisë së ajrit të ambientit aty ku është cilësor dhe në rastet tjera të përmirësohet.

1.6.5. Ligji për menaxhimin e mbeturinave

Ligji për menaxhimin e mbeturinave rregullon menaxhimin e mbeturinave, parimet dhe objektivat e administrimit të mbeturinave, planet dhe programet e administrimit të mbeturinave, të drejtat dhe detyrimet e personave juridik dhe fizik në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, kërkesat dhe detyrimet e personave juridik dhe individëve që prodhojnë produkte dhe ambalazhe dhe që në fund të ciklit jetësor rëndojnë mjedisin. Rregullon mënyrën dhe kushtet në të cilat mund të bëhet mbledhja, transportimi, trajtimi, depozitimi, përpunimi dhe deponimi i mbeturinave. Gjithashtu me këtë ligj rregullohet edhe importi dhe eksporti dhe tranzitimi, bartja e mbeturinave, monitorimi, sistemi i informacionit, financimi dhe mbikëqyrja e menaxhimit të mbeturinave.⁴⁴

Dispozitat e këtij ligji u referohen të gjitha llojeve të mbeturinave të përmendura më lartë, përveç:⁴⁵

- mbetjeve radioaktive;
- mbetjeve të krijuara gjatë eksplorimit, shfrytëzimit, përpunimit dhe ruajtjes së burimeve minerale dhe punimeve të guroreve;
- gazrat e lëshuar në atmosferë;
- ujërat e zeza, me përjashtim të mbeturinave të lëngshme;

⁴³ po aty, neni 2

⁴⁴ Ligji për menaxhimin e mbeturinave i RM-së (tekst i konsoliduar), neni 1

⁴⁵ po aty, neni 2

- mbeturinat e kafshëve (kufomat, plehurat organike etj.) si dhe llojet e tjera të materialeve të padëmshme me origjinë natyrore, të cilat mund të përdoren në bujqësi, dhe
- mbetjet nga mjetet eksplozive të deaktivizuara.

Qëllimet e këtij ligji janë që të sigurojnë:⁴⁶

- shmangien dhe në masën më të madhe të mundshme zvogëlimin e sasive të mbeturinave të krijuara;
- përdorimi i përbërësve të mbeturinave të shfrytëzueshme;
- zhvillimi i qëndrueshëm, duke ruajtur dhe kursyer burimet natyrore;
- parandalimi i efekteve të dëmshme të mbeturinave në mjedis, jetë dhe shëndet;
- depozitimi i mbeturinave, në një mënyrë të pranueshme për mjedisin, dhe
- shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit, jetës dhe shëndetit.
-

1.6.6. Ligji për Energjetikë

Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë:⁴⁷

- furnizimin e sigurt dhe cilësor me energji dhe energen të konsumatorëve;
- krijimin e një sektori të energjisë efikase, konkurruese dhe financiarisht të qëndrueshme;
- inkurajimin e konkurrencës në tregjet e energjisë duke respektuar parimet e mosdiskriminimit, objektivitetit dhe transparencës;
- integrimin e tregjeve të energjisë në Republikën e Maqedonisë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare të energjisë në përputhje me detyrimet e marra me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare;
- rritjen e efikasitetit të energjisë dhe inkurajimin e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, dhe

⁴⁶ Ligji për menaxhimin e mbeturinave (tekst i konsoliduar), neni 3

⁴⁷ Ligji për Energjetikë i Republikës së Maqedonisë, neni 2

- mbrojtja e mjedisit nga ndikimet negative në kryerjen e aktiviteteve të caktuara në fushën e energjetikës.

Ky ligj rregullon:⁴⁸

- objektivat e politikës energjetike dhe mënyrat e zbatimit të saj;
- aktivitetet e energjisë dhe mënyra e rregullimit të veprimtarive energjetike;
- statusin dhe kompetencën e Komisionit Rregullator të Energjetikës të RM-së;
- tregun e energjisë elektrike, tregun e gazit natyror, tregun e naftës së përpunuar, derivatet e naftës dhe karburantët për transport;
- kushtet për arritjen e efikasitetit të energjisë dhe promovimin e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, dhe
- çështje të tjera të energjetikës.

1.6.7. Ligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht

Sipas këtij ligji, një organizëm i gjallë përcaktohet si “çdo entite biologjik i aftë të kopjojë ose transmetojë materiale gjenetike”, ndërsa një organizëm i gjallë i modifikuar gjenetikisht është “çdo organizëm i gjallë që posedon një kombinim të pazakontë të materialit gjenetik të marrë nga aplikimi i bio teknologjisë dhe është i aftë të “shumohet”.⁴⁹

Ky ligj rregullon menaxhimin e organizmave të modifikuar gjenetikisht dhe një kombinim të organizmave të modifikuar gjenetikisht dhe produkteve që përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe një kombinim të organizmave të modifikuar gjenetikisht dhe produkteve që përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht ose përbëhen ose burojnë nga një kombinim i organizmave të modifikuar gjenetikisht, duke përfshirë organizmat e modifikuar gjenetikisht si një produkt, në nenin 4 të këtij ligji.

⁴⁸ Ligji për Energjetikë i RM-së, neni 3

⁴⁹ Ligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht i RM-së, neni 1

1.6.8. Ligji për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor

Ky ligj rregullon të drejtat dhe detyrimet e Republikës së Maqedonisë, komunës, qytetit të Shkupit, komunave në qytetin e Shkupit, si dhe rregullon të drejtat dhe detyrimet e personave fizik dhe juridik, në raport me menaxhimin me zhurmën në mjedisin jetësor dhe mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor.⁵⁰

Qëllimet e këtij ligji janë:⁵¹

- krijimin e kushteve të shëndetshme të jetesës dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor nga zhurma
- masat dhe aktivitetet për të shmangur, parandaluar apo ulur zhurmën.
- Marrjen e masave për mbrojtjen e zhurmës të imponuar nga mjedisi dhe shkaktimi i shqetësimeve dhe ngacmimeve
- Largimin apo zvogëlimin e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj zhurmës në media dhe mjedis duke siguruar një bazë për zhvillimin e masave për uljen e zhurmës të emetuar nga burime më të mëdha, posaçërisht automjetet rrugore, hekurudhore dhe ujore si dhe infrastruktura, avionët etj.

⁵⁰ Ligji për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor në RM, neni 1

⁵¹ Ligji për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor në RM, neni 2

Kapitulli II

KARAKTERISTIKAT E VEPRAVE PENALE KUNDËR MJEDISIT

2.1. Vështrime hyrëse për veprat penale kundër mjedisit

Për rëndësinë e madhe që ka ruajtja e mjedisit jetësor, është e siguar edhe me kushtetutë dhe sanksionohet me ligj.

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, në nenin 218 ka paraparë si vepër penale ndotjen e ambientit jetësor, në nenin 219, ndotjen e ujit të pijshëm si dhe në nenin 226 prerjen e pa ligjëshme të pyjeve, rrezikimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina e parasheh në nenin 230, ndërsa transportimin e materialeve të rrezikshme në vend e rregullon me nenin 232 të Kodit penal të RM-së.⁵²

Në vitin 2005 Republika e Maqedonisë, ka nxjerrë edhe Ligjin për mjedisin jetësor, me anë të së cilit rregullohen të drejtat dhe obligimet e RM-së, të komunave si dhe të drejtat dhe obligimet e personave fizik dhe juridik në sigurimin e kushteve për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor, për të drejtën e shtetasve për mjedis të shëndetshëm jetësor.

2.2. Llojet e veprave penale kundër mjedisit jetësor

Sipas Legjislacionit të Republikës së Maqedonisë, vepra penale kundër mjedisit jetësorë llogariten veprat si në vijim:

- Ndotja e ambientit jetësor
- Ndotja e ujit të pijshëm
- Prerja e paligjshme e pyjeve
- Cënimi i mjedisit jetësor me hedhurina
- Transportimi i materieve të rrezikshme në vend
- Uzurpimi i paluajtshmërive
- Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale
- Gjuetia e paligjshme

⁵² Kodi Penal i RM-së, (tekst i përpunuar) Afrim Osmani, 2010

- Peshkimi i paligjshëm
- Mundimi i kafshëve

2.2.1 Ndotja e ambientit jetësor

Mjedisi jetësor nënkupton hapësirën, ambientin, të gjitha të mirat natyrore dhe me organizma të gjalla që jetojnë në të, vlera natyrore të trashëguara dhe të krijuara, hapësirën e përgjithshme në të cilën jeton njeriu dhe në të cilën janë të vendosura vendbanimet, të mirat në shfrytëzim të përgjithshëm, të gjitha objektet industriale dhe të tjera, duke përfshirë edhe lëmejtë dhe rajonet tjerra të mjedisit jetësor (neni 5 i Ligjit për mjedisin jetësor).⁵³

Ajri, uji dhe sipërfaqet ujore janë objekte të mbrojtjes me ndotjen e të cilave çënohet jeta apo shëndeti i njeriut.⁵⁴

Ndotja e ajrit, ujit dhe sipërfaqeve ujore janë të dënueshme nëse nuk respektohen dispozitat e caktuara për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor si dhe shkaktimin e rrezikut për jetën dhe shëndetin e njeriut apo shkatërrimin e botës shtazore dhe të mjedisit që na rethon (neni 1 i Ligjit për mjedisin jetësor).

Ndotja e ajrit bëhet përmes çlirimit të gazrave të ndryshëm, çlirimit të tymit dhe lëndëve tjerra të papërpunuara që mund të ndikojnë dhe të rrezikojnë dukshëm shëndetin e njeriut dhe të mjedisit jetësor.

Emetimi i ndotjes në ajër vjen nga aktivitetet e njerëzve ekonomike dhe sociale siç janë: industria, transporti, amvisëritë, djegiet dhe instalimet energjetike, deponitë për grumbullimin e mbeturinave (veçanërisht deponitë e egra). Djegia nga amvisëritë siç është djegia e lëndëve djegëse të ngurta (druri dhe qymyri) janë burim i rëndësishëm i grimcave të ngurta që emitohen direkt si dhe hidrokarbureve aromatike policiklike (PAHs), të cilat bien në llojin e substancave kancerogjene. Aktivitet bujqësorë janë indikator që lëshojnë amoniak (NH₃), i cili ndikon direkt në shëndetin e njeriut dhe në ekosistem.⁵⁵

Sipas të dhënave të EEA dhe OBSH, shkaktar të reth 400,000 vdekjeve në botë, fatkeqësisht shkaktohen nga ajri i ndotur. Sipas këtij raporti të Agjencisë Evropiane të Mjedisit

⁵³ Shih nenin 5 të Ligjit për mjedisin jetësor të RMV-së

⁵⁴ Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, Tetovë 2007, fq. 105

⁵⁵ Jordan, AJ Seen, GE Jacobsen - Atmospheric Environment, Elsevier 2006, fq. 81

për ndotjen e ajrit në Evropë, Republika e Maqedonisë renditet më keq në të gjithë vendet e Evropës, me ajrin më të ndotur në qytetet, Shkup, Tetovë, Manastir të cilët janë edhe ndër 10 qytetet më të ndotura në Evropë.⁵⁶

Statistikat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë tregojnë se ndotja e ajrit është shkaktari kryesor i mbi 1300 vdekjeve në vit dhe një numër në rritje i njerëzve me sëmundje të frymëmarrjes.

Analiza e realizuar nga Banka Botërore, tregon se ndotja e ajrit kushton shtetin rreth 2.5% të PBB vjetore për shërbime shtesë të kujdesit shëndetësor, përkatësisht 300 milionë euro në vit.

Në Republikën e Maqedonisë, ndotja e ajrit 10 vitet e fundit është shumë e theksuar dhe indikator për këtë janë shumë faktor, që vendi jonë të renditet në top 10 vendet me ajrin më të ndotur në botë. Në disa periudha kohore disa qytete të RM-së në këto renditje kanë zënë vendin e parë (qyteti i Shkupit), përkatësisht vendin e dytë dhe të tretë (Tetova).⁵⁷

Faktorë që ndikojnë në ndotjen e ambientit jetësor, përkatësisht ajrit në RM-së janë të shumtë mirëpo unë do të ju paraqes disa prej tyre:

- Ndotja që vjen nga fabrikat prodhuese të cilët nuk respektojnë rekomandimet e inspektoriatit ekologjik në kuadër të Ministrisë së ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor dhe rrezikojnë jetën e qytetarëve duke mos vënduar filtrat përkatës dhe duke lëshuar në ajër tym dhe gazra të dëmshme.
- Indikator tjetër që ndikon në rritjen enorme të ndotjes është edhe infrastruktura rrugore dhe përqëndrimi i komunikacionit vetëm në disa rrugë qendrore, e theksuar më shumë në vendbanimet e pjesës perendimore të vendit, përktësisht në Tetovë.
- Veturat me standard më të ulët ekologjik janë në numër më të madh në Republikën e Maqedonisë, këto vetura llogariten në top 5 ndotësit më të mëdhenjë të ajrit në vend.
- Analizat tjerra tregojnë se modelimi i shkarkimeve të substancave ndotëse si rrjedhojë e ngrohjes dhe lëndës djegëse që përdoret për ngrohje janë indikator i madh për ndotjen dhe lëshimin e substancave ndotëse siç janë grimcat PM2.5 dhe PM10.

⁵⁶ EEA - Air quality in Europe — 2014 report, Luxembourg.

<https://www.eea.europa.eu/publications/air-quality-in-europe-2014>

⁵⁷ Qeveria e RM-së (raport vjetor), Programi për reduktimin e ndotjes, Shkup 2018, fq. 2

- Deponitë ilegale dhe mbeturinat, djegia e tyre dhe kapacitetet industriale, mosrespektimi i rregullave gjatë ndërtimit, trafiku dhe ngritja e pluhurit nga sipërfaqet e shumta të pashqetësuarra e plotësojnë kompleksitetin e sfidës e vështirësojnë procesin dhe zgjidhjen e tyre.

2.2.2. Ndotja e ujit të pijshëm

Mungesa e burimeve të ujit të pijshëm, të pastër po bëhet një nga problemet thelbësore të shekullit XXI. Njerëzimi nvaret nga uji, sepse ne jo vetëm që e shfrytëzojmë për pije dhe është i nevojshëm për mbijetesën tonë, por ai përdoret edhe për prodhimin e energjisë, prodhimet në industri si dhe në bujqësi.⁵⁸

Në ditët e sotme, përkundër faktit se po jetojmë në një “planet të kaltërt”, sasi të ujit të pijshëm po zvogëlohen, prandaj ruajtja e tij është shumë e rëndësishme. Çdo formë e ndotjes ose vjedhjes ose ndonjë aktiviteti të paligjshëm kundër burimeve ujore është një formë e rëndë e krimit.

Ndërgjegjësimi i “botës” për krimet kundër mjedisit është duke u rritur në nivel ndërkombëtar, veprat penale kundër ujit janë akoma një çështje që shfaqet. Veprat të tilla kanë ndikime të konsiderueshme, megjithëse informacionet janë shumë të fragmentuara. Uji është burimi mjedisor që dëmtohet nga një vepër e tillë siç është ndotja e ujit të pijshëm, ndotja e ujit në sipërfaqe, apo lloji tjetër i këtyre krimeve siç është raportimi jo i drejtë, mashtrues për cilësinë e ujit të pijshëm. Objekt i këtyre veprave mund të jenë, vjedhja e ujit të pijshëm ose korrupsioni nga ana e ndërrmarjeve që lidhen me kontrollin/shfrytëzimin ekonomik të ujit, ose mjete të krimit siç mund të jetë përmbytja me dashje ose helmimi i qëllimshëm i furnizimit me ujë. Gjithashtu mundet të ketë kërcënime penale për infrastrukturën e administrimit të ujërave.

Në vazhdim të formës së përzgjedhur nga ligjëvenësit në vendin tonë mbi mbrojtjen penale të mjedisit nga ndotja, në nenin 219 të Kodit Penal parashihet një vepër tjetër e ndotjes e cila i kushton rëndësi të madhe mbrojtjes së ujit të pijshëm dhe e parasheh si në vijim:

⁵⁸ Katja Eman, Criminal Law, Criminology, Human Ecology, Environmental interactions, Ljubljana 2014, fq. 44

Ai i cili me ndonjë materie ose në çfarëdo forme do të bëjë të përdorshëm ujin për pije të pusit, burimit, rezervuarit të ujit, cisternës ose ndonjë ujë tjetër të pijshëm, do të merr dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet (Kodi Penal i RM-së, neni 219).⁵⁹

Nëse për shkak të veprës penale nga paragrafi 1 ka ardhur deri te paraqitja e ndonjë epidemie të sëmundjeve ngjitëse, kryerësi i kësaj vepre do të dënohet me burgim prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet.

Siç mund të shihet nga përmbajtja e paragrafit të parë të dispozitës ligjore, veprat kundër ujit të pijshëm kanë për objekt të tyre marrëdhëniet juridike të vëndosura për të siguruar dhe mbrojtur ujërat e pijshëm.

Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë çdo individ, person që ka moshën për përgjegjësi penale dhe që është i përgjegjshëm dhe ka shkelur dispozitat e mbrojtjes së ujit të pijshëm nga ndotja.

Mbrojtja e ujërave në përgjithësi, burimeve të ujit dhe ujit të pijshëm në veçanti në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ndotja është objekt i një kuadri ligjor më të gjerë për ujërat në përgjithësi, i cili përfshin edhe ligjin bazë “Ligjin për ujërat”.

Uji është bazë e një zhvillimi të qëndrueshëm. Burimet e ujit ndikojnë dukshëm në uljen e varfërisë si dhe rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë e mjedisit. Uji kontribuon në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe zhvillimin gjithëpërfshirës, që ndikon në kushtet e jetës së njerëzve në të gjithë botën.⁶⁰

Sipas të dhënave nga ISHP, qasja në ujë të pijshëm në Republikën e Maqedonisë është 90%, dhe kategorizon shtetin në grupin e vendeve të botës me qasje të dukshme, gjë kjo që nuk e zvogëlon angazhimin e vendit për përmirësimin e mëtutjeshëm që qasjes në ujë të pijshëm deri në 97% deri në fund të vitit 2020.⁶¹

Në vijim do të ju paraqesim mostrat e ujit të pijshëm në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2002 – 2014⁶²:


⁵⁹ Kodi Penal i RMV-së, neni 219

⁶⁰ Instituti i shëndetit publik të RMV-së, Dita botërore e ujit – Uji dhe zhvillimi i qëndrueshëm

⁶¹ <http://iph.mk/wp-content/uploads/2015/03/Flaer-A4-AL.pdf>

⁶² Instituti i Shëndetit Publik i RM-së, të dhëna statistikore për ujin e pijshëm 2002-2014

Grafikoni nr. II/1



Sipas të dhënave të Institutit të Shëndetit Publik, të paraqitura në grafikonin më lartë mund të shihen se 90% e mostrave të ujit të pijshëm rezultojnë se uji është i pijshëm, një përqindje e vogël rezulton bakterial i dëmtuar, ndërsa rreth 10% të mostrave të ujit rezultojnë në përmbajtje me materie kimike.

2.2.3. Prerja e paligjshme e pyjeve

Prerja e paligjshme e pyjeve, nënkupton prerjen, përpunimin, transportimin, blerrjen ose shitjen e drunjëve në kundërshtim me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo ka një ndikim shkatërrues në disa nga pyjet e mbetura dhe shumë të vlefshme në botë, si dhe mbi njerëzit që jetojnë në to dhe mbështeten në burimet që sigurojnë pyjet.⁶³

Prerjet e paligjshme të pyjeve minojnë legjitimitetin e sektorit të pyjeve dhe pengojnë përpjekjet e qeverive për të zbatuar një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve.

Kodi Penal i RM-së, veprat penale të prerjes së paligjshme të pyjeve, i përfshinë në pjesën e veprave më të rrezikshme dhe shumë të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit, këto vepra kanë rritje të madhe në numër vitet e fundit.

⁶³ Shih Ligjin për pyjet "Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 64/09

Vepra penale e prerjes së pyjeve ka objekt të mbrojtjes sigurimin, mbrojtjen e pyjeve në aspektin social dhe atë ekonomik.

Nga pjesa objektive, këto vepra kryhen me veprime aktive që shfaqjen në prerjen e paligjshme të pyjeve, prerjen pa lejen përkatëse të organeve kompetente.⁶⁴

Subjekt të veprave penale të prerjes së paligjshme të pyjeve mund të jetë çdo person i moshës madhore me përgjegjësi penale dhe që është i përgjegjshëm, i cili ndërmerr veprim dhe pret pyjet apo dëmton ato pa leje.

Është shumë e vështirë që të vlerësohet shkalla e prerjeve të paligjshme të pyjeve si dhe dëmet që vijnë nga ajo.

Banka Botërore vlerëson se qeveritë në të gjithë botën humbasin mes 10-15 miliardë dollarë çdo vit si rezultat i prerjeve të paligjshme të pyjeve, para këto që mund të shpenzohen për të përmirësuar jetën e njerëzve në përgjithësi.⁶⁵

Në vijim do të ju paraqesim pamje të pyjeve që shkatrohen në Indonezi, me qëllim të konvertimit të tokës pyllore në tokë pjellore, duke prerë të gjitha pyjet për të shfrytëzuar tokën për qëllime të tjera⁶⁶:



Në këtë fotografi shfaqen pamjet e tokës pyjore që po pastrohet dhe shfrytëzimi i saj për qëllime të tjera, në Indonezi, Aceh-u Jugor. *Fotografia: Getty image.*

⁶⁴ Prof. Dr. Ismail Zejneli, E drejta Penale, pjesa e posaçme, Tetovë 2007, fq. 107

⁶⁵ Justice for Forests Improving Criminal Justice Efforts to Combat Illegal Logging, Marilyne Pereira Goncalves, Melissa Panjer, Theodore S. Greenberg, William B. Magrath, World Bank Study, Washington DC 2012, fq. 7

⁶⁶ <https://www.chathamhouse.org/expert/comment/forest-governance-how-indonesia-and-vietnam-are-responding-illegal-logging>

Hulumtimet e fundit identifikojnë shndërrimin e paligjshëm të pyjeve në shfrytëzim të tokës bujqësore si një nga nxitësit kryesorë të shpyllëzimit në të gjithë botën, mbi 20 milion hektarë pyje janë konvertuar në mënyrë të paligjshme nga viti 2000 deri në 2012. Sa i përket shpërndarjes hapësinore rajonet më të shpyllëzuata në të gjithë botën ishin Brazili dhe Indonezia, që përbënin 75% të tokave pyjore tropikale.⁶⁷

Politika e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e pyjeve dhe për të luftuar prerjet e paligjshme si dhe tregëtinë me pyjet, u përcaktua që në vitin 2003 me Planin e Veprimit FLEGT, të cilat së bashku përmbajnë gati 60% të pyjeve në botë dhe furnizojnë një pjesë të madhe të drurit që tregëtohet ndërkombëtarisht, këto janë Afrika Qendrore, Rusia, Amerika Jugore dhe Azia Juglindore. Plani i Veprimit FLEGT përfshin masat e ofertës dhe kërkesën për të adresuar prerjet ilegale dhe është miratuar nga Këshilli i Ministrave të BE-së në nëntor të vitit 2003.⁶⁸

Plani i veprimit FLEGT ka çuar në dy pjesë kryesore të legjislacionit:

1. Rregullorja FLEGT e miratuar në vitin 2005, lejon kontrollimin e të gjitha drunjve që futen në BE nga vendet që kanë marrëveshje bilaterale të partneritetit vullnetar FLEGT (VPA) me BE-në,⁶⁹
2. Rregullorja e drurit të BE-së, e propozuar nga Komisioni në tetor të viti 2008 dhe e miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në tetor të vitit 2010, si një masë gjithëpërfshirëse për të ndaluar vendosjen e produkteve të paligjshme të drurit dhe lëndëve tjerra nga druri në tregun e brendshëm.⁷⁰

Në Republikën e Maqedonisë, prerja e paligjshme e pyjeve është një problem në rritje të dukshme.

⁶⁷ Chatham House. (2015, July). Tackling Illegal Logging and Related Trade: What progress and where next. The Royal Institute of International Affairs, London.


⁶⁸ Illegal logging/FLEGT Action Plan
https://ec.europa.eu/environment/forests/illegal_logging.htm

⁶⁹ Council Regulation (EC) No 2173/2005 of 20 December 2005 on the establishment of a FLEGT licensing scheme for imports of timber into the European Community

⁷⁰ Regulation (EU) No 995/2010 of the European Parliament and of the Council of 20 October 2010 laying down the obligations of operators who place timber and timber products on the market Text with EEA relevance

Në vijim do të ju paraqesim statistikat sipas Entit Shtetëror për statistika për prerjen e paligjshme të drunjëve (për m3) për vitet 2008-2013:⁷¹

Grafikoni nr. II/2



Siç mund të shihet në grafikonin e paraqitur më lartë në vitin 2008, në mënyrë të paligjshme janë prerë 7164 m3 drunj, drunjët e prerë në mënyrë të paligjshme në vitin 2009 rezultojnë rreth 6062 metër kub drunj, në vitin 2010 kjo shifër rritet për rreth 40% dhe arrin në 11557 m3 drunjë të prerë në mënyrë të paligjshme, të dhënat shfaqin rritje të madhe për vitin 2011 me rritje mbi 50% edhe atë arrin në 25189 m3 drunjë të prerë në mënyrë të paligjshme, në vitin 2012 përsëri ka rritje dhe të dhënat tregojnë 26239 m3 dru të prerë, ndërsa në vitin 2013 kjo shifër është 25942 metër kub drunjë të prerë në mënyrë të paligjshme të territorin e RM-së.

Nëse do të analizoheshin dëmet me rajone, përsëri qyteti i Tetovës me rethinë, shfaqet lartë me statistika për prerje të paligjshme të pyjeve, ku pjesa më e madhe e prerjes së drunjëve bëhet në hapësirat e Malit Sharr dhe dëmtohet rëndë ekosistemi dhe biodiversiteti. Këto vise nuk janë aspak të mbrojtura dhe kontrollet nga organet e MPB-së për prerjen e drunjëve në këto hapësira janë më të ralla, me vetë faktin që një hapësirë me aq gjelbërim dhe

⁷¹ Enti Shtetëror për Statistika i RM-së, raport vjetor, viti 2014

të mira ekologjike nuk është e mbrojtur dhe nuk është shpallur “Park Nacional”, ku kujdesi i organeve kompetente të shtetit do të ishin më të larta dhe gjithashtu kujdesi i qytetarëve do të ishte më i theksuar dhe në këtë formë do të mbroheshin të mirat ekologjike që pëmban në vete Mali Sharr.

Sipas të dhënave të Ministrisë të Punëve të Brendshme në vitin 2014, është konstatuar se kompanitë që i japin lejet për prerje të pyjeve punojnë në mënyrë të paligjshme.

31 kompani që kanë pasur licencë për dhënie të lejeve për prerje të pyllit kanë punuar në mënyrë të paligjshme. Në aksionin që u zhvillua në vitin 2014, aksion për parandalimin e krimit ndaj pyjeve i quajtur “Pylli”, MPB me urdhër të Prokurorisë Publike ka konfiskuar rreth 7.000 Kartonë për evidentim të pyjeve (drunjëve të prerë).⁷²


Vepra penale është kryer gjatë dhënies së lejeve për prerjen e pyjeve të cilat kanë qenë në pronësi të shtetit, dokumentacion jo i plotë gjatë dhënies së lejeve për prerjen e pyjeve private si dhe shkrimi i të dhënave të pasakta në kërkesat e adresuara për llojin e tokës për të cilën është kërkuar prerja e drunjve. MPB në qershor të vitit 2014, në kuadër të këtij aksioni ka kryer kontroll në 245 depo, objekte për ruajtjen e drunjve dhe ka ngritur 5 (pesë) kallëzime penale për kryerjen e 3 (tre) veprave penale të vjedhjes (nga një pyll i huaj janë konfiskuar drunjtë në sasi më të madhe se 1 (një) metër kub), dy vepra të tjera penale falsifikimi i dokumenteve si dhe një vepër penale evazion fiskal. Janë mbyllur 49 objekte depo për shitjen e drunjëve në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut si rrjedhojë e 167 shkeljeve të konstatuara, ku edhe janë konfiskuar rreth 800 metër kub dru për djegje.⁷³

Në grafikonin e paraqitur në vijim do të shihni të dhënat nga Ministria e Punëve të Brendshme për paditë penale të ngritura për vitin 2014, për prerje të paligjshme të pyjeve, të ndara në qytete:

⁷² Buletini i Ministrisë së Punëve të Brendshme, viti 2014

⁷³ Ministria e Punëve të Brendshme (buletin), viti 2014

Grafikoni nr. II/3



Duke iu referuar të dhënave të MPB-së, qyteti i Shkupit shfaqet në krye të listës me 20 padi penale të ngritura për prerje të paligjshme të pyjeve, qyteti i Tetovës me 15 raste, Ohri me 12 padi, Manastiri me 8, në qytetin e Strumicës janë ngritur 6 padi penale, në Veles 7, Shtip 4 dhe në qytetin e Kumanovës është ngritur vetëm një padi penale për prerje të paligjshme të pyjeve. Numri i padive penale të ngritura në vitin 2014 për këto vepra penale rezulton të jetë gjithsej 73.

2.2.4. Rrezikimi i mjedisit jetësor me hedhurina

Që në fillet e para të njerëzimit, ekzistojnë mbeturinat. Në fillim, këto llogariteshin si substanca me origjinë natyrore (lëkurë, kockë, dru) që dekompozohen dhe zbërthehen në natyrë dhe nuk kishte asnjë problem me mbeturinat e ngurta. Në jetën e përditshmem njerëzit bëjnë dhe shfrytëzojnë objekte të ndryshme, përdorin produkte ushqimore dhe në këtë formë mbeturinat krijohen në mënyrë të pashmangshme. Shumica e mbeturinave që njeriu krijon në mjedisin ku jeton kanë origjinë biologjike që nënkupton se ato përmbajnë lëndë organike. Sasia

dhe lloji i mbeturinave të krijuara rritet si rezultat i standardit më të lartë të jetesës dhe industrisë që ka marrë hov të madh.⁷⁴

Hudhja e mbeturinave në vende në të cilat banojnë dhe jetojnë njerëzit, veçanërisht pranë burimeve të ujit të pijshëm, mund të shkaktojë paraqitjen e ndonjë sëmundje dhe në rastin më të keq paraqitjen e ndonjë epidemie. Me këto veprime rrezikohen burimet e pastërta të ujit të pijshëm apo rrezikimi i ushqimeve dhe prodhimtarive ushqimore.⁷⁵

Grumbullimi i mbeturinave, mbetjeve nga hedhurinat është faktor kryesor kontribues për problemet kryesore që përballemi tani, prej kësaj edhe vetëdija për përfitimet prej uljeve apo të ri-shfrytëzimit dhe reklimit të mbetjeve. Kjo na ri-kujton disa paralajmërime që janë bërë për këtë pjesë në Kuranin famëlartë: “Por mos harxhoni shumë, sepse All-llahu nuk i do as rrënjët” (Kurani 6: 141, përkthim Jusuf Ali).

Në Republikën e Maqedonisë, ekzistojnë disa deponi komunale të cilat në numër janë 54 depo, mirëpo 80% e këtyre deponive nuk plotësojnë standardet e nevojshme ekologjike dhe shpesh përbëjnë më shumë dëm në shëndetin e qytetarëve dhe dëmtojnë mjedisin. Deponia e vetme në vend që plotëson standardet është deponia “Drislla”, mirëpo kjo deponi nuk është zgjidhje për të gjithë qytetet e Republikës së Maqedonisë, ajo mbulon vetëm pjesën e qytetit të Shkupit.

Në mungesë të deponisë, qyteti i Tetovës përsëri shfaqet kampion vendor për ndotjen e mjedisit jetësorë, me vetë faktin që ky qytet me reth 200 000 banorë (me rethinën), akoma nuk e ka të zgjidhur nevojën elementare dhe shumë të domosdoshme të deponisë, që do të mbulonte këtë pjesë të vendit. Në mungesë të deponisë sipas disa të dhënave na tregon se në Tetovë ka reth 2.000 deponi të egra të krijuara nga hudhja e mbeturinave në shtretërit e lumenjëve, në hapësira të hapura, në viset malore, po shpesh herë edhe në qendër të qytetit.

Ekzistojnë shumë lloje të mbeturinave të ngurta nvarësisht prej vetive dhe vendit në të cilën shfaqjen, në vijim do të analizojmë disa lloje siç janë:

- mbeturinat industriale
- mbeturinat komunale

⁷⁴ Богеска Р., Цекова Б. и Герасимовска Б., Влијание на отпадоците врз животната средина, 2008 Скопје, fq. 505

⁷⁵ Ismail Zejneli, E drejta penale – pjesa e posaçme, (2007), fq. 107

- mbeturinat e rrezikshme
- mbetjet radioaktive, dhe
- mbetjet mjekësore.

2.2.4.1. Mbeturinat industriale

Mbeturinat industriale, janë mbetjet që ngelin si rrjedhojë e proceseve të ndryshme të prodhimit ose përpunimit në fabrika apo që gjenerohen në miniera, metalurgji, termocentralet dhe në industrinë kimike.

Trajtimi jo-adekuat i këtyre mbetjeve të rrezikshme dhe mos respektimi i kushteve primare thelbësore për trajtim të këtyre mbetjeve shpesh vë në rrezik punëtorët në industri si dhe dëmton mjedisin, në raste më të rënda edhe duke rrezikuar jetën e njerëzve në përgjithësi.

Me dendësinë e popullsisë, zhvillimin e jetës më dinamike si dhe mënyrën e jetesës ka kontribuar që në formë drastike të rriten sasi të mbeturinave të cilët ato hudhin.

2.2.4.2. Mbeturinat komunale

Mbeturinat komunale nënkuptojnë mbeturinat shtëpiake që njerëzit i hudhin pas kryerjes së nevojave të tyre apo konsumimit të produkteve të ndryshme ushqyese, materialet e ndryshme ndërtimore, mbetjet sanitare nga banjat dhe mbeturinat rrugore.

Mbeturinat në Republikën e Maqedonisë grumbullohen, mirëpo akoma nuk është bërë praktikë selektimi i tyre kur hudhen, proces ky që pastaj do të ndihmonte në ndarjen dhe reciklimin e mbeturinave dhe nuk do të ishte nevoja që të gjitha mbeturinat që merren nga organet komunale të dërgohen në deponitë e mbeturinave dhe të grumbullohen atje në sasi të mëdha, mirëpo të njejtat do të dërgoheshin për reciklim.

Në tabelën e mëposhtme do të ju paraqesim, kohën e nevojshme që duhet për dekompozim të mbeturinave:⁷⁶

⁷⁶ <https://academic.oup.com/femsec/article/92/7/fiw087/2469992>

Tabela nr. II/4

Materiali	Koha e nevojshme për dekompozim
Letra (jo e plastifikuar)	10 deri në 30 ditë
Druri	10 deri në 15 vjet
Ushqimi, lulet dhe mbetje tjerra organike	7 deri në 14 dite
Veshje material pambuk	2 deri në 5 muaj
Konzerva (material alumin ose metal)	100 deri në 500 vjet
Plastikë	1 milion vjet
Qelq	asnjëherë

Në kohën që jetojmë në shumicë përdoren produkte që përmbajnë ose janë të ambalazuara në foli të aluminit, plastikë, konzervë ose tjetër ambalazh e cila është e fortë dhe nuk dekompozohet lehtë dhe e gjithë kjo sjell deri te ndotja e mjedisit me këto materiale të cilët i paraqitëm në tabelën më lartë dhe siç mund të shihet, për shumicën e materialeve duhet një periudhë shumë e gjatë kohore deri sa të dekompozohen dhe shkatërohen plotësisht. Çdo hedhje e këtyre materialeve në vende jo-adekuate për trajtim të këtyre mbetjeve, rrezikon shëndetin e qytetarëve dhe dëmton mjedisin

2.2.4.3. Mbetjet radioaktive

Mbetjet radioaktive përcaktohen si materiale që përmbajnë, ose janë të kontaminuara me radionuklide në përqëndrime ose aktivitete më të mëdha se nivelet e pastrimit, siç përcaktohen nga autoritetet rregullatore të vendit dhe për të cilat nuk është paraparë përdorimi.⁷⁷

2.2.4.4. Mbetjet mjekësore

Mbetjet mjekësore janë çdo lloj mbeturinash që përmbajnë materiale infektive ose materiale që janë potencialisht infektive, kjo përfshin mbeturinat e krijuara nga institucionet e kujdesit shëndetësor, siç janë zyrat e mjekëve, spitalet, klinikat dentare, laboratorët, insitucioonet hulumtuese mjekësore si dhe klinikat veterinerë.

⁷⁷ M.I. Ojovan W.E. Lee, An Introduction to Nuclear Waste Immobilisation 2005 fq. 51

2.2.5. Transportimi i materieve të rrezikshme në vend

Si materie të rrezikshme llogariten të gjitha materialet të cilat përmbajnë substanca reaktiviteti, eksploziviteti, substanca kancerogjene, infektiviteti, toksiciteti, ekotoksiciteti si dhe veti toksike të lëshimit të gazit nga reaksionet kimike ose dekompozimi biologjik, vetitë e të cilave ndotin mjedisin jetësor dhe janë të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve në përgjithësi.⁷⁸ Është vërtetuar se edhe mbetjet e rrezikshme nga bujqësia dhe bagëtitë kanë një ndikim negativ në mjedis.

Në Republikën e Maqedonisë, nuk ekzistojnë sisteme zyrtare apo qendra për grumbullimin e mbeturinave radioaktive, si dhe nuk ka pajisje adekuate për asgjësim të këtyre mbetjeve. Mbetjet radioaktive, zakonisht eksportohen në vende të tjerra të cilët kanë pajisje dhe vende adekuate për trajtim të këtyre mbetjeve shume të rrezikshme për ambientin jetësor.

Transportimi i materieve të rrezikshme në vend rregullohen me Ligjin për bartje të materieve të rrezikshme të RM-së, forma e transportimit të këtyreve materie të rrezikshme në rrugët brenda dhe jashtë shtetit si dhe hekurudha, kushtet të cilët duhet ti plotësojnë transportuesit, ambalazhimi dhe mjetet bartëse.⁷⁹

Materie të rrezikshme llogariten dhe sipas karakteristikave ndahen në disa klasa⁸⁰:

Tabela nr. II/5

Klasifikimi numerik	Materia
1	<i>materie dhe mjete eksplozive</i>
2	<i>gazëra</i>
3	<i>lëndë djegëse të lëngshme</i>
4.1	<i>lëndë djegëse të ngurta</i>
4.2	<i>lëndë vetë-djegëse</i>
4.3	<i>materie të cilat në kontakt me ujin krijojnë gaz djegës</i>
5.1	<i>materie oksiduese</i>
5.2	<i>perokside organike</i>
6.1	<i>helme</i>
6.2	<i>materie ngjitëse, infektuese</i>
7	<i>materie radioaktive</i>
8	<i>materie korozive</i>
9	<i>materie dhe lëndë tjerra prodhuese të rrezikshme</i>

⁷⁸ Ligji për mjedisin i RM-së, neni 5, paragrafi, 11 dhe 12

⁷⁹ Ligji për bartje të materieve të rrezikshme të RM-së, neni 1

⁸⁰ Po aty (ref. 79)

Vepra penale kryhet me anë të ndërmarrjes të çdo veprimi të kundërligjshëm që do të shfaqet në transportimin e këtyre materieve me rrezikshmëri të lartë në vend.

Veprën penale mund ta kryejë, çdo person i cili ka mbushur moshën madhore për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, dhe gjatë transportimit të këtyre materieve ka shkelur rregullat për transportim.

2.2.6. Uzurpimi i paluajtshmërive

Çdo pronë e shpallur për përdorim të përgjithshëm, një e mirë nën mbrojtje të përkohshme apo trashëgimi kulturore, vend i rrallë në natyrë dhe me rëndësi të veçantë ose ndonjë pasuri tjetër natyrore, nënkupton të mirat e përgjithshme që na ka falur Zoti dhe janë në mbrojtje të organeve kompetente shtetërore përmes legjislacioneve të ndryshme.

Çdo person juridik ose fizik i cili me qëllim të zotërimit do të marrë paluajtshmëri të huaj që është pronë e dikujt tjetër ose është pronë shtetërore, do të llogaritet se ka kryer veprën penale të uzurpimit të paluajtshmërive.

2.2.7. Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale

Hulumtimi dhe eksploatimi i lëndës së parë minerale dhe aktiviteteve të tjera të cilat mundet që të shkaktojnë ndryshime të visit, mund të bëhen në forma me të cilat sigurohet mbrojtja e vlerave të viseve të hapësirës në masë të madhe të mundshme.⁸¹

Çdo formë tjetër e eksploatimit të lëndëve të para minerale të cilat janë të paracaktuara me ligj, pa koncesion apo pa leje për të njëjtën, do të llogaritet se ka kryer veprën penale të eksploatimit joligjor të lëndëve të para minerale dhe do të dënohet sipas legjislacionit të vendit.

2.2.8. Gjuetia e paligjshme

Me vepër penale të gjuetisë së paligjshme nënkuptojmë, çdo person i cili do të del në gjah dhe do të gjuajë ndonjë kafshë/shpenzë të egër, gjatë periudhës kohore kur gjuetia është e ndaluar.

⁸¹ Ligji për mbrojtjen e natyrës, neni 121, paragrafi 1.

Secili që pa autorizim do të gjuajë në vend të ndaluar për gjueti, do të vras, plagos apo zë ndonjë egërsi të gjallë, do të llogaritet se ka kryer veprën penale të gjuetisë së paligjshme dhe do të dënohet sipas legjislacionit të vendit.⁸²

2.2.9. Peshkimi i paligjshëm

Me peshkim të paligjshëm nënkuptojmë, çdokush që gjuan peshq me rrymë, eksploziv, helm, mjete për turbullim, mjete që përdoren për peshkim nënujor, rrjetë apo mjete të tjerra me të cilat është i ndaluar peshkimi.⁸³

Peshkimi me eksploziv ka efekt direkt te njeriu dhe njihet si forma më e përdorur, këtu shkak bëhet pakujdesia më të cilin përdoret materiali eksplozives me anë të cilit gjithashtu rrezikohet edhe jeta e personit që e përdor, përveç peshqëve që vret me këtë formë dëmtohet rëndë edhe ekosistemi duke e shkatëruar biodiversitetin. Peshkimi me elektricitet gjithashtu ka dëme të mëdha veçanërisht nëse bëhet në periudhën e riprodhimit sepse me këtë formë mundet të dëmtohen vezët e peshqive. Lloj tjetër i peshkimit i cili llogaritet më argëtues dhe praktikohet shumë është peshkimi natën, ky sport është i ndaluar sepse pashku gjatë natës është i palëvizshëm dhe nuk i jepet mundësi të fshihet.⁸⁴

⁸² Shih Ligjin për Gjuetinë “Gazeta zyrtare e RM-së”, nr. 26/09.

⁸³ Shih Ligjin për peshkim dhe akuakulturë “Gazeta zyrtare e RM-së”, nr. 7/08

⁸⁴ Magdalena Cara, Peshkimi i paligjshëm dhe pasojat sociale, mjedisore dhe të biodiversiteti (artikull 2018).

Kapitulli III

ANALIZË DHE TË DHËNA STATISTIKORE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

3.1. Ecuria dhe vëllimi i veprave penale kundër mjedisit

Krimi mjedisor si një fenomen shumë aktual në shoqëri, individual si dhe shkaqet e tij gjithmonë kanë qenë objekt interesimi që në periudhat më të hershme të zhvillimit të shoqërisë dhe gjithmonë kanë shkaktuar frikë dhe pasiguri te qytetarët.

Me krimin mjedisor, shpesh herë viktimizimi është serioz, jo vetëm se ajo se çdo viktimë individualisht është prekur seriozisht, por sepse viktima të shumta preken nga krimi. Viktimat individuale mund të humbasin shumë pak, mirëpo efekti akumulues për komunitetin dhe mjedisin jetësor mund të jetë i konsiderueshëm.⁸⁵

Studime të shumta raportojnë një ulje të krimeve mjedisore pas shqiptimit të gjobave ose gjobave potenciale, për shkak të efekteve parandaluese të përgjithshme dhe specifike. Këtu në hulumtojmë nëse ato efekte parandaluese duken të besueshme duke vlerësuar mundësinë e një çështje penale që ndodh çdo vit ndërmjet 1983 deri në vitin 2014.

Analizat tona tregojnë se ekziston një probabilitet jashtëzakonisht i ulët që një rast i krimit mjedisor të ndiqet penalisht, duke hedhur dyshimin se këto raste penale janë mjaft të përhapura për të gjeneruar një efekt parandalues.

3.2. Kryerësit e veprave penale kundër mjedisit jetësor

Kryerës të veprave penale kundër mjedisit jetësor shpesh paraqiten persona juridik dhe persona fizik, të cilët kryejnë veprën penale me dashje po në disa raste edhe nga pakujdesia.

Duke iu referuar të dhënave statistikore, prej Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë, në vijim do të ju paraqesim të dhënat për veprat penale kundër mjedisit jetësor të realizuara në periudhën kohore 2009-2014⁸⁶.

⁸⁵ Eileen Skinnider, Effect, Issues and Challenges for Victims of Crimes that have a Significant Impact on the Environment, 2013 Vancouver, fq. 3

⁸⁶ Enti Shtetëror për Statistika i RM-së, Të dhëna statistikore për personat e paraqitur, akuzuar dhe të dënuar për veprat penale të realizuara gjatë periudhës 2009-2014.

Do të ju paraqesim personat, kryerësit e këtyre veprave, llojit të vendimit të shqiptuar, gjininë e kryerësve, moshën e tyre, shkollimin, profesionin dhe përkatësinë etnike.

Do të ju paraqesim të dhënat për kallëzimet penale të ngritura për këto persona, persona të akuzuar, sa prej tyre janë dënuar si dhe llojin dhe kohëzgjatjen e dënimeve të shqiptuara.

Në tabelën në vijim do të shihni të dhënat për persona të rritur të paraqitur, sipas llojit të veprës penale, llojit të vendimit, kohëzgjatjen e procedurës dhe gjinisë:

Tabela nr. III/1

Lloji i veprës penale	Gjithsej	Kryerës të njohur						Gjithsej kryerës të panjohur
		Gjithsej kryerësit e njohur	Femra	Lloji i vendimit				
				Ankesa të hedhura poshtë	Hetime të pezulluara	Hetime të ndërprera	Aktakuza të ngritura	
Gjithsej	151	128	3	46	-	11	71	23
Uzarpimi i pasurive të paluajtshme	72	72	3	31	-	8	33	-
Shkretimi i pyllit	7	4	-	2	-	-	2	3
Gjuetia e paligjshme	13	9	-	1	-	2	6	4
Peshkimi i paligjshëm	28	18	-	2	-	-	16	10
Mundimi i kafshëve	25	21	-	8	-	1	12	4
Të tjerra	6	4	-	2	-	-	2	2

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave i RM-së

Të dhënat e paraqitura në tabelën më lartë tregojnë se gjithsej kemi të paraqitura 151 raste, ku 3 raste janë femra, për 128 kryerësit e veprave janë të njohur, 46 ankesa janë hudhur poshtë, 11 hetime janë ndërprerë dhe janë ngritur 71 aktakuza, 23 persona shfaqen si kryerës të panjohur të këtyre veprave penale.

Në vijim do të ju paraqesim të dhënat për persona të rritur të paraqitur sipas veprës penale, parashtruesit të kallëzimeve penale, llojit të vendimit dhe formës së paraqitjes së kallëzimit penal:

Tabela nr. III/2

	Gjithsej			Kallz. pen. të refuzuar		Proc. hetimore e stopuar		Hetim i ndërprerë		Padi		Kryerësi i panjohur	
	të gjithë	direkt	përmes MPB	direkt	përmes MPB	direkt	përmes MPB	direkt	përmes MPB	direkt	përmes MPB	direkt	përmes MPB
Gjithsej	151	56	95	27	19	-	-	7	4	22	49	-	23
Qytetar i dëmtuar	43	38	5	20	3	-	-	7	-	11	2	-	-
Qytetar tjetër	4	4	-	2	-	-	-	-	-	2	-	-	-
Subjekt afarist i dëmtuar	4	4	-	-	-	-	-	-	-	4	-	-	-
Inspeksion	9	7	2	4	-	-	-	-	-	3	2	-	-
MPB	88	-	88	-	16	-	-	-	4	-	45	-	23
Organe tjerra	1	1	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-
Njoftim-prokurorit publik	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjerë	1	1	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Në bazë të të dhënave nga Enti Shtetëror për Statistika i RM-së, gjithsej janë paraqitur 151 persona të rritur, ku 95 prej tyre janë paraqitur përmes organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe 56 janë paraqitur direkt.

Në tabelën në vijim, do të gjeni të dhënat për persona të rritur të paraqitur - kryerës të njohur, sipas grupeve të veprave penale, llojit të dënimit dhe kohëzgjatja e procedurës:

Tabela nr. III/3

Lloji	Gjithsej	Kohëzgjatja e procedurës nga ngritja e hetimit deri në vendim					
		deri 1 muaj	1 - 2 muaj	2 - 4 muaj	4 - 6 muaj	6 muaj deri 1 vit	më shumë se 1 vit
Gjithsej	128	29	21	30	13	19	16
Kallzim penal i refuzuar	46	7	8	13	4	4	10
Hetim i ndërprerë	11	-	3	3	-	5	-
Aktakuzë e ngritur	71	22	10	14	9	10	6

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Duke u referuar në të dhënat statistikore të Entit Shtetëror të Statistikave, gjithsej janë refuzuar 46 kallëzime penale, 11 procedura hetimore janë ndërprerë dhe janë ngritur aktakuza për 71 persona, siç janë të paraqitura në tabelën më lartë.

Në vijim do të gjeni të dhënat statistikore për persona të ritur të paraqitur - kryerës të njohur, sipas grupeve të veprave penale dhe përkatësisë etnike:

Tabela nr. III/4

	Gjithsej	Përkatësia etnike								
		Maqedonas	Shqiptar	Turq	Rom	Vlleh	Serb	Boshnjak	te tjerrë	të panjohur
Gjithsej	128	85	28	5	3	1	-	-	1	5
Femra	3	3	-	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Në bazë të të dhënave nga Enti Shtetëror për Statistika i RM-së, persona të njohur të paraqitur të ndarë sipas përkatësisë etnike ku gjithsej kemi 128 kryerës të njohur edhe atë 85 të përkatësisë etnike maqedonas, 28 shqiptarë, 5 turq, 3 rom, 1 vlleh, 5 persona të panjohur dhe 1 të përkatësive tjerra etnike në RM.

Të dhënat statistikore për persona të rritur të akuzuar sipas veprës penale, llojit të vendimit dhe gjinisë, do ti gjeni në tabelën në vijim:

Tabela nr. III/5

Lloji i veprës penale	Gjithsej		Të shpallur fajtor	Nuk janë të shpallur fajtor		
	persona të akuzuar	femra		hetim i ndërprerë	të liruar nga akuza	akuza është refuzuar
Gjithsej	68	4	62	3	2	1
Uzarpimi i paluajshmërive	31	4	27	2	2	-
Eksplotimi joligjor i lëndëve të para minerale	11	-	11	-	-	-
Shkretimi i pyllit	4	-	4	-	-	-
Gjuetia e paligjshme	4	-	4	-	-	-
Peshkimi i paligjshëm	9	-	9	-	-	-
Mundimi i kafshëve	4	-	2	1	-	1
Tjerra	5	-	5	-	-	-

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Në bazë të të dhënave nga Enti Shtetëror për Statistika i RM-së, të paraqitura në tabelën e mësipërme, gjithsej kemi 68 persona të akuzuar si kryerës të veprave penale, 4 persona të gjinisë femërore. Fajtor për kryerjen e veprave penale kundër mjedisit janë shpallur gjithsej 62 persona, për 3 persona hetimi është ndërprerë, dy të tjerrë janë liruar nga akuza dhe për 1 person është refuzuar aktakuza.

Në tabelën në vijim do të ju paraqesim të dhënat për persona të rritur të dënuar sipas llojit të veprës penale dhe llojit të sanksionit të shqiptuar:

Tabela nr. III/6

Lloji i veprës penale	Gjithsej		Lloji i sanksioneve				Lloji i sanksioneve		
	Të dënuar	Femra	dënime gjithsej	Dënimet			Masa alternative	masa alternative	
				kryesore		dytësore		dënim me kusht	
				burgim	gjobë dënim në të holla	dëbimi i të huajit		burgim	dënim me të holla
Gjithsej	62	4	27	4	22	1	35	26	9
Eksplotimi joligjor i lëndëve të para minerale	11	-	2	-	2	-	9	-	9
Uzurpimi i paluajtshmërive	27	4	12	-	12	-	15	15	-
Shkretimi i pyllit	4	-	3	-	2	1	1	1	-
Gjuetia e paligjshme	4	-	1	-	1	-	3	3	-
Peshkimi i paligjshëm	9	-	7	3	4	-	2	2	-
Mundimi i kafshëve	2	-	1	-	1	-	1	1	-
Tjerra	5	-	1	1	-	-	4	4	-

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistika të RM-së, për 62 persona kryerës të veprave penale kundër mjedisit, janë shqiptuar gjithsej 27 dënime dhe 35 sanksione, masa alternative. Dënime me burgim janë shqiptuar për 4 persona si dënim kryesorë dhe për 26 persona burgim masë alternative, dënim në të holla (gjobë) për 22 persona dhe 9 persona të tjerrë si masë alternative, 4 persona të dënuar janë të gjinisë femërore, për një person është shqiptuar masa dytësore e dënimit dëbimi i të huajit nga vendi.

Persona të rritur të dënuar sipas llojit të veprës penale dhe llojit të sanksioneve kryesore të shqiptuara, burgim, dënim me të holla dhe ndalesat e shqiptuara (kryesore dhe dytësore), paraqiten si në vijim:

Tabela nr. III/7

Lloji i veprës penale	Gjithsej		Dënime kryesore										Dënime dytësore					
	persona të gjykuar	femra	të gjithë	burgim										të gjithë	dënim me gjobë			
				burgim të përjetshëm	deri 20 vjet	10-15 vjet	5-10 vjet	3-5 vjet	2-3 vjet	1-2 vjet	6 muaj deri 1 vjet	deri 6 muaj	deri 5000 denar		5001 - 10000	10001 - 30000	mbi 30001 denar	
Gjithsej	62	4	4	-	-	-	-	-	-	-	-	1	3	22	-	1	11	10
Eksplotimi jologjor i lëndëve të para minerale	11	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	-	-	2
Uzarpimi i paluajtshmërive	27	4	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	12	-	-	6	6
Shkretimi i pyllit	4	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	-	2	-
Gjuetia e paligjshme	4	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	1	-
Peshkimi i paligjshëm	9	-	3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3	4	-	-	2	2
Mundimi i kafshëve	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	1	-	-
Tjerra	5	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Të dhënat statistikore nga Enti Shtetëror i Statistikave tregojnë se, ndaj 3 personave është shqyptuar dënimi kryesor, burgim edhe atë 6 muaj deri në 1 vit përkatësisht deri në 6 muaj. Për 22 persona të tjerrë është shqyptuar dënim me gjobë, edhe atë për 1 person dënim me gjobë prej kategorisë 5001-10000 denar, 11 persona dënim 10001-30000 denar dhe 10 persona mbi 30001 denar.

Në tabelën në vijim do të ju paraqesim të dhënat për persona të rritur të dënuar sipas llojit të veprës penale dhe llojit të dënimeve alternative të shqiptuara:

Tabela nr. III/8

Lloji i veprës penale	Gjithsej të dënuar	Masa alternative											
		Gjithsej masa alternative	dënim me kusht										
			Gjithsej të dënuar me kusht	burgim						dënim me gjobë			
				të gjithë	mbi 1 vit	6 muaj deri 1 vit	3-6 muaj	deri 3 muaj	të gjithë	deri 5000 denar	5001 - 10000	10001 - 30000	
Gjithsej	62	35	35	26	-	4	3	19	9	-	-	9	
Uzurpimi i paluajtshmërive	27	15	15	15	-	-	1	14	-	-	-	-	
Ekspluatimi joligjor i lëndëve të para minerale	11	9	9	-	-	-	-	-	9	-	-	9	
Shkretimi i pyllit	4	1	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	
Gjuetia e paligjshme	4	3	3	3	-	-	2	1	-	-	-	-	
Peshkimi i paligjshëm	9	2	2	2	-	-	-	2	-	-	-	-	
Mundimi i kafshëve	2	1	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	
Tjerra	5	4	4	4	-	3	-	1	-	-	-	-	

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Sipas të dhënave statistikore të Entit Shtetëror të Statistikave, masa alternative janë shqiptuar për gjithsej 35 persona, me kusht janë dënuar 35 kryrës të veprave penale, me burgim 26 persona dhe për 9 persona është shqiptuar denim me gjobë, sipas detajeve të paraqitura në tabelën më lartë.

Në vijim janë të paraqitura të dhënat statistikore për persona të rritur të dënuar sipas masave të shqyptuara të sigurisë, konfiskimit të paluajtshmërive dhe sendeve:

Tabela nr. III/9

Lloji i veprës penale	Gjithsej		Gjithsej masa të sigurisë	Masa të sigurisë	
	Gjithsej persona të dënuar	Femra		Konfiskim i pasurisë së paluajtshme	Marrja e sendeve
Gjithsej	62	4	-	1	18
Ekspluatimi joligjor i lëndëve të para minerale	11	-	-	-	10
Uzurpimi i paluajtshmërive	27	4	-	-	-
Shkretimi i pyllit	4	-	-	-	1
Gjuetia e paligjshme	4	-	-	-	-

Peshkimi i paligjshëm	9	-	-	1	6
Mundimi i kafshëve	2	-	-	-	-
Tjerra	5	-	-	-	1

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Të dhënat prej Entit Shtetëror të Statistikave paraqesin 19 masa të sigurisë të shqiptuara, 1 masë për konfiskim të pasurisë së paluajtshme dhe 18 për marrje të sendeve.

Në vijim do të paraqiten rastet për persona të rritur të dënuar sipas veprave penale, bashkëpunimit, gjinisë dhe numrit të bashkëpunëtorëve gjatë realizimit të veprës penale:

Tabela nr. III/10

	Gjithsej	Bashkëpunëtor					Numri i personave të përfshirë gjatë kryerjes së veprës penale				
		vetë	kryerës	bashkëkryerës	inxitës	ndihmues	një person	dy persona	tre persona	4 persona	5 ose më shumë
Gjithsej	62	37	15	10	-	-	37	15	1	-	9
Femra	4	4	-	-	-	-	4	-	-	-	-

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Në bazë të të dhënave nga Enti Shtetëror për Statistika i RM-së, gjithsej 37 persona kanë kryer vetë veprat penale kundër mjedisit, 15 prej tyre kryerës (dy persona) dhe 10 persona kanë kryer veprat penale me bashkëkryerës, ku 1 vepër është kryer në bashkëpunim nga tre persona dhe 9 vepra penale janë kryer në bashkëpunim nga 5 e më shumë persona.

3.2.1. Moshë dhe gjinia e kryerësve të veprave penale kundër mjedisit jetësor

Moshë e kryerësve të veprave penale është një ndër karakteristikat më të rëndësishme të fenomenologjisë kriminale. Kryerësit e veprave penale kundër mjedisit jetësor janë të moshave të ndryshme.

Si kryerës të veprave penale kundër mjedisit paraqiten personat e gjinisë femërore dhe ata të gjinisë mashkullore. Siç mundet të shihni edhe në të dhënat statistikore në vijim se pjesëmarrja e gjinisë femërore në kryerjen e veprave penale kundër mjedisit është shumë më e ulët në krahasim me personat e gjinisë mashkullore.

Në vijim do të paraqesim të dhënat statistikore për persona të rritur të dënuar sipas grupit të veprave penale, dënimeve tjerra, moshës dhe gjinisë:

Tabela nr. III/11

	Gjithsej			18-20 vjet		21-24 vjet		25-29 vjet		30-39 vjet		40-49 vjet		50-59 vjet		60 dhe më shumë		të panjohur	
	të gjithë	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
Gjithsej	62	58	4	1	-	4	-	8	-	11	2	10	1	11	-	12	1	1	-

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Në bazë të të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikave i RM-së, numri më i madh i kryerësve të këtyre veprave penale janë të moshës mbi 30 vjeçare, edhe atë 13 vepra penale të kryera prej personave të moshës mbi 60 vjeç 12 meshkuj dhe 1 femër, 11 vepra penale personat e moshës 50-59 vjet të gjithë meshkuj, ata të moshës 40-49 vjet kanë kryer 11 vepra penale kundër mjedisit 10 prej tyre meshkuj 1 femër, 13 kryerësit tjerë janë të moshës 30-39 edhe atë 11 meshkuj dhe 2 femra, 8 vepra penale janë kryer nga meshkujt e kategorisë së moshës 25-29 vjet, 4 persona meshkuj të moshës 21-24 vjet paraqiten si kryerës të veprave penale, ndërsa vetëm 1 person i moshës 18-20 vjet mashkull paraqitet si kryerës i këtyre veprave penale.

Në tabelën në vijim do të gjeni të dhënat për persona të rritur të dënuar sipas llojeve të veprave penale, dënimeve të mëhershme, moshës dhe gjinisë:

Tabela nr. III/12

	Gjithsej			18 - 20 vjeç		21 - 24 vjeç		25 - 29 vjeç		30 - 39 vjeç		40 - 49 vjeç		50 - 59 vjeç		më shumë se 60 vjeç		Të panjohur	
	të gjithë	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
Gjithsej	62	58	4	1	-	4	-	8	-	11	2	10	1	11	-	12	1	1	-
Të dënuar më parë	3	3	-	-	-	-	-	-	-	1	-	1	-	1	-	-	-	-	-
Për vepra të ngjashme	2	2	-	-	-	-	-	-	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Për vepra të tjera	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-
Për vepra të ngjashme dhe të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Të dhënat statistikore të Entit Shtetëror të Statistikave, të paraqitura në tabelën më lartë, tregojnë se 3 persona të dënuar më herët kanë kryer vepra penale kundër mjedisit

jetësor, ku 2 persona janë recedivist dhe janë dënuar përsëri për vepra të ngjashme, ndërsa 1 person është dënuar për vepra të tjerra.

Në vijim do të ju paraqesim të dhënat për të miturit (fëmijë) të dënuar sipas llojeve të veprave penale dhe dënimeve:

Tabela nr. III/13

Vepra penale	Fëmijë nga 16 deri 18 vjeç						Fëmijë nga 16 deri 18 vjeç					
	burg për fëmijët						masa edukuese					
	Gjithsej	të gjithë	deri 10 vjeç	8-10 vjeç	5-8 vjeç	3-5 vjeç	të gjithë	masa disiplinore		masa institucionale		
								paralajmërim	qendra disiplinore	në familje tjetër	organ të kujdestarisë	
Gjithsej	1	-	-	-	-	-	1	-	-	-	1	
Shkretimi i pyllit	1	-	-	-	-	-	1	-	-	-	1	

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Siç edhe mund të shihni në të dhënat statistikore të paraqitura më lartë, vetëm 1 rast i fëmijëve shfaqet i dënuar me masë edukuese në organ të kujdestarisë, për kryerjen e veprës penale kundër mjedisit jetësor, Shkretimi i pyllit.

3.2.2. Shkollimi, profesioni dhe nacionaliteti i kryerësve të veprave penale kundër mjedisit

Shkollimi është faktorë shumë i rëndësishëm në formimin, zhvillimin e çdo individi. Përmes shkollimit çdo individ mundet të krijojë botëkuptimet e jetës dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të tij, nëpërmjet shkollimit tek personat barten njohuritë e caktuara si dhe shkollimi luan rol në formimin e shprehive dhe qasjeve pozitive, veçanërisht në formimin e drejtë të personalitetit të tij.

Ndikimi i disa faktorëve të tjerrë siç janë varfëria e skajshme, papunësia, kushtet e vështira ekonomike dhe faktorë të tjerrë, shpesh shtyjnë disa persona që të kryejnë vepra të ndryshme penale pa mvarrësisht shkollimi edhe te personat me shkollim të mesëm ose shkollim të lartë siç paraqiten rastet edhe në veprat penale kundër mjedisit.

Në disa raste te këto vepra penale dhe vepra të tjerra penale, kryhen nga persona të arsimuar me shkollim të lartë, dhe aftësitë dhe njohuritë e fituara përdoren nga këto persona

për qëllim të kryerjes së sjelljeve të ndryshme kriminale dhe fshehjen në formë të sofistikuar të dukurive kriminale por edhe të vetë veprës eventuale penale qo do kishin kryer.

Në vijim do të paraqesim të dhënat statistikore për persona të rritur të dënuar sipas grupeve të veprave penale, gjinisë dhe shkollimit:

Tabela nr. III/14

	Gjithsej	Pa përgatitje shkollore prej klasës 1 deri 3 të shkollës fillore	Prej klasës 4-7 të shkollës fillore	Shkollim fillor të përfunduar	Me shkollim të mesëm	Me shkollim të lartë	Fakultete dhe akademi të arteve	Panjohur
Gjithsej	62	-	2	12	29	-	1	18
Femra	4	-	1	-	3	-	-	-

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Sipas të dhënave nga Enti Shtetëror për Statistika i RM-së, 15 persona me shkollim fillor kanë kryer vepra penale kundër mjedisit, me shkollim të mesëm paraqiten 32 persona, me fakultet/akademi të kryer kemi 1 person si dhe 18 persona janë të panjohur.

Të dhënat statistikore për persona të rritur të dënuar sipas grupeve të veprave penale dhe profesionit, paraqiten si në vijim:

Tabela nr. III/15

Gjithsej	Nëpunës shtetëror dhe drejtor	Punëtorë teknik	Punëtorë në profesione shërbyese dhe shitës në lokale	Punëtorë bujqësor profesional	Profesionet për punë jo-industriale	Përdorues të makinerive për mbjellje të bimëve	Punëtorë pa ndonjë profesion të caktuar	Të papunë	Penzioner	Të panjohur
62	2	-	1	5	1	1	7	13	3	29

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Duke u bazuar në të dhënat statistikore të entit sipas profesionit të të dënuarve, për gjithsej 62 persona të dënuar, 29 janë të panjohur, 3 persona të dënuar janë penzioner, 13 persona të pa punë, 7 persona shfaqen si persona pa ndonjë profesion të caktuar, 1 person i dënuar është bujk përdorues i makinerive për mbjellje, 1 person me profesion për punë jo-industriale, 5 persona shfaqen si bujq profesional, 1 person shitës në lokal dhe 2 persona nëpunës shtetëror përkatësisht 1 drejtor.

Në tabelën në vijim do të paraqesim të dhënat statistikore për persona të dënuar sipas grupit të veprave penale dhe përkatësisë etnike:

Tabela nr. III/16

Gjithsej	Përkatësia etnike								
	Maqedonas	Shqiptar	Turq	Rom	Vllehë	Serb	Boshnjak	të tjerrë	të panjohur
62	36	6	6	4	-	-	-	-	10

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i RM-së.

Nëse do të shihnim të dhënat statistikore të entit sipas përkatësisë etnike, 36 persona të dënuar për kryerjen e veprave penale kundër mjedisit jetësor janë të përkatësisë maqedonase, 6 persona të përkatësisë etnike shqiptar, 6 persona turq, 4 persona shfaqen rom dhe 10 persona të pa njohur.

3.3. Veprat penale kundër mjedisit jetësor, analizë sipas të dhënave nga Prokuroritë publike dhe gjykatat e RM-së.

Në bazë të të dhënave nga Prokuroritë Publike të Republikës së Maqedonisë, për veprat penale kundër mjedisit jetësor dhe ambientit në vitin 2014 janë pranuar kallëzime penale për gjithsej 223 persona dhe së bashku me kallëzimet penale prej periudhës së më hershme kundër 147 personave, në periudhën e raportimit është vepruar për kallëzimet penale kundër 370 personave. Prokuroritë publike në vitin 2014 kanë ngritur aktakuza për 96 persona, ndërsa nga ana e gjykatave janë sjellur vendime të shkallës së parë për 160 persona.

Në krahasim me vitin paraparak 2013 kur për këto vepra penale janë pranuar kallëzime penale kundër 267 personave dhe të pa përfunduara kundër 140 personave ose gjithsej kundër 407 personave, ka ulje prej 44 personave, si dhe prokuroria publike ka ngritur akt akuza kundër 154 personave ku ka ulje për 58 persona, ndërsa gjykatat kanë sjellur aktgjykime të shkallës së parë kundrejt 137 personave ose për 23 persona më shumë.⁸⁷

Gjatë vitit 2012, nga prokuroritë publike, janë ngritur gjithsej 279 kallëzime penale për personat kryerës të veprave penale kundër mjedisit dhe së bashku me kallëzimet penale nga periudha e më hershme kundër 155 personave, në periudhën raportuese janë ngritur kallëzime

⁸⁷ Raporti për punën e prokurorive publike të RM-së, 2014, fq. 18
<http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/Izvestaj-na-JORM.pdf>

penale kundër 434 personave. Në vitin 2012, prokuroria publike ngriti gjithësej 164 aktakuza, ndërsa gjykatat kanë dhënë aktgjykime të shkallës së parë kundër 184 personave.

Në krahasim me vitin 2011 më herët kur janë ngritur kallëzime penale kundër 309 personave dhe të papërfunduara ndaj 114 personave ose gjithësej 423 personave, këtu kemi një ulje për 30 persona si dhe akuza ndaj 168 personave, kemi ulje prej 4 personash. Gjykatat kanë vendosur aktgjykime kundër 178 personave ose më shumë për 6 persona.⁸⁸

Në bazë të të dhënave nga Prokuroritë Publike të Republikës së Maqedonisë, për veprat penale kundër mjedisit jetësor në vitin 2009 janë pranuar kallëzime penale për gjithësej 147 persona dhe së bashku me kallëzimet penale të periudhës së mëhershme që janë kundër 32 personave, në periudhën raportuese është vepruar për kallëzimet penale kundër 179 personave. Prokuroritë publike në vitin 2009 kanë ngritur aktakuza kundër 78 personave. Gjykatat në vitin 2009 kanë sjellur aktgjykime të shkallës së parë kundrejtë 78 personave.⁸⁹

Gjykata e Lartë e RM-së

Në vitin 2014 në Gjykatën e Lartë të RM-së, janë paraqitur 5 (pesë) lëndë veprës penale – Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale dhe 1 (një) lëndë të veprës penale – Peshkim i paligjshëm.⁹⁰

Në vitin 2013, 2 (dy) lëndë për veprën penale – Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale dhe 2 (dy) lëndë për veprën penale – Peshkimi i paligjshëm.⁹¹

⁸⁸ Raporti për punën e prokurorive publike të RM-së, viti 2012, faqe 20

<http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2013/04/godishen-izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelstva-vo-republika-makedonija-za-2012-godina.pdf>

⁸⁹ Raporti për punën e prokurorive publike të RM-së, 2009, fq. 20

<http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2015/03/Godisen-izvestaj-za-2009-godina.pdf>

⁹⁰ Raport për punën e Gjykatës së Lartë të RM-së për vitin 2014, fq. 8

http://www.vsrn.mk/wps/wcm/connect/vsrn/2d951736-5e91-4069-bd7f-fb8ba8de0fc0/VSRM+izveshtaj+za+2014.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41LOB520APQFKICD0CU3-2d951736-5e91-4069-bd7f-fb8ba8de0fc0-ldWzOgu

⁹¹ Raport për punën e Gjykatës së Lartë të RM-së, 2013, fq. 6

http://www.osvinica.mk/wps/wcm/connect/vsrn/7c41727a-faa7-4a9e-aba4-0cc364114abc/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98+%D0%92%D0%A1%D0%A0%D0%9C-2013.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41LOB520APQFKICD0CU3-7c41727a-faa7-4a9e-aba4-0cc364114abc-lfR-DBU

Lëndë të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë e RM-së për veprat penale kundër mjedisit në vitin 2012, janë:⁹²

- 2 (dy) lëndë për veprën penale – Uzurpimi i paluajtshmërive
- 1 (një) lëndë për veprën penale – Eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale
- 1 (një) lëndë për veprën penale – Peshkim i paligjshëm, dhe
- 1 (një) lëndë për veprën penale – Rrezikimi i mjedisit jetësor me hedhurina

Në vitin 2011 është gjykuar vetëm për 1 (një) lëndë të veprës penale – Uzurpimi i paluajtshmërive.⁹³

3.3.1. Raportimet sipas të dhënave nga Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor i RM-së

Inspektorati Shtetëror për mjedisin jetësor në gjatë vitit 2014 ka vepruar për 3091 lëndë dhe ka përgatitur gjithsej 3091 Procesverbale për Konstatim të gjendjes faktike pas kryerjes së inspektimit në vend ngjarje. Në procedurë inspektimi ka sjellur 394 vendime prej të cilave 366 vendime me të cilat urdhërohet përkatësisht 28 vendime me të cilat ndalohen aktivitete të caktuara pas inspektimit të kryer. Janë parashtruar 72 kërkesa për procedurë kundërvajtëse. Përkaj kërkesave për procedurë kundërvajtëse nuk janë parashtruar kërkesa për procedurë penale. Janë dorëzuar gjithsej 141 njoftime/kërkesa deri te subjekte të ndryshme juridike dhe persona fizik. Janë përgatitur 614 procedura për ndërprerje të procedurës për arsye të pagesës së kompenzimit.⁹⁴

Në vijim do të paraqesim të dhënat në formë tabelare:

⁹² Raport për punën e Gjykatës së Lartë të RM-së, 2012, fq. 11
http://www.vsrn.mk/wps/wcm/connect/vsrn/c81484b0-73e9-431d-9666-08e4ab2aeacb/lzvestaj-VSRM-2012.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41L0B520APQFKICD0CU3-c81484b0-73e9-431d-9666-08e4ab2aeacb-lfR-DBU

⁹³ http://www.sud.mk/wps/wcm/connect/vsrn/7d4305b9-5d09-41d2-b6c0-2f12ddc0cc50/lzvestaj-VSRM-2011.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41L0B520APQFKICD0CU3-7d4305b9-5d09-41d2-b6c0-2f12ddc0cc50-lfR-DBU

⁹⁴ Raport për aktivitetet e kryera për vitin – Inspektorati Shtetëror për mjedisin, viti 2014, fq. 7

Tabela nr. III/17⁹⁵

Numri i mbikqyrjeve	Vendime Urdhëruese	Vendime Ndaluese	Procedurë Kundërvajtëse	Procedurë Penale	Njoftime	Përfundime
3091	366	28	72	0	141	614

Burimi: Inspektoriati Shtetëror për Mjedisin Jetësor i RM-së.

Mbikqyrjet nga Inspektoriati Shtetëror për Mjedisin Jetësor, për vitin 2014 janë realizuar në pajtim me Ligjet në vijim:⁹⁶

Tabela nr. III/18

Ligji	Mbikqyrjet e realizuara
Ligji për menaxhim me hedhurinat	1096
Ligji për mjedisin jetësor	1102
Ligji për menaxhim me hedhurinat e paketuara	864
Ligji për ujërat	154
Ligji për mbrojtjen e natyrës	165
Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit	13
Ligji për mbrojtje nga zhurmat e emetuara në mjedisin jetësor	35
Të tjerra	4

Burimi: Inspektoriati Shtetëror për Mjedisin Jetësor i RM-së.

Të dhënat nga Inspektoriati Shtetëror për Mjedisin Jetësor, të paraqitura në tabelën më lartë, tregojnë se numri më i madh i mbikqyrjeve është bërë në bazë të ligjit për mjedisin jetësor edhe atë në 1102 mbikqyrje, 1096 raste sipas ligjit për menaxhim me hedhurinat, ku 864 raste të tjera janë me ligjin për menaxhimi me hedhurina të paketuara. Mbikqyrjet e realizuara sipas ligjit për ujërat janë 154, ligji për mbrojtjen e natyrës 165, mbrojtjen nga zhurmat 35 mbikqyrje dhe vetëm 13 mbikqyrje për problemet më të theksuara që shfaqen periudhën e fundit për cilësinë e ajrit.

⁹⁵ <http://www.sei.gov.mk/uploads/Godisen%20Izvestaj%202014-DIZS%20grafik-final.pdf>

⁹⁶ Po aty

3.4. Analizë e përgjithshme për veprat penale kundër mjedisit jetësor, në rajonin e Tetovës dhe komunat për reth.

Në këtë kohë moderne në të cilën thirremi se jetojmë të gjithë, ku zhvillimet në teknologji kanë marrë hov të madh, dhe të njëjtat shfrytëzohen nga vendet e ndryshme në Evropë dhe më gjërë për të ndihmuar të gjitha proceset për zhvillim të shtetit dhe shoqërisë. Duke krahasuar këto zhvillime, Republika e Maqedonisë përballet me regres të madh ose të paktën këto të mira që na ofron teknologjia nuk shfrytëzohen për qëllime të mira, siç është mungesa e një aplikacioni të thjeshtë (deri në vitin 2014) me të cilin qytetarët do të njoftoheshin për cilësinë e ajrit dhe nivelin e grimcave të dëmshme në ajër, që vijnë si rezultat i ndotjes enorme.

Qytetarët e Tetovës, krahas problemeve në infrastrukturë rrugore, mungesës së transportit publik, komunikacionit të rënduar, ndërtimeve pa leje, po përballen edhe me ajrin e ndotur i cili është mbi nivelet e lejuara. Gjithë kjo ndotje që përmban në vete vulën e problemeve infrastrukturore e të tjerra që përmendëm më lartë, si dhe problemi tjetër që po shqetëson banorët e kësaj komune dhe më gjërë, fabrikat e ndryshme prodhuese që gravitojnë në këtë zonë dhe vazhdojnë punën duke mos respektuar standardet ekologjike dhe në masë të madhe ndotin ajrin që thithin qytetarët e Tetovës. Vlen të theksohet ndotësi më i madh që është fabrika “Jugohrom”, e cila vazhdon të punojë me intenzitet të lartë duke mos respektuar standardet e nevojshme ekologjike.

Në vitin 2014, më saktë 30 korrik, një subjekt politik në Republikën e Maqedonisë, në Prokurorinë Publike Themelore në Tetovë, dorëzon padi penale kundër fabrikës “Jugohrom” për ndotje të mjedisit jetësor dhe natyrës (KP, neni 218) dhe rrezikimin e mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina (KP, neni 230).⁹⁷

Siç është e shënuar në padinë penale:

“Padi penale, dorëzohet për rrezikim të shëndetit të qytetarëve të Komunës së Tetovës si dhe dëmtim të mjedisit jetësor, duke filluar nga viti 2005 (që kur ka hyrë në fuqi ligji për mjedisin jetësor) deri më sot, “Jugohrom”, nuk ka respektuar ligjin dhe nuk ka filluar me kohë që të

⁹⁷ <https://scoop.mk/vo-toksinoto-kralstvo-na-jugohrom/>

vëndojë pajisjet ekologjike dhe vazhdon të ndotë ambientin, duke mos marrë parrasysht ankesat e qytetarëve, paralajmërimeve si dhe dënimeve të institucioneve⁹⁸.

Më tej në padi vazhdon:

“Si fakte, dorëzojmë të dhënat e grimcave PM10 prej stacionit matës në Tetovë, për muajt e fundit, raport të vitit 2013 si dhe raport të detajuar prej vitit 2005 deri më 2013, ku lehtë mund të shihet tejkalimi i madh i kufirit të lejuar prej 50 mg/m³.⁹⁹

Prokuroria Publike Themelore në Tetovë, më 5 dhjetor të vitit 2014 u përgjigj deri te ngritësi i kallëzimit penal negativisht me arsyetimin se veprat e paraqitura nuk janë vepra që ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare.


Rezultat i këtyre politikave, ajri në Tetovë është shumë i ndotur dhe varion nga 5 deri në 20 herë më shumë sesa lejohet. Sipas matjeve zyrtare nga Ministria, ndotja mbi nivelin e lejuar është matur në 285 ditë gjatë vitit 2014. Në muajin dhjetor dhe janar, nuk ka pasur asnjë ditë kur ndotja e ajrit ka qenë ndër kufirin e lejuar prej 50 mikrogramë të grimcave të ngurta për metër kub.

Në vijim do të paraqesim rrjedhën e ndotjes me grimcat PM10 në qytetin e Tetovës për muajin dhjetor të vitit 2014:

⁹⁸ Кривична Пријава, бр. НН, датум НН, против Југохром Феролас, Основно Јавно Обвинителство Тетово 2014.

⁹⁹ По ату (ref. 98)

Grafikoni nr. III/19




Burimi: Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor

Siç mund të shihet në të dhënat e shfaqura në grafikonin më lartë, ndotja me grimca PM10 gjatë gjithë muajit dhjetor të vitit 2014 në qytetin e Tetovës ka qenë mbi kufirin e lejuar, në disa ditë të shfaqura ka arritur kulminacionin me 666 mg/m³ grimca PM10, ku është 10 herë më lartë së kufiri i lejuar prej 50mg/m³ PM10.

Grimcat PM10, janë të dëmshme për dëmtojnë rëndë shëndetin e qytetarëve. Rreziku i vdekjes nga kanceri, sëmundjet e frymëmarrjes dhe kardiovaskulare është për 13% më i lartë te njerëzit që janë të ekspozuar ndaj grimcave PM10 për një kohë të gjatë.

Nga viti 2010 deri në vitin 2013, numri i pacientëve me kancer është rritur me gati 80 %. Përveç qytetit të Tetovës, edhe në komunat në këtë rajon, ka një rritje të konsiderueshme të pacientëve me kancer, sipas të dhënave të paraqitura në vijim:

Raste të reja të diagnostifikuar me kancer



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

Siç mund të shihet në grafikonin më lartë, në Tetovë në vitin 2010 numri i pacientëve të diagnostifikuar me kancer ishte 1054, ndërsa tre vjet më vonë ky numër u rrit në 1801. Sipas numrit të përgjithshëm në këtë periudhë, komuna e Tetovës ka 4848 raste të reja.

Në vendin e dytë është Jegunovca, vendi ku ndodhet ndotësi fabrika “Jugohrom”, me një numër të përgjithshëm prej 402 pacientësh të rinj. Në vendin e tretë është komuna e Tearcës me 394 persona, në vendin e katërt është Bogovina me 253, në vendin e pestë është Brvenica me 145 ndërsa Zhelina është në vendin e gjashtë me 120 pacientë të rinj të diagnostifikuar me kancer gjatë tre viteve.

Sipas raportit të ISHP-së për vitin 2013, Tetova është në krye të listës për sa i përket numrit të fëmijëve të infektuar me sëmundje specifike të frymëmarrjes të shkaktuara nga ndotja me reth 6 herë mbi mesataren e lejuar shtetërore.

Kapitulli IV

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR NË RM NË NJË KONTEST KRAHASIMOR ME SHTETE TË TJERA DHE ME DIREKTIVAT E BASHKIMIT EVROPIAN MBI KRIMIN MJEDISOR

4.1. Vështrim krahasues mbi veprat penale kundër mjedisit

Si çdo përkufizim i përgjithshëm mbi veprat penale që janë me një objekt të grupit të veçante, edhe kuptimi i veprave penale kundër mjediisti jetësorë, element kryesorë e ka objektin konkret që llogaritet ndryshe mbrojtës, veçanërisht nga legjislacionet e ndryshme penale, kodet penale dhe formën se si duhet mbrojtur ky objekt nga veprat penale duke pasur në konsideratë natyrën e veçantë dhe efektet e tyre në fushën e ambientit jetësorë.

Ligjvënësit në vende të ndryshme, sigurisht që kanë të drejtën e zgjedhjes dhe implementimit të rregullave dhe ligjeve me anë të të cilëve do të rregullohen çështjet e mjedisit, mirëpo gjithmonë duke pasur në konsideratë legjislacionet ndërkombëtare, konventat e ndryshme, direktivat dhe të gjitha dokumentet tjerra me anë të të cilave janë rregulluar çështjet e mjedisit jetësorë dhe të cilat rregulla shtetet anëtare të organizatave të ndryshme ndërkombëtare duhet të implementojnë në legjislacionin e vet.

Në këtë kontekst ne do të analizojmë këto vepra sipas legjislacioneve të shteteve të ndryshme, si ato trajtojnë çështjet e mjedisit, si mbrojnë mjedisin dhe qytetarët. Legjislacioni i tyre në çfarë forme rregullon këto vepra, si janë të definuara në Kodet Penale dhe në ligje të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit. Do të pasqyrojmë sanksionet, dënimet e shqiptuara për kryerësit e veprave penale kundër mjedisit jetësor, llojet e dënimeve si dhe procedurat hetimore, duke analizuar edhe të dhënat statistikore për numrin dhe llojet e veprave penale që kryhen në këto vende.

4.1.1. Veprat penale kundër mjedisit në legjislacionin e SHBA-ve

Origjina dhe zhvillimi i ligjit penal për mjedisin, si në shumicën e vendeve edhe në SHBA, është në nevojën e parandalimit të ndotjeve të mjedisit që janë gjithnjë e më serioze në nivel ndërkombëtar po edhe në SHBA. Është konstatuar se shkaqet kryesore të ndotjes serioze të

ambientit, në lirinë ekonomike të kapitalizmit ndaj monopolit në procesin e zhvillimit ekonomik, për shkak të stagnimit ekonomik dhe menaxhimi social është jashtë kontrollit si rezultat i kofuzionit të menaxhimit dhe krizës sociale.¹⁰⁰

Krimet mjedisore kryhen në shumë komunitete në të gjithë vendet dhe ndodhin në një sërë ambientesh. Sidoqoftë, provat anekdotale tregojnë fuqishëm se një përqindje e lartë në mënyrë disproporcionale e krimeve mjedisore ndodh në komunitete që nuk kanë burime të përshtatshme për të parandaluar këto krime ose thjesht nuk kanë mjete efektive për të siguruar kompensim për shkeljet që ndodhin.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës rregullon aktivitetet që ndikojnë në mjedis përmes një skeme komplekse të statuteve dhe rregulloreve të agjencive. Në vitin 1970 në SHBA u themelua Agjencia e mbrojtjes së Mjedisit (EPA), për të zbatuar funksionin e integruar të mbrojtjes së mjedisit.

Agjencia e mbrojtjes së Mjedisit (EPA) mban përgjegjësinë për zbatimin e rregulloreve të përcaktuara në legjislacionin e Kongresit, por gjithashtu gëzon autoritetin për të nxjerrë rregullore shtesë. Këto rregullore ndikojnë dhe kanë impakt direkt në jetën e bimëve, habitatet e botës së egër, kafshët, cilësinë e tokës, cilësinë e ajrit, cilësinë e ujit, kontrollin e mbetjeve të rrezikshme, kufijtë e emetimeve të gazrave të dëmshëm dhe efektet e tyre në vendet rekreative.¹⁰¹ Sidoqoftë përshtatja dhe implementimi sipas rregulloreve mjedisore zakonisht për bizneset përbën kosto shtesë të shpenzimeve dhe investim shtesë për rregullimin e kësaj pjese. Në përpjekje për të shmangur këto kosto shtesë, disa biznese do të refuzojnë të zbatojnë rregulloret. Ndonjëherë bizneset refuzojnë hapur të zbatojnë dhe pajtohen që të paguajnë gjobën qeveritare për shkelje të rregullave sesa të paguajnë kostot e pajtueshmërisë, të cilat realisht tejkalojnë kostot totale të gjobave. Sidoqoftë biznese të tjera do të përpiqen të fshehin mos pajtueshmërinë e tyre, të tilla si hedhja e mbeturinave të rrezikshme në lumenj, përrenj, oqeanë ose zona të izoluar ndryshe, në vend që të paguajnë për ta marrë atë në një fabrikë për trajtim kimik. Lloje të tjera të zakonshme të shkeljeve të ligjit mjedisor përfshijnë mbeturinat, asgjësimi jo i duhur i mbeturinave, përdorimi i pesticideve ilegale në bujqësi,

¹⁰⁰ IOP Conf. Series: Earth and Environmental Science 188 (2018) 012014, Shanghai, China 2018, fq. 3

¹⁰¹ <https://www.epa.gov/aboutepa>

dioksid sulfui, dioksidin e azotit, monoksidin e karbonit dhe ozonin në sasi që tejkalojnë kufijtë rregullues, derdhjet e naftës, shkatërimi i ligatinave, djegja e mbeturinave, falsifikimi i të dhënave laboratorike që kanë të bëjnë me rregulloret e mjedisit, kontrabandë e kimikateve ilegale në vend si dhe kryerja e mashtrimit në lidhje me rregulloret mjedisore.

E drejta penale karakterizon një shkelje të ligjit mjedisor si një formë të krimit me jakë të bardhë. Nëse dënohen, shkelësit përballen me gjobë, me kusht, me burg ose me ndonjë kombinim prej këtyre. Në mënyrë tipike, një dënim me burg përdoret kur merren me individë, ndërsa korporatat përballen me gjoba të ashpra. Me gjoba përpiqen të kompensojnë përfitimin financiar të kryerjes së veprimtarisë së paligjshme.¹⁰²

4.1.2. Veprat penale kundër mjedisit në Gjermani

Mbrojtja e mjedisit është përcaktuar si një objektiv shtetëror (Staatsziel) në Kushtetutën gjermane (Grundgesetz) që nga viti 1994. Ajo parashikon që legjislatura, qeveria dhe të gjitha organet publike të përpiqen të ruajnë mjedisin dhe burimet natyrore në dobi të brezave të ardhshëm. Ky objektiv është mishëruar edhe në të gjitha kushtetutat e 16 shteteve (Bundeslander).¹⁰³ Legjislacioni gjerman lidhur me veprat penale kundër mjedisit ka një sistem sistematik dhe shkencor, ku referohet si sistem më i ashpër dhe i dënueshëm për krimet mjedisore.

Në Tabelën nr. IV/1 do të pasqyrojmë sistemin gjerman të ligjeve për mjedisin, zhvillimin e tyre ndër vite.¹⁰⁴ Zhvillimi i sistemit të përgjegjësisë penale për veprat penale ndaj mjedisit në Gjermani:

Tabela nr. IV/1.

Viti	Zhvillimi i sistemit të drejtës penale për veprat ndaj mjedisit	Kuptimi
1871	Për veprat penale kundër mjedisit dispozitat e para u shfaqën në Perandorinë Prusiane.	Sistem i parë i përgjegjësisë kriminale për veprat penale kundër mjedisit.

¹⁰² Environmental Law Violations, Legal Information Institute
https://www.law.cornell.edu/wex/environmental_law_violations

¹⁰³ Dr. Thomas Wölfl, Environmental law in Germany, Rechtsanwal 2018, fq. 49.

¹⁰⁴ XiaoJianMing OuYangGuangMing. Monograph on comparative law, Beijing: China environmental science press, 2004

1980	Kanë kaluar 18 metoda modifikimi të ligjit penal (i njohur gjithashtu si "ligji mjedisor"), duke shtuar "dëmin mjedisor".	Me qëllim që ligji penal mjedisor të bëhet më sistematik dhe shkencor.
1990	Reforma themelore e ligjit penat të mjedisit	Për të përmirësuar ndjekjen ndaj veprave të mjedisit që të parandalohen defektet më serioze
1994	Ndryshoni Kodin Penal dhe përsosni edhe më tej dispozitat përkatëse të përmbajtjes së krimit mjedisor	Për të forcuar më tej mbrojtjen efektive të ligjit penal ndaj mjedisit
1999	Në kodin e fundit penal krimi ka ndikuar që të vendosen dispozita të veçanta për krimet e mjedisit	Krimi mjedisor dhe përgjegjësia penale ka ndikuar për vendosjen e sistemit gjithëpërfshirës të rregullave
2002	Janë shtuar pjesët për të modifikuar të drejtën penale të mjedisit, "krimi i ujit të ndotur", krimi i ndotjes atmosferike", "krimi i hedhjes së mbeturinave në formë të paligjshme" etj.	Sistemi i krimit mjedisor merr një zhvillim të ri.

Ajo që përmenda më lartë mund të konstatohet se sistemi gjerman i përgjegjësisë penale të mjedisit filloi më herët, gjithashtu në pozitën udhëheqëse në shoqërinë bashkëkohore. Në të njejtën kohë, sipas afateve kohore ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, Gjermania çdo vit rriti dhe azhuroi legjislacionin përkatës mjedisor, në mënyrë që të sigurojë gjithëpërfshirjen e legjislacionit të përgjegjësisë mjedisore dhe të ndëshkojë krimet mjedisore.

Gjermania i kushton një rëndësi të madhe përdorimit të ligjit penal që do të thotë se dënimi është i keq për sjelljen e krimit në mjedis, kodi penal flet për rregullimin e modelit të së drejtës penale për mjedisin të njohur si "Modeli Gjerman". Kjo kryesisht bazohet në masat e ndëshkimit të dënimit dhe lirisë.

4.1.3. Veprat penale kundër mjedisit në Angli dhe Uells

Në Mbretërinë e Bashkuar ekzistojnë dy sisteme të ndryshme juridike: Anglia dhe Uellsit dhe Skocia. Legjislacioni në fushën e ligjit penal mjedisor është shumë i fragmentuar në shumë statute dhe rregullore, kryesisht për shkak të sasisë së konsiderueshme të reformave të kryera në njëzet vitet e fundit. Më e rëndësishmja është Ligji për mbrojtjen e mjedisit, i cili mishëron një sërë sanksionesh penale të zbatuara nga Autoritetet përkatëse.

Një nivel i caktuar i standardizimit të arritur është rezultati i transpozimit të Ligjit të BE-së, veçanërisht Direktivës së Krimit Mjedisor. Duket se në Mbretërinë e Bashkuar krimet mjedisore nuk janë përparësi për qeverinë ose për policinë kombëtare dhe lokale. Rregullat e procedurës penale të përgjithshme zbatohen për krimet mjedisore, megjithëse ekzistojnë disa rregulla të cilat janë specifike për krimet mjedisore. Shumica e krimeve mjedisore imponojnë një përgjegjësi të rreptë (d.m.th. nuk ka nevojë për të provuar fajin) gjë që, jo vetëm që lehtëson ligjvënësve të zbatojnë dhe ndjekin penalisht veprat penale dhe kryerësit e këtyre veprave penale kundër mjedisit, por gjithashtu përbëjnë një nxitje të fortë për operatorët që të marrin të gjitha masat e mundshme për minimizimin e rrezikut.¹⁰⁵

4.1.3.1. Legjislacioni në Mbretërinë e Bashkuar

Sistemi ligjor në Mbretërinë e Bashkuar nuk parashikon as një legjislacion të specializuar lidhur me krimin e organizuar mjedisore dhe më përgjithësisht legjislacionin kushtuar krimit të organizuar. Për shkak të transpozimit të legjislacionit evropian në sistemin ligjor në Mbretërinë e Bashkuar, oficerët përmbarues, siç është policia, mund të vendosin nëse është më e përshtatshme për të ndjekur penalisht krimin sipas legjislacionit të brendshëm ose sipas legjislacionit të BE-së ose të dyja.

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar miraton legjislacionin për Anglinë dhe për disa çështje në Uells. Për të gjitha çështjet e mbetura në Uells, Asambleja Kombëtare për Uellsin ka autorizime për të miratuar ligjin. Në Angli, organi kryesor përgjegjës për zhvillimin e politikave mjedisore dhe hartimin e legjislacionit mjedisor është Departamenti për Biznes, Energji dhe Strategji Industriale (DEFRA) i cili përgjithësisht trajton çështje që lidhen me ndryshimin e klimës. Përveç vendit ku qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka kompetencë qeveria Uellsiane zhvillon politikën mjedisore për Uellsin.

Agjencia e Mjedisit (EA) (në Uells, Natural Resources Wales – NRW) është organi kryesor përgjegjës për lëshimin e lejeve dhe zbatimin, megjithëse në disa raste autoritetet lokale (LA) i kryejnë këto funksione.¹⁰⁶

¹⁰⁵ <https://efface.eu/fighting-environmental-crime-uk-country-report>

¹⁰⁶ <https://www.gov.uk/government/organisations/environment-agency>

4.1.3.2. Dënimet për veprat penale kundër mjedisit në Mbretërinë e Bashkuar

Sanksionet për shkeljen e shumicës së ligjeve mjedisore (pra depozitimi i paautorizuar ose i dëmshëm i mbeturinave, shkarkimet e paligjshme në ajër, tokë dhe ujë) është ndjekja penale e një individi ose ndërrmarje nga rregullatori përkatës në gjykatat penale. Dënimet maksimale zakonisht janë si më poshtë:¹⁰⁷

- Gjykatat e ulëta: gjobë e pakufizuar (50,000 GBP për vepra të kryera para 12 mars 2015) dhe/ose gjashtë muaj burgim. Legjislacioni ka qenë prej kohësh në fuqi për të rritur afatin maksimal të burgimit në 12 muaj, por ky ndryshim nuk është sjellë në fuqi. Disa vepra më pak serioze parashikojnë dënime të ndryshme maksimale deri në 5,000 GBP.
- Gjykatat e larta: burgim të pakufizuar dhe/ose pesë vjet burg.

Drejtorët dhe zyrtarët e ndërmarrjeve mund të ndiqen penalisht nëse vepra penale është kryer me pëlqimin ose vetëdijen e tyre, ose i atribuohet neglizhencës së tyre.

Personat fizik mund të paraqesin pretendime të ligjit civil për dëmin e shkaktuar nga çështjet mjedisore, zakonisht nën ligjin e zakonshëm të bezdisjes ose neglizhencës. Kërkesat zakonisht janë për dëmshpërblim, por gjykatat gjithashtu mund të japin urdhër.

Agjensia e Mjedisit (EA) si rregullator kryesor i merr fuqishëm autorizimet e saj zbatuese. Sidoqoftë ajo nuk ka burimet e nevojshme për ti zbatuar në çdo rast dhe për këtë arsye ka miratuar një politikë përmbarimi dhe ndjekjeje për ta ndihmuar atë në vendosjen se cilat raste duhet të ndjekë. Zbatimi është përgjithësisht diskrecional, por në disa raste ekzekutimi është i detyrueshëm. Për shembull EA ose autoriteti lokal (LA) duhet të shërbejë një njoftim për përmirësimin nëse gjen se toka do të ndotet, përveç nëse riparimi mund të kryhet në mënyrë vullnetare. Prandaj EA ka tendencën për të dhënë përparësi ndaj shkeljeve të përsëritura.¹⁰⁸

¹⁰⁷ Michael Coxall and Elizabeth Hardacre, Clifford Chance LLP, Environmental law and practice in the UK (England and Wales)

¹⁰⁸ [https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/6-503-1654?transitionType=Default&contextData=\(sc.Default\)&firstPage=true&bhcp=1](https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/6-503-1654?transitionType=Default&contextData=(sc.Default)&firstPage=true&bhcp=1)

4.1.4. Veprat penale kundër mjedisit në Francë

E drejta e mjedisit në Francë është zhvilluar që nga mesi i viteve 70-të të shekullit XX, me dy ligje të miratuara në vitin 1976, njëri për mbrojtjen e natyrës dhe njëri për objektet e klasifikuara për mbrojtjen e mjedisit (Installations classées pour la protection de l'environnement, ICPE). E nxitur fillimisht nga zhvillimi i nismave ndërkombëtare si Konferenca e Stokholmit e vitit 1972 dhe integrimi i shqetësimeve mjedisore në politikat e KE në Evropë, kjo temë gjen evolucion dhe rritje në Francë. Në vitet e fundit Parisi është bërë fortesë e risive dhe arritjeve themelore ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke filluar me aktvendimet e famshme për rastin e naftëtarit Erika (2008-2012) duke njohur konceptin e dëmtimit ekologjik, duke vazhduar me miratimin e Marrëveshjes historike të Parisit në dhjetor të vitit 2015 për ndryshimet klimatike, miratimi i ligjeve të vitit 2016 mbi tranzicionin e energjisë për rritjen e gjelbër dhe mbi biodiversitetin (me futjen e parimit të mos regresionit) dhe përfundimin me fillimin ndërkombëtar nga Presidenti i Republikës Franceze të draft-paktit global për mjedisin në vitin 2017.¹⁰⁹

4.1.4.1. Legjislacioni në Francë

Në vitin 2008 Corinne Lepage, president i lëvizjes për mjedisin “Cap 21” dhe ish-ministri i Mjedisit, propozoi futjen në nenin 521-1 të Kodit Penal Francez termin, veprën penale “délinquanceécologique”, e cila përbëhet nga: lëshimi, shkarkimi, emetimi ose prezantimi me njohuri mbi rrezikun eventual prej substancave të rrezikshme si mbeturinat, vajrat, vajrat e mbeturinave ose ndonjë substance që ka të ngjarë të rrezikojë shëndetin e njeriut, kafshëve ose mjedisin natyror, në tokë, atmosferë, në ushqime ose ujëra përfshirë ato të detit territorial siç janë:

- Trajtimin, deponimin, transportin, eksportin, importin e paligjshëm të mbeturinave të rrezikshme;
- Posedimi, marrja, dëmtimi, përpunimi, vrasja ose tregëtia e paligjshme e organizmave të gjallë ose pjesë e këtyre;

¹⁰⁹Alogna, Ivano, "Environmental Law of France", 2018/10/19
https://www.academia.edu/37680496/Environmental_Law_of_France

- Përkeqësimi i ndjeshëm i një habitati të mbrojtur
- Zhurma që i nënshtrohet rregulloreve specifike
- Tregtia e substancave që shkatërrojnë ozonin (ODS)
- Veprat penale që përfshijnë përdorimin e lehtësive të klasifikuara
- Përdorimi i produkteve kimike dhe organike të paautorizuara ose mosrespektimi i standardeve të autorizuara ose kërkesave të licencimit, kushteve të prodhimit, funksionimit, përdorimit ose hulumtimit eksperimental të këtyre produkteve.

4.1.4.2. Dënimet për veprat penale kundër mjedisit në Francë

Në sistemin penal francez ekzistojnë tre lloje të sanksioneve penale:

- *peines principale*, (dënime të mëdha);
- *peines alternatives* (dënime alternative), dhe
- *peines complementaires* (dënime shtesë).

Dënimet kryesore që zbatohen për personat fizik për kryerjen e një krimi janë *reclusion criminelle* (burgimi) dhe ndalimi penal i cili është dënimi i parashikuar për disa shkelje të interesave themelore të Kombit. Periudha minimale për një afat të caktuar burgimi ose ndalimi penal është dhjetë vjet (neni 131-1 KP). Dënimet maksimale përkatësisht janë burgim penal për gjithë jetën ose paraburgim penal për gjithë jetën. Dënimet kryesore që zbatohen për personat fizik janë: burgosje, gjobitje, gjobitje ditore, edukim-kurs qytetarie, gjoba që sjellin në konfiskim ose kufizim të të drejtave, dënime shtesë, dënimi i dëmshpërblimit (neni 131-3 i KP francez).¹¹⁰

4.1.5. Veprat penale kundër mjedisit në Itali

Në sistemin juridik italian, mbrojtja kriminale e mjedisit bazohet pothuajse të rësisht në një seri të kundërvajtjeve (kontravvenzioni), të cilat janë jashtë Kodit Penal. Veprat penale për administrimin e mbeturinave, ndotjen e ujit dhe ndotjen e ajrit parashikohen kryesisht nga Kodi i Mjedisit. Sidoqoftë, vlen të përmendet se Kodi i Mjedisit nuk përmban të gjitha dispozitat për

¹¹⁰ Kodi Penal Françez, <https://www.legislationline.org/documents/section/criminal-codes/country/30/France/show>

krimin mjedisor, me veprat penale në sektorët e mjedisorë përkatës (p.sh. ato për mbrojtjen e florës dhe faunës) të parashikuara nga statutet e tjerra. Në këtë drejtim, praktikuesin (prokurori, policia) vërejnë se një nga mangësitë e legjislacionit italian për krimet e mjedisit është që dispozitat përkatëse gjenden në akte të ndryshme (p.sh. Kodi i Mjedisit, Kodi Penal, Leg. Dec. 231/2001 etj.)¹¹¹. Ata gjithashtu theksojnë përhapjen e tepërt të normave në këtë fushë, në veçanti, praktikuesit (gjykatësit) theksojnë faktin se ndryshimi i vazhdueshëm në ligjet administrative mjedisore kërkon një azhurim të vazhdueshëm nga ana e autoriteteve përmbarimore dhe kjo mundet të ndikojë negativisht në zbatimin e dispozitave penale mjedisore.

4.1.5.1. Të dhëna statistikore për veprat penale kundër mjedisit në Itali,

Në tabelën në vijim do të ju shfaqim të dhëna statistikore për veprat penale kundër mjedisit në Itali, sipas rajoneve, viti 2011-12¹¹², pjesa Veriore (Piedmont, Lugina e Aostës, Lombardia, Liguria, Trentino-Alto Adige, Veneto, Friuli-Venezia Giulia, Emilia-Romagna):¹¹³

Tabela nr. IV/2.

SEKTORI OPERATIV	Kontrolli		Personi		Dënime në EURO	Sekuestrime në EURO
	numri	Prej të cilëve nuk përputhen	Të paraqitur	arrestuar		
Vepra penale të zhurmës	6	1	1	0	0	0
Ndotja e ambientit	41	15	22	0	36.2	368
Ndotja e tokës	290	203	355	4	237.214	43.466.234
Ndotjet elektromagnetike	0	0	0	0	0	0
Ndotja e ujit	35	9	11	0	6.516	65
Ndotje të lehtë	0	0	0	0	0	0
Ndotja e pejsazhit/ndërtimet pa leje	37	19	27	0	0	1
Ndotjet radioaktive	1	1	0	0	0	5
Organizma të modifikuar gjenetikiht	0	0	0	0	0	0
Vija ndër kufitare	16	4	8	0	0	0
GJITHSEJ	426	252	424	4	279.93	43.905.234

¹¹¹ Kodi Penal Italian, <https://www.brocardi.it/codice-penale/>

¹¹² Ministry of the Environment and protection of land and sea – (Comando Carabinieri per la tutela dell’ambiente)

¹¹³ https://www.minambiente.it/sites/default/files/archivio/allegati/vari/controlli_carabinieri_2012.pdf

Të dhënat e paraqitura tregojnë se për gjithsej 426 kryerës persona fizik/juridik, 4 prej tyre janë arrestuar, dënime në euro janë shqiptuar në vlerë rreth 300 euro, ndërsa konfiskim të pasurisë është bërë në vlerë rreth 44.000 euro.

Në vijim do të ju paraqesim të dhënat statistikore për pjesën qendrore të Italisë (Toscana, Umbria, Marche, Lazio):

Tabela nr. IV/3.

SEKTORI OPERATIV	Kontrolli		Personi		Dënime në EURO	Sekuestrime në EURO
	numri	Prej të cilëve nuk përputhen	Të paraqitur	arrestuar		
Vepra penale të zhurmës	42	2	15	0	0	0
Ndotja e ambientit	85	35	34	0	0	0
Ndotja e tokës	226	77	103	0	18.861	36.165.030
Ndotjet elektromagnetike	2	0	0	0	0	0
Ndotja e ujit	100	25	32	0	18	8.800.000
Ndotje të lehtë	0	0	0	0	0	0
Ndotja e pejsazhit/ndërtimet pa leje	84	16	28	0	0	18.200.300
Ndotjet radioaktive	0	0	0	0	0	0
Organizma të modifikuar gjenetikiht	0	0	0	0	0	0
Dëmet nga aksidentet e mëdha	5	2	2	0	0	0
Vija ndër kufitare	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	544	157	214	0	36.861	63.165.330

Të dhënat statistikore të paraqitura në tabelën më lartë tregojnë se numri i përgjithshëm i personave është 544, ku 214 prej tyre janë të paraqitur. Dënime në euro janë shqiptuar në vlerë rreth 37.000 euro, ndërsa konfiskim i pasurisë është bërë në vlerë prej 63.165 euro.

Në tabelën në vijim do të paraqesim të dhënat për veprat penale të mjedisit jetësor në pjesën jugore të Italisë (Abruzzo, Molise, Campania, Puglia, Basilicata, Calabria, Sicilia, Sardegna):

Tabela nr. IV/4.

SEKTORI OPERATIV	Kontrolli		Persona		Dënime në EURO	Sekuestrime në EURO
	numri	Nuk përputhen	paraqitur	arestuar		
Vepra penale të zhurmës	45	5	5	0	0	0
Ndotja e ambientit	278	119	154	8	117.489	570.275.270

Ndotja e tokës	809	443	647	31	595.023	1.192.034.040
Ndotjet elektromagnetike	1	0	0	0	0	0
Ndotja e ujit	414	251	287	2	616.382	141.519.000
Ndotje e lehtë	0	0	0	0	0	0
Ndotja e pejsazhit/ndërtimet pa leje	212	127	211	4	132.848	62.250.000
Ndotjet radioaktive	3	2	3	0	0	0
Organizma të modifikuar gjenetikisht	0	0	0	0	0	0
Dëmet nga aksidentet e mëdha	10	7	10	0	0	0
Vija ndër kufitare	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	1.772	954	1.317	45	1.461.742	1.966.078.310

Të dhënat e paraqitura tregojnë numrin më të madh të veprave në këtë pjesë të Italisë edhe atë gjithsej 1772 kryerës persona fizik/juridik, 45 prej tyre janë arrestuar, dënime në euro janë shqiptuar në vlerë rreth 1.500 euro, ndërsa konfiskim të pasurisë është bërë në vlerë rreth 2 milion euro.

Në vijim do të paraqesim të dhënat statistikore për veprat penale kundër mjedisit jetësor në të gjithë territorin e Italisë:

Tabela nr. IV/5.

SEKTORI OPERATIV	Kontrolli		Persona		Dënime në EURO	Sekuestrime në EURO
	numri	Nuk përputhen	paraqitur	arrestuar		
Vepra penale të zhurmës	93	8	21	0	0	0
Ndotja e ambientit	404	169	210	8	153.689	570.643.270
Ndotja e tokës	1.325	723	1.105	35	851.098	1.271.665.304
Ndotjet elektromagnetike	3	0	0	0	0	0
Ndotja e ujit	549	285	330	2	640.898	150.384.000
Ndotje e lehtë	0	0	0	0	0	0
Ndotja e pejsazhit/ndërtimet pa leje	333	162	266	4	132.848	80.451.300
Ndotjet radioaktive	4	3	3	0	0	5
Organizma të modifikuar gjenetikisht	0	0	0	0	0	0
Dëmet nga aksidentet e mëdha	15	9	12	0	0	0
Vija ndër kufitare	16	4	8	0	0	0
GJITHSEJ	2.742	1.363	1.955	49	1.778.533	2.073.148.874

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë mund të shihet se në të gjithë territorin e Italisë për periudhën 2011-12, gjithsej paraqiten 2742 vepra, numri i personave të

paraqitur është 1955, gjithsej janë arrestuar 49 persona. Dënime të shqiptuara në euro gjithsej janë 1.778.533 euro, konfiskim të pasurisë/sendeve është bërë në vlerë të përgjithshme prej 2.073.148.874 euro.

4.1.6. Veprat penale kundër mjedisit në Kroaci

Brenda ligjit kombëtar si dhe ndërkombëtar të mjedisit, katër dekadat e fundit kanë qenë një kohë në të cilën ndërtimi sistematik i një regjimi juridik për mbrojtjen e mjedisit ka evoluar në përputhje me njohjet dhe nevojat e reja. Në Republikën e Kroacisë, është bërë një hap i rëndësishëm përpara në standardizimin ligjor të zonës së mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit.

Duke konsideruar se një nga detyrimet e Republikës së Kroacisë për pranimin në Bashkimin Evropian ishte që të harmonizojë legjislacionin mjedisor të saj me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ndryshimet ligjore të zbatuara janë shkaktuar pjesërisht nga ky proces dhe pritet që zgjidhjet ligjore kombëtare dhe evropiane të vazhdojnë për tu zhvilluar dhe përsosur më tutje.¹¹⁴

Kroacia ka zgjedhur që të miratojë udhëzimet për zhvillim të qëndrueshëm, të cilat në të njëjtën kohë i sigurojnë edhe zhvillimin ekonomik dhe drejtësinë sociale si dhe kushtet për mbrojtjen e burimeve natyrore, të cilat padyshim përfaqësojnë pasurinë më të madhe të vendit. Për interesat e ekonomisë dhe nevojat e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të besohet se Udhëzimet e zhvillimit të qëndrueshëm janë pasqyruar në ligje dhe akte nënligjore të përpunuar në drejtim të Ligjit për Mjedisin.¹¹⁵

4.1.6.1. Veprat Penale kundër mjedisit sipas Kodit Penal të Kroacisë

Kodi Penal Kroat, në pjesën XX të tij rregullon veprat penale kundër mjedisit duke specifikuar krimet e mjedisit (neni 193), duke shkarkuar substancat ndotëse nga anijet (neni 194), rrezikimin e shtresës së ozonit (neni 195), rrezikimi i mjedisit me mbeturinat (neni 196), rrezikimi i mjedisit me bimët industriale (neni 197), rrezikimi i mjedisit nga substanca

¹¹⁴ J. Omejec i M. Seršić, PRAVO ZAŠTITE OKOLIŠA, EKOLOŠKO PRAVO, Zagreb, 2003, fq. 89

¹¹⁵ Goodstein Eban, Ekonomika i okoliš, MATE, Zagreb, 2003.

radioaktive (neni 198), rreziku nga dridhjet, zhurmat ose rezatimi jonizues (neni 199), shkatërimi i zonave të mbrojtura të natyrës (neni 202), futja e paligjshme e kafshëve të egra në mjedis (neni 203), gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm (neni 204), vrasja ose torturimi i kafshëve (neni 205), transmetimi i sëmundjeve ngjitëse dhe dëmtimi i bimëve (neni 206).¹¹⁶

4.1.6.2. Të dhëna statistikore për veprat penale kundër mjedisit në Republikën e Kroacisë

Në tabelën në vijim do të ju shfaqim të dhënat statistikore për veprat penale kundër mjedisit në Republikën e Kroacisë, sipas llojeve të veprave penale, rasteve të paraqitura, sa prej atyre rasteve janë zgjidhur dhe për sa raste janë zbuluar edhe vepra të tjera pasuese, për periudhën kohore 2013-14¹¹⁷:

Tabela nr. IV/6.

Veprat penale kundër mjedisit	Të paraqitura			Të zgjidhura		Janë zbuluar edhe vepra pasuses			
	Gjithsej	Të kapur	Panjohur	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Periudha e mëparshme	%i
Ndotja e mjedisit	1		1	1	100,0	1	100,0		100,0
Ndotja e ambientit me hedhurina	3		2	2	66,7	1	50,0		50,0
Shkatërimi i specieve natyrore të mbrojtura	9	7	1	8	88,9				
Tregëtimi në zona të ndaluara	2	2		2	100,0				
Gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm	55	9	41	27	49,1	13	31,7	1	29,3
Vrasja ose torturimi i kafshëve	111	5	93	77	69,4	59	63,4		63,4
Shkretimi i pyllit	6		5	4	66,7	3	60,0		60,0
Gjithesj – veprat e përgjithshme	187	23	143	121	64,7	77	53,8	1	53,1
Shfrytëzimi i paligjshëm i xeheve	2		1	2	100,0	1	100,0		100,0
Ndërtim i paligjshëm	11		3	11	100,0	3	100,0		100,0
Gjithesj - krim ekonomik	13		4	13	100,0	4	100,0		100,0
GJITHSEJ	200	23	147	134	67,0	81	55,1	1	54,4

Të dhënat statistikore të paraqitura në tabelën e mësipërme për vitin 2014 tregojnë gjithsej 200 vepra penale kundër mjedisit të paraqitura, nëse do të shihnim në % numri i

¹¹⁶ Kodi Penal Kroat, <https://www.zakon.hr/z/98/Kazneni-zakon>

¹¹⁷ Raporti vjetor i ministrisë së punëve të brendshme të Kroacisë, teksti në gjuhën kroate (MINISTARSTVO UNUTARNJIH POSLOVAGLAVNO TAJNIŠTVOSLUŽBA ZA STRATEŠKO PLANIRANJE, STATISTIKU I UNAPRJEĐENJE RADA, MUP RH – Glavno tajništvo - Služba za strateško planiranje, statistiku i unaprjeđenje rada) <https://mup.gov.hr/UserDocImages/statistika/2018/Statisticki%20pregled%20temeljnih%20sigurnosnih%20pokazatelja%20i%20rezultata%20rada%20u%202013.%20godini.pdf>

rasteve të zgjidhura shkon në 67 %. Në 81 raste të personave kryerës të këtyre veprave janë zbuluar edhe vepra penale tjerra pasuese.

Në vijim do të paraqesim një vështrim krahasues i veprave penale kundër mjedisit, për vitet krahasuese 2013-2014¹¹⁸:

Tabela nr. IV/7.

Veprat penale kundër mjedisit	Të paraqitura			Të zgjidhura			2014. % gjithsej të paraqitur
	Numri i v.p.		+ - %	Numri i v.p.		+ - %	
	2013.	2014.		2013.	2014.		
Ndotja e mjedisit	2	1	-50,0	2	1	-50,0	0,5
Ndotja e ambientit me hedhurina		3			2		1,5
Shkatërrimi i specieve natyrore të mbrojtura	11	9	-18,2	9	8	-11,1	4,5
Tregëtimi në zona të ndaluara	1	2	+100,0	1	2	+100,0	1,0
Gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm	56	55	-1,8	28	27	-3,6	27,5
Vrasja ose torturimi i kafshëve	59	111	+88,1	46	77	+67,4	55,5
Shkretimi i pyllit	9	6	-33,3	7	4	-42,9	3,0
Gjithesj – veprat e përgjithshme	138	187	+35,5	93	121	+30,1	93,5
Shfrytëzimi i paligjshëm i xeheve	116	2	-98,3	115	2	-98,3	1,0
Ndërtim i paligjshëm	11	11	0,0	11	11	0,0	5,5
Gjithesj - krim ekonomik	127	13	-89,8	126	13	-89,7	6,5
GJITHSEJ	265	200	-24,5	219	134	-38,8	100,0

Të dhënat statistikore të paraqitura në tabelën më lartë tregojnë se numri i veprave penale kundër mjedisit në vitin 2013 ka qenë më i lartë se ai i shfaqur në vitin 2014, për 65 vepra. Nëse do të shihnim rastet e zgjidhura në vitin 2013 ato janë 219 raste dhe në % numri i rasteve të zgjidhura në vitin 2013 është më i madh në krahasim me 134 raste të zgjidhura në vitin 2014.

4.1.7. Veprat penale kundër mjedisit në Kosovë

Republika e Kosovës, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së saj në vitin 2008, ku në qershor të këtij viti hyri në fuqi edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në legjislacionin e saj rregulloi edhe çështjet që kanë të bëjnë me veprat penale kundër mjedisit.

¹¹⁸ Po aty (ref. 117)

Legjislacioni mjedisor bazohet kryesisht në Kushtetutë e Republikës së Kosovës dhe përfshin lloje të ndryshme të ligjeve, të përgjithshme dhe ligje të veçanta për mjedisin, përbërësit e tij, akte normative, vendime të qeverisë, udhëzime të ministrive, rregullore specifike, norma dhe standarde të ndryshme. Legjislacioni i Republikës së Kosovës për fushën e mjedisit përputhet me standardet e Bashkimit Evropian, sepse ai mbështetet në parimet e njejta që mbështetet edhe legjislacioni evropian për mjedisin.¹¹⁹

Ligji kryesor për mbrojtjen e mjedisit, pas Kushtetutës është Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

Ky ligj ka për synim¹²⁰:

- Të promovoj krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës
- Të rregullojë përdorimin racional të burimeve natyrore dhe pakësimin e shkarkimeve ndotëse në mjedis.
- Të bashkërendojë veprimtaritë shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit
- Të sigurojë se zhvillimi në Kosovë është i qëndrueshëm në mënyrë që toka, ajri, uji dhe burimet tjerra jetese të mbrohen dhe ruhen për të mirën e gjeneratave të ardhshme të Kosovës.
- Të promovojë masa regjionale dhe ndërkombëtare për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit.

Nisur nga ky Ligj mund të konstatojmë se Republika e Kosovës i njeh dhe respekton parimet ndërkombëtare të rregulluara me konventa, direktiva, protokolle, dokumente dhe rregullore tjerra në fushën e mjedisit.

Shkeljet administrative mjedisore, kundërvajtjet dhe krimet në Kosovë janë të lidhura me situata të varfërisë ekstreme dhe pasojave të luftërave të mëparshme. Siç theksohet në (Raportin vjetor IPA 2013) “situata është mjaft e vështirë në zonat urbane për shkak të demografisë së ndryshuar dhe presionit të migracionit nga zonat rurale në ato urbane. Kjo reflektohet edhe në ndërtimet e paplanifikuara, një mjedis urban i menaxhuar dobët dhe

¹¹⁹ Neni 52, Përgjegjësia për mjedisin, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008

¹²⁰ Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 50, publikuar më 06.04.2009

shërbime publike joefikase si mbledhja e mbeturinave, trajtimi i ujërave të ndotur, kanalizimet etj. Gjithashtu ndotja nga termocentralet dhe aktivitetet tjera paraqesin kërcënim serioz për shëndetin e qytetarëve". Mungesa e reagimit nga autoritetet përkatëse përbën shkelje edhe më të rëndë mjedisore dhe kriminale.¹²¹

Problemet më të theksuara mjedisore në Republikën e Kosovës janë:

- Shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore dhe minerale
- Niveli i lartë i ndotjes si rrjedhojë e dendësisë së madhe të popullsisë
- Aktivitetet ekonomike me ndikim të madh në mjedis, veçanërisht në prerjet dhe minierat
- Niveli i lartë i ndotjes së ajrit

Në këtë skenar, krimi mjedisor është i lidhur me mungesën e respektimit të rregullave themelore të miratuara për mbrojtjen e mjedisit si ato të mëhershmet nga UNMIK (UNSCRS 1244/99) por edhe pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008.

Në Kodin Penal të Kosovës, vepra penale kundër mjedisit për dallim nga KP i RM-së, parrashihen së bashku me veprat penale kundër objekteve kulturore. Ashtu sikur edhe në Kodin Penal të RM-së, në rastet kur vepra penale është e dënueshme, pavarësisht nga forma e fajit me të cilën është kryer, për çdo formë të fajit qoftë me dashje, nga pakujdesia janë të parashikuara në paragrafë të veçantë dhe për çdo formë veçmas shënohet dënimi që mund të shqiptohet. Politika e dënimeve sipas KP të Kosovës është shumë identiek me KP të RM-së, dallon pjesa e shqiptimit të dënimit maksimal që në KP të Kosovës është deri në 12 vjet për veprën penale Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme, nëse si rrjedhojë e kësaj vepre do të rezultonte me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi kryerësi do të dënohej me dënim prej 3 deri në 12 vjet¹²², për dallim nga KP i RM-së, ku dënimi maksimal që shqiptohet është deri në 10 vjet burgim.¹²³

¹²¹ Instrument for Pre-accession Assistance, IPA 2013 Annual Programme. Waste Management 09-2012/02, pp. 1-2.

¹²² Kodi nr. 06/L-074 Penal i REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 Janar 2019, Prishtinë

¹²³ Afrim Osmani, Kodi Penal i RM-së, Shkup 2010, Vepra të rënda kundër mjedisit jetësor dhe natyrës, neni 234, paragrafi 1

Kapitulli V

POLITIKA E DËNIMIT PËR VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SI DHE MASAT PARANDALUESE

5.1. Dënimet sipak Kodit Penal të RMV-së për veprat penale kundër mjedisit jetësor

Askujt nuk mundet që ti shqiptohet dënim apo ndonjë sanksion tjetër penal për vepër, e cila para se të kryhet nuk ka qenë e caktuar me ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë si vepër penale dhe për të cilën nuk ka qenë i paraparë dënim me ligj.¹²⁴

Përpos inkriminimit të sjelljeve të ndryshme që adresohen kundër mjedisit jetësor, element tjetër i rëndësishëm për sigurimin e mbrojtjes juridike penale të mjedisit jetësor që mbrojtja të jetë sa më efektive është edhe plotikia e dënimeve që shteti ndjek për veprat penale që kryhen kundër mjedisit jetësor.¹²⁵

Në studimet e ndryshme të kryera në fushën e veprave penale kundër mjedisit jetësor është vlerësuar se dënimet e ulëta dhe llojet jo të përshtatshme dhe të mjaftueshme të tyre mund të kthehen në një shqetësim të madh dhe shumë serioz në luftën kundër kriminalitetit mjedisor. Niveli shumë i ulët mund të vërë në dyshim edhe vetë efektin parandalues, duke bërë kështu që ato të kthehen edhe në faktorë që do të ndikonin në rritjen potenciale të kriminalitetit mjedisor. Qasja tjetër drejt skemës së përshkallëzuar të dënimeve të parashikuara për veprat penale kundër mjedisit jetësor, përshtatur me shkallën e rrezikshmërisë së rrezikimit ose dëmtimit të shkaktuar nga këto vepra, mund që të shërbej në përmirësimin e metodave që përdoren nga shtetet në përpjekjen për mbrojtje sa më efektive të mjedisit dhe përbërësve të tij.

Qëllimet e ndëshkimit të kryerësve të këtyre veprave, përpos realizimit të drejtësisë, janë edhe pengimi i kryerësit të kryej vepra penale dhe riedukimi i tij, si dhe të ndikojë ndaj të tjerëve që të mos kryejnë vepra penale.¹²⁶

¹²⁴ Shih nenin 1 të Kodit Penal të RM-së.

¹²⁵ Ismet Elezi, Politika Kriminale, Tiranë 2006, f. 101

¹²⁶ Shih nenin 32 të KP të RM-së.

Në bazë të Kodit Penal në fuqi, llojet e dënimeve kryesore të parashikuara për personat fizik për veprat penale të kryera kundër mjedisit jetësor, shqyptohen dënimet me gjobë dhe dënime me burgim.

Dënimi me gjobë shqyptohet me anë të gjobave ditore, me çka numri i gjobave ditore nuk mund të jetë më i vogël se pesë dhe më i madh se 360 gjoba ditore. Gjykata bën matjen e numrit të gjobave ditore dhe cakton lartësinë e gjobës ditore.¹²⁷

Dënimi me burgim sipas KP të RM-së nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë dhe as më i gjatë se 15 vjet.¹²⁸

Në vijim do të analizojmë veprat penale kundër mjedisit dhe dënimet e caktuara për këto vepra, në bazë të Kodit Penal në fuqi në Republikën e Maqedonisë.

5.1.1. Vepra penale e ndotjes së ambientit jetësor

Vepra penale, “Ndotja e mjedisit jetësor dhe natyrës”, në Kodin Penal parashihet në nenin 218. Paragrafi 1 i këtij neni përcakton se ai që me lëshimin e gazrave helmues më tepër se sasitë e lejuara me ligj për materialet ose rrezatimin jonizues në ajër, ujë ose tokë, dhe do të shkaktojë dëme të konsiderueshme në ujë, tokë dhe ajër dhe do të rrezikojë jetën dhe shëndetin e njerëzve ose shkatërrimin e florës dhe faunës në një shkallë të madhe, ose speciet e rralla të bimëve ose kafshëve, do të dënohet me burgim prej katër deri në dhjetë vjet.¹²⁹

Personi zyrtar apo përgjegjës në personin juridik, përshkruhet në paragrafin 2 të nenit 218, i cili duke mos respektuar rregullat e mbrojtjes së mjedisit do të lëshojë të vendosë pajisjet për pastrim apo do të lejoj ndërtimin, lejim në veprim apo shfrytëzimin e repartit i cili e ndot mjedisin jetësor apo në mënyrë tjerët do të lejojë ndërmarrjen e masave për pengimin ose pamundësimin e ndotjes së ajrit, truallit, ujit, sipërfaqjes ujore ose rrjedhës së ujit që tejkalon kufirin e lejuar ose për pengimin e ushtimës që në mënyrë të konsiderueshme e tejkalon kufirin e lejuar dhe me atë do të shkaktojë rrezik për jetën ose shëndetin e njerëzve apo zhdukjen e botës shtazore dhe bimore do të dënohet me burgim prej më së paku pesë viteve.¹³⁰

¹²⁷ Shih nenin 38 të KP dhe nenet 212, 219 të Ligjit për përmbardimin e sanksioneve të RM-së

¹²⁸ Shih nenin 35 të KP dhe nenet 37 dhe 211 të Ligjit për përmbardimin e sanksioneve të RM-së

¹²⁹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 218, paragrafi 1

¹³⁰ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 218, paragrafi 2.

Dënimi nga paragrafi 2 i këtij neni do të dë shqiptohet personit i cili në kundërshtim me rregulloret, administron ose operon një fabrike në të cilën kryhen veprimtari të rrezikshme ose në të cilat depozitohen ose përdoren substanca ose përgatitje të rrezikshme, të cilat jashtë fabrikës mund të qëndrojnë përgjithmonë ose përkohësisht, rrezikojnë cilësinë e ajrit, ujit ose tokës si dhe rrezikojnë ndjeshëm jetën ose shëndetin e njerëzve dhe dëmtojnë florën dhe faunën.

Nëse vepra penale është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me gjobë ose deri në tre vjet burg. Me rastin e shqyptimit të dënimit me kusht, gjykata mund ti shqyptojë një kusht kryerësit të veprës penale të marrë masat e përcaktuara për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit brenda një periudhe kohore të caktuar. Nëse krimi sipas këtij neni është kryer nga një person juridik, ai do të dënohet me gjobë.¹³¹

5.1.2. Vepra penale e ndotjes së ujit të pijshëm

Vepra penale “Ndotja e ujit të pijshëm”, parashihet në neni 219 të Kodit Penal dhe dënimi për këtë vepër penale është me gjobë ose me burgim deri në tre vjet, për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilën me ndonjë materie të dëmshme do të ndotin ujin e pijshëm të burimi, pusit cisternës apo rezervuarit apo ndonjë ujë tjetër të pijshëm.¹³²

Me veprimin e kryerësit të kësaj vepre penale do të paraqitet epidemia e ndonjë sëmundjes ngjitëse, atëherë kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet. Nëse vepra penale do të kryhej nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.¹³³

Në rastet e kryerjes së veprës penale të ndotjes së ujit të pijshëm nga person juridik atëherë dënimi që do të shqyptohet do të ishte me gjobë.

¹³¹ Po aty (ref. 130), paragrafi 4 dhe 5.

¹³² Shih nenin 219 të Kodit Penal të RM-së,

¹³³ Po aty, paragrafi 2 dhe 3.

5.1.3. Vepra penale e prerjes së paligjshme të pyjeve

Prerja e paligjshme e pyjeve është vepra tjetër penale kundër mjedisit jetësor, kjo veprë penale në Kodin Penal parashihet në nenin 226 si në vijim:

Ai i cili përkundër rregullave apo urdhërave të organeve apo organizatave kompetente do të bëjë ndryshimin e caktuar, pres, apo pastrojë pyjet apo do të thundërzojë trungjet dhe do të shkatërrojë pyllin do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.¹³⁴

Nëse vepra penale do të kryhej në pyë të mbrojtur, park nacional apo në pyll me kushtim special, kryerësi i kësaj veprë do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet. Personi i cili do ta kryente veprën penale në pyllin e vet do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Nëse vepra penale do të kryhej nga person juridik, dënimi që do të shqyptohet do të ishte me gjobë.¹³⁵

5.1.4. Vepra penale e rrezikimit të mjedisit jetësor me hedhurina

Vepra penale e “Rrezikimit të mjedisit jetësor me hedhurina” rregullohet me nenin 230 të KP. Dënimi për kryerësit e kësaj veprë penale është prej tre muaj deri në tre vjet, për të gjithë personat të cilët përkundër dispozitave për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës do të skadojnë (ruajnë) në depo ose në ndonjë vend tjetër hedhurinst, apo do të shpërndajnë ndonjë materie hedhurinash dhe me këtë veprim do të ndikojnë në kualitetin e ajrit, tokës, ujit apo rrjedhës së ujit, do të rrezikojnë jetën e botës bimore dhe shtazore si dhe shëndetin e njerëzve.¹³⁶

Në rastet më të rënda të kësaj veprë penale, dënimi që mund të shqyptohet është prej katër deri në dhjetë vjet, për të gjithë ato që do të ruajnë në depo, shpërndajnë apo do të lënë hedhurina të rrezikshme që përmbajnë substanca që kanë cilësinë e eksplozivit, reaktivitetit, ndezjes, ngacmueshmërisë, helmueshmërisë, infeksionit, kanë ndikim kancerogjen, mutagjen,

¹³⁴ Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (tekst integral i përpunuar në gjuhën shqipe), 2010, fq. 190

¹³⁵ Po aty, neni 226, paragrafët 2-5.

¹³⁶ Shih nenin 230 të KP të RM-së

teratogjen apo etoksitet ose cilësi të lëshimit të gazrave helmuese përmes reaksioneve të ndryshme kimie dhe atyre biologjike.¹³⁷

Personi që do të kryejë këtë vepër penale nga pakujdesia do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Nëse vepra penale do të kryhej nga personi juridik, denimi që do të shqyptohej do të ishte me gjobë.

5.1.5. Vepra penale e transportimit të materieve të rrezikshme në vend

Vepra penale e transportimit të materieve të rrezikshme në vend, rregullohet me nenin 232 të KP të RM-së dhe do tu shqyptohej të gjithë atyre që përkundër dispozitave të caktuara do të fusë në vend materie apo hedhurina radioaktive, të dëmshme për jetën apo shëndetin e njerëzve, do të dënohet me burgim prej një deri në dhjet vjet.¹³⁸ Çdo person zyrtar i cili përkundër dispozitave do të mundësojë të futen në vend materie apo hedhurina do të dënohet me së paku tre vjet burgim. Nëse vepra penale do të kryhet nga personi juridik denimi do të jetë me gjobë.¹³⁹

5.1.6. Vepra e rënda penale kundër mjedisit jetësor

Dënimet për vepra të rënda kundër mjedisit jetësor, do të shqyptoheshin nëse për shkak të këtyre veprave penale do të shkaktohej lëndim i rëndë trupor ose do të keqësohej shëndeti i më shumë personave, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Në rastet e shkaktimit të vdekjes së një apo më shumë personave, apo ndryshimet nga ndotja nuk do të menjanohesin për periudhë më të gjatë kohore nga këto vepra, denimi do të ishte me burgim me më së paku katër vite. Në rastet kur do të dëmtohej rëndë pasuria, kryerësi do të dënohej me burgim prej një deri në pesë vjet.¹⁴⁰

¹³⁷ Po aty, paragrafet 3-5

¹³⁸ Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (tekst integral i përpunuar në gjuhën shqipe), 2010, fq. 194.

¹³⁹ Po aty, neni 232, paragrafi 2 dhe 3.

¹⁴⁰ Shih nenin 234 të Kodit Penal të RM-së

5.2. Masat parandaluese ndaj veprave penale kundër mjedisit

Kriminaliteti mjedisor nuk njeh dhe nuk respekton asnjë kufi lokal apo rajonal, kombëtar, ndërkombëtar, madje as fizik. Prandaj është shumë e rëndësishme të theksohet se krimet mjedisore po kërkojnë thirrjen e parimeve të kriminologjisë krahasuese (ndërkombëtare) për studimin e tij dhe parimet e legjislacionit penal ndërkombëtar për kontrollin e krimin mjedisor. Për më tepër është e rëndësishme të theksohet se mungesa e teorisë në fushën e kriminalitetit mjedisor është po aq e dukshme në hulumtimin e krimin të specifik për mjedisin jetësor.

Roli i parandalimit të veprimtarive të dëmshme për mjedisin është i lidhur ngushtë me kriminologjinë, sepse ishte kriminologjia ajo që kuptoi se njerëzit nuk mund ta pushtojnë, as ta kontrollojnë natyrën. Njerëzit duhet të ndërtojnë jetën e tyre brenda kugzimeve ekologjike. Prandaj, kriminologjia quhet “kriminologji e gjelbërt proaktive”. Në këtë drejtim, theksohet se zgjidhja e problemeve bashkëkohore mjedisore nuk qëndron në legjislacionin më të kufizuar për mbrojtjen e mjedisit por ajo qëndron në ripërcaktimin e marrëdhënies sonë me natyrën në përgjithësi. Fatkeqësisht, kulturat, vlerat dhe përceptimet tona ndaj natyrës duhet të rishikohen, njerëzit duhet të kalojnë nga sjellja reaktive në sjellje proaktive (parandaluese) ndaj veprave penale kundër mjedisit.¹⁴¹

Qëllimet dhe objektivat e parandalimit të krimin mjedisor janë të pandara nga eko-filozofia. Kjo do të thotë, ajo që ne përpiqemi të parandalojmë është e lidhur me mënyrën se si ne i shohim interesat njerëzore, nevojat dhe kërkesat e biosferave specifike.¹⁴² Parandalimi i krimin mjedisor gjithashtu përfshinë vizione të veçanta të shoqërisë, parandalimi i krimin të çdo lloji ka pasoja për llojin e botës brenda të së cilës ne jetojmë si dhe ekuilibrin që bëjmë midis lirisë dhe kontrollit shoqëror.¹⁴³ Një qëndrim i fortë ekologjik mund të justifikonte ndalimin e njerëzve për të hyrë në ndonjë zone të shkretirës në bazë të parandalimit të ndërhyrjes njerëzore në zona të tilla. Nëse alternativat janë të mundshme ose duhet të vihen në

¹⁴¹ Mesko, Gorazd & Bančić, Klemen & Eman, Katja & Fields, Charles. (2011). Situational Crime-Prevention Measures to Environmental Threats, fq. 21

¹⁴² Green criminology and the pursuit of social and ecological justice, in Beirne P & South N (eds), Issues in green criminology: confronting harms against environments, humanity and other animals. Devon: Willan Publishing, 2007

¹⁴³ Sutton, Cherney & White, Crimes against nature: environmental criminology and ecological justice, 2008, fq.

dispozicion është pikërisht ajo që diskutimet politike mbi parandalimin e krimit do të duhet të adresojnë.

Duke marrë parrasysh natyrën shumë komplekse të mjedisit si dhe ndërveprimin mes përbërësve të ndryshëm të tij, është më se e domosdoshme që në këtë kontekst të jetë adoptimi i një qasjeje të integruar, me anë të së cilës do të sigurohej parandalimi i këtyre veprave penale dhe nuk do të rrezikohej mjedisi jetësor.

Rol të rëndësishëm në “luftën parandaluese” të këtyre krimeve kanë institucionet shtetërore në mbrojtjen e mjedisit duke filluar nga procesi i planifikimit hapësinorë, ku roli më i rëndësishëm këtu bie mbi Ministrinë e Ambientit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinorë, duke filluar nga përgatitja periodike e strategjive dhe planeve mjedisore dhe hapësinore. Ajo gjithashtu ka rol të rëndësishëm në nxitjen dhe mbështjetjen e veprimtarive të cilat kanë për synim një nivel më të lartë mbrojtjeje të mjedisit jetësor, me përdorimin e mjeteve të plotikës së mbrojtjes të mjedisit, të cilat parashihen në ligjin përkatës.

Propozimet dhe nevoja për ndryshime, reforma në kuadrin ligjor në fushën e mjedisit jetësor janë shumë të nevojshme dhe janë një hap pozitiv për forcimin e kapaciteteve kontrolluese edhe të Inspektoriatit shtetëror të mjedisit, me anë të së cilave do të sigurohej zbatimi i ligjit dhe parandalimi i shkeljeve eventuale që do të mund të arrijnë deri në konsumimin e veprave penale kundër mjedisit.

Zbatimi në praktikë të reformave ligjore dhe institucionale të cilat janë kryer vitet e fundit, për parandalimin e shkeljeve të ligjit, kërkon edhe investime më të mëdha për sektorin e mjedisit. Republika e Maqedonisë ka kryer reforma në këtë drejtim që janë dhënë nga BE-ja, në kontest të integrimit evropian të vendit dhe ka shfrytëzuar fondet IPA nga Bashkimi Evropian të dedikuara për fushën e Mjedisit.

PËRFUNDIMI

Veprat penale kundër mjedisit jetësor, si vepra penale që janë në rritje të vazhdueshme, në vendet e Ballkanit, në krahasim me shtetet evropiane të cilët këtë problematikë e kanë tejkaluar dhe numri i këtyre veprave penale është në ulje dhe është zvogluar ndjeshëm në 10 vitet e fundit.

Në rajonin e Tetovës këto vepra penale janë të theksuara, mirëpo siç ju paraqitëm më lartë, numri i vogël i rasteve të paraqitura dhe personave të dënuar për kryerjen e këtyre veprave penale është problemi kryesor që ndihmon kryerësit që të vazhdojnë të dëmtojnë mjedisin dhe qytetarët, duke dëmtuar të mirat e përgjithshme, posaçërisht me uzurpimin e zonave të gjelbërta në qytetin e Tetovës dhe rethinës, nga ndërtimet e ndryshme pa leje që janë ndërtuar në dhjetë vitet e fundit. Problem tjetër që paraqitet në këtë rajon është edhe infrastruktura e dobët dhe ngarkesa e madhe e komunikacionit, duke mos harruar edhe ndotësin më të madh të qytetit, fabrikën “Jugohrom”, që vazhdon punën duke mos respektuar standardet e vëndosjes së filtrave të cilët do të parandalonin ndotjen e ajrit nga ky subjekt.

Studimi i tyre i pamjaftueshëm mirëpo i nevojshëm dhe shumë i rëndësishëm, prandaj rëndësia e këtij punimi qëndron në atë se gjatë analizës së shkaqeve të kryerjes dhe hulumtimit të këtyre veprave, del në sipërfaqe se si rezultat i cilëve faktorë këto vepra janë në rritje të vazhdueshme, si intervenon shteti në kompensimin, dëmshpërblimin dhe mbrojtjen e viktimave, sa ndikojnë sanksione e parapara kundër këtyre veprave penale në risocializimin e kryerësve dhe vetëdijësimin e qytetarëve në përgjithësi.

Hulumtimi me të dhëna statistikore si dhe bashkëpunimi në hulumtim me përfaqësues të organizatave të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit jetësor, do të ndihmojë në pasqyrimin dhe informimin e qytetarëve mbi rreziqet që vijnë si pasojë e këtyre veprave si dhe mundësia e parandalimit dhe kontribuimi i masës në këtë drejtim.

Shpresoj që ky punim do të kontribuojë në njohjen e rrezikshmërisë së këtyre veprave penale për të gjithë personat që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, si dhe të kontribuojë për gjetjen e masave më efikase për parandalimin e kësaj dukurie mjaft të dëmshme për shoqërinë.

BIBLIOGRAFIA

I. Libra, monografi, punime kërkimore shkencore

- Kambovski, Vllado, E drejta penale, *pjesa e përgjithsme*, Shkup 2007
- Kambovski Vlado & Zejneli Ismail, E drejta Penale, Shkup 2018
- Zejneli, Ismail, E drejta penale, pjesa e posaçme *cikël leksionesh*, Tetovë 2007
- Zejneli, Ismail, Legal aspect of environmental protection in Macedonia. In *Legal aspect of environmental protection in Macedonia*, pp. 14. SEEU REVIEV, No. 1, 2008
- Çicoli, E. Veprat penale në fushën e mjedisit,
- Bell S, Mc Gillivra YD, *Environmental Law, seventh edition*, Oxford University press, 2008
- Elezi, I, E drejta penale e RPSSH *pjesa e posaçme*, Tiranë 1983
- Jovanović, Jovasheviq, Krivicno pravo, Beograd, 2002
- Beijen, B. A., *The implementation of area protection provisions from European environmental directives in the Member States*, Utrecht Law Review, Vol. 5, Nr. 1, Qershor, 2009
- Carevic, M., *Judicial Training and Research on EU crimes against environment and maritime pollution: Report for the Republic of Croatia*
- Dindi, M.P., Shënime nga jurisprudenca shqiptare: *dega penale 1929-1942*, Tiranë
- Elezi, Ismet, E drejta penale-pjesa e posaçme, Tiranë, 2009
- European Commission, *Proposal for a directive of the European Parliament and of the Council on the protection of the environment through criminal law, Explanatory Memorandum*, 2007
- Salihu, Ismet, “E drejta penale (pjesa e përgjithshme)”, Prishtinë, 2005
- Kanevcev, Metodija, “Praktikum za krivicno pravo poseben del “, Shkup, 2003
- Vesels, Johanes, Hetinger, Mihael, Kazneno pravo, poseben del 1, 2009
(Tabernakull – pjesë e projektit të R. M. – së për përkthim të 500 librave me të cilat mësohet në universitetet më të mira në SHBA dhe EU)
- Reid, Titus, Sue, Criminal law, Florida, 1998
- Matravers, Matt, Justice and punishment , New York, 2000
- Merrills, G. J., Human rights in Europe , UK, 2001
- Stojmenova, Sllagjana, Krivicen Zakonik, Shkup, 2006

- Marjanovic, Gjorgji, E drejta penale maqedonase (pjesa e përgjithshme), Shkup, 1998
- C. Hamilton, A. Macintosh, in Encyclopedia of Ecology, 2008
- L.Ramacci, Diritto penale dell' ambiente, 2011
- Kathleen Imholz dhe Elsa Toska (Dobjani), manual, Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, Tiranë 2016
- JE Scott EW Hughes, Ecology, 1986
- Gilbert F. White, Reflections on Changing Perceptions of the Earth, 1994 Annual Review of Energy and the Environment 19 (1994)
- A. Dan Tarlock , History of Environmental Law,
- Jean-Claude BRUNET, 27th OSCE ECONOMIC AND ENVIRONMENTAL FORUM, Prague 12th Sept. 2019 “Strengthening good environmental governance and international cooperation”: The case for preventing and fighting Environmental Crime in the OSCE Region.
- Jordan, AJ Seen, GE Jacobsen - Atmospheric Environment, 2006 – Elsevier
- EEA - Air quality in Europe — 2014 report review
- Qeveria e RM-së (raport vjetor), Programi për reduktimin e ndotjes
- Katja Eman, Criminal Law, Criminology, Human Ecology, Environmental interactions, 2014
- Justice for Forests Improving Criminal Justice Efforts to Combat Illegal Logging, Marilyne Pereira Goncalves, Melissa Panjer, Theodore S. Greenberg, William B. Magrath, 2012
- Chatham House. (2015, July). Tackling Illegal Logging and Related Trade: What progress and where next. The Royal Institute of International Affairs, London.
- Богеска Р., Цекова Б. и Герасимовска Б. (2008): Влијание на отпадоците врз животната средина
- M.I. Ojovan W.E. Lee, An Introduction to Nuclear Waste Immobilisation 2005
- Eileen Skinnider, Effect, Issues and Challenges for Victims of Crimes that have a Significant Impact on the Environment, 2013,
- Dr. Thomas Wölfl, Environmental law in Germany
- XiaoJianMing OuYangGuangMing. Monograph on comparative law, Beijing: China environmental science press, 2004

- Michael Coxall and Elizabeth Hardacre, Clifford Chance LLP, Environmental law and practice in the UK (England and Wales)
- J. Omejec i M. Seršić, PRAVO ZAŠTITE OKOLIŠA, EKOLOŠKO PRAVO
- Goodstein Eban, Ekonomika i okoliš, MATE, Zagreb, 2003.
- Instrument for Pre-accession Assistance, IPA 2013 Annual Programme. Waste Management 09-2012/02,pp. 1-2.
- Ismet Elezi, Politika Kriminale, 2006
- Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (tekst integral i përpunuar në gjuhën shqipe), 2010
- Mesko, Gorazd & Bančić, Klemen & Eman, Katja & Fields, Charles. (2011). Situational Crime-Prevention Measures to Environmental Threats,
- Green criminology and the pursuit of social and ecological justice, in Beirne P & South N (eds), Issues in green criminology: confronting harms against environments, humanity and other animals. Devon: Willan Publishing, 2007

Burime Juridike

II. Kushtetuta, Kode, Ligje, Direktiva dhe Konventa

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë
- Ligji i procedurës penale i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për mbrojtjen e natyrës i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për mjedisin jetësor i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për ujërat i Republikës së Maqedonisë
- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për menaxhimin e mbeturinave i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor në RM

- Ligji për organizmat e modifikuar gjenetikiht i RM-së
- Ligji për pyjet i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për gjuetinë i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për Energjetikë i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për bartje të materieve të rrezikshme të RM-së
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Kroacisë
- Kodi Penal i Republikës së Italisë
- Kodi Penal i Francës
- Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut
- Konventa për mbrojtje të mjedist përmes të drejtës penale
- Konventa e Arhausit
- Direktiva 2008/99/EC
- Direktiva 2009/123/EC
- Direktiva 2005/35/EC

III. Burime interneti

www.stat.gov.mk

www.mvr.gov.mk

www.pravda.gov.mk

http://ec.europa.eu/environment/legal/crime/pdf/criminal_penalties1.pdf

<http://www.germanlawjournal.com/>

<https://www.ippc.int/en/themes/environment-protection/>

<https://childrenandarmedconflict.un.org/keydocuments/albanian/universaldeclara1.html>

<https://www.osce.org/secretariat/429728?download=true>

<https://legalcareerpath.com/what-is-environmental-law/>

https://ec.europa.eu/environment/legal/crime/legis_en.htm

<https://academic.oup.com/femsec/article/92/7/fiw087/2469992>

https://ec.europa.eu/environment/forests/illegal_logging.htm

<http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/Izvestaj-na-JORM.pdf>

<http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2013/04/godishen-izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelstva-vo-republika-makedonija-za-2012-godina.pdf>

<http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2015/03/Godisen-izvestaj-za-2009-godina.pdf>

http://www.vsrn.mk/wps/wcm/connect/vsrn/2d951736-5e91-4069-bd7f-fb8ba8de0fc0/VSRM+izveshtaj+za+2014.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41L0B520APQFKICD0CU3-2d951736-5e91-4069-bd7f-fb8ba8de0fc0-ldWzOgu

http://www.osvinica.mk/wps/wcm/connect/vsrn/7c41727a-faa7-4a9e-aba4-0cc364114abc/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98+%D0%92%D0%A1%D0%A0%D0%9C-2013.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41L0B520APQFKICD0CU3-7c41727a-faa7-4a9e-aba4-0cc364114abc-lfR-DBU

http://www.vsrn.mk/wps/wcm/connect/vsrn/c81484b0-73e9-431d-9666-08e4ab2aeacb/Izvestaj-VSRM-2012.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41L0B520APQFKICD0CU3-c81484b0-73e9-431d-9666-08e4ab2aeacb-lfR-DBU

http://www.sud.mk/wps/wcm/connect/vsrn/7d4305b9-5d09-41d2-b6c0-2f12ddc0cc50/Izvestaj-VSRM-2011.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41L0B520APQFKICD0CU3-7d4305b9-5d09-41d2-b6c0-2f12ddc0cc50-lfR-DBU

<http://www.sei.gov.mk/uploads/Godisen%20Izvestaj%202014-DIZS%20grafik-final.pdf>

<https://www.epa.gov/aboutepa>

<https://efface.eu/fighting-environmental-crime-uk-country-report>

<https://www.gov.uk/government/organisations/environment-agency>

ABSTRAKT

Në këtë punim janë trajtuar çështjet e veprave penale kundër mjedisit jetësorë, mbrojtja e mjedisit jetësor, që është një fushë relativisht e re dhe është në zhvillim e sipër.

Dëmet që i bëhen mjedisit janë të lidhura me ndotjen e ajrit, tokës dhe ujit, këto rreziqe dëmtojnë po edhe vrasin më shumë njerëz se krimet që ndodhin në rrugë, gjithashtu dëmi që shkaktohet nga këto vepra penale është shumë i madh edhe në aspekt financiar ku humbjet janë të mëdha. Sot bota çdo ditë përballlet nga këto dëme që i bëhen mjedisit nga këto vepra.

Fokusi është në legjislacionin e shtetit të Maqedonisë se si i trajtonë këto çështje, duke zbatuar në praktikë normat penale-juridike, sa është efektiv legjislacioni për të mbrojtur mjedisin përmes të drejtës penale. Raportimet mbi veprat penale kundër mjedisit, sa krime janë të paraqitura sa prej tyre janë trajtuar dhe sa persona janë gjykuar dhe sa të tjerrë kanë marrë dënim për realizimin e këtyre veprave penale shumë të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve dhe mjedisin jetësor.

Fusha: E drejta Penale

Fjalët kyçe: mjedisi jetësor, veprat penale kundër mjedisit jetësor, ambienti, natyra, krimi mejdisor, kodi penal, mbrojtja e mjedisit.